

ZGJEDHJET 2016

RAPORTI PËRFUNDIMTAR NGA VËZHGIMI AFATGJATË I PROCESIT POLITIK DHE
ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

ZGJEDHJET 2016

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR NGA VËZHGIMI AFATGJATË I PROCESIT POLITIK DHE
ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

CIVIL - Qendra për Liri
Shkup, 2017

ZGJEDHJET 2016: Raporti përfundimtar nga vëzhgimi afatgjatë i procesit politik dhe zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Republikën e Maqedonisë

Botues: CIVIL – Qendra për Liri

Për botuesin: Xhabir M. Deralla

Ekipi redaktues/Ekipi i Projektit i Civilit:

Xhabir M. Deralla (redaktor i publikacionit), Sinisha Stankoviq (redaktor i CIVIL Media), Biljana Jordanovska, Monika Taleska, Maja Ivanovska, Dehran Muratov, Ermin Klimenta, Dr. Sasho Ordanoski (analist politik), Aleksandar Novakoski (ekspert juridik), Sandra Gavrilovska (ekspert juridik), Petrit Saraçini (ekspert i medieve), Goran Naumovski (ekspert i financave), Dragan Zeliq (GONG, Kroaci, ekspert i mbikëqyrjes së zgjedhjeve), Heather Roberson Gaston (SHBA, ekspert i të drejtave të njeriut), Sonja Eftovska (CIVIL, Kryetare e Komitetit Ekzekutiv), Marija Tegovska, Marijana Gugoski, Diana Tahiri, Kreshnik Ajdini.

Shërbimet gjuhësore: Natasha Cvetkovska, Diana Tahiri, Kreshnik Ajdini, Heather Roberson Gaston, Mr. Gordana Aceska

Thyerjet teknike dhe dizajni: Ivana Taleska, Ermin Klimenta

Fotografite: Biljana Jordanovska, CIVIL - arkivi

Ilustrimet: Miroslav Stojanoviq, Xhabir M. Deralla

Shtypi: SHT Dule 99, Shkup

Rezultatet dhe qëndrimet e prezantuara në këtë publikim janë të Civilit dhe të autorëve dhe nuk i reflektojnë domosdo qëndrimet e donatorit.

Ky publikim u financua me mjete gjermane nga Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore.

Ky publikim është në dispozicion sipas kushteve të Creative Commons Attribution 4.0 License.

Kontakt:

CIVIL, Maksim Gork 31/1, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

02/5209176 | civil@civil.org.mk | civil.mk@gmail.com

Web: www.civil.org.mk | Facebook: www.facebook.com/civil.mk | Twitter: www.twitter.com/CivilMacedonia


YouTube: www.youtube.com/c/Civil.Macedonia

ISBN-10 608-4815-05-7

ISBN-13 978-608-4815-05-1

EAN 9786084815051

PËRMBAJTJA | 4 Frikë, ndarje, shtet i robëruar...Dhe mos-
bindje! | 10 Projekti "Maqedonia e Lirë" | 16 Rekomandime (para
zgjedhore të Civilit | 16 Vetëm zgjedhjet e lira janë një shans për
të rivendosur sundimin e ligjit | 28 Presion brutal politik притисок
| 36 CIVIL kërkon që institucionet dhe partitë politike t'i ndër-
presin keqpërdorimet dhe presionet | 46 Qytetarë, mos u frikësoni
të votoni! | 52 Ditë e qetë e votimeve, por e tensionuar, përplot me
parregullsi | 73 Rivotim në Tearcë, ilustrim i vogël për probleme
Të mëdha | 78 Rrëmujë: Lista e votuesve dhe Komisioni Shtetëror
Zgjedhor | 88 Raportime të misioneve të huaja vëzhguese –
bashkëpunim me Civil | 96 Maqedonisë i duhet një proces i
ngjashëm me denacifikimin | 106 Aty ku ka frikë, nuk ekziston
demokracia! | 114 U shkel e drejta e votës! | 126 Beteja për
të partive politike | 142 Fushata më e pistë deri më tani | 158
Mediat e dirigjuara përsëri me avazin e vjetër: Propagandistët
e dëgjueshëm të pushtetit mezi e pritën fundin e mandatit të
komisionit ad-hok! | 162 Fushatë e zezë | 170 Dyqind ditë të rënda
për Maqedoninë | 188 Betejat me sajber ujkun e keq | 196 Për
projektin



MES FRIKËS,
NDARJEVE DHE
SHTETIT TË
ROBËRUAR



Xhabir Deralla, CIVIL, prezantim i parimit ZERO TOLERANCË PËR PARREGULLSITË ZGJEDHORE

MES FRIKËS, NDARJEVE DHE SHTETIT TË ROBËRUAR

XHABIR DERALLA

Proceset zgjedhore në Republikën e Maqedonisë nxorën një varg defektesh socio-politike dhe institucionale. Zgjedhjet parlamentare 2016, në shumë mënyra, paraqesin trashëgiminë e robërisë dhjetëvjeçare institucionale të cilën e zbatuan partitë në pushtet. Dhuna strukturore, korrupsioni politik i përhapur anembanë dhe shkelja e ligjeve dhe standardeve demokratike, u bënë karakteristikë dominuese të jetës së përditshme, të shënuar me ndarje, frikë dhe kanosje. Nga e paturpshmja deri te suptilja, defektet e këtilla dhe ndërhyrja e thellë në sistemin demokratik krijuan kushte për robërimin e çdo truri dhe manovrimin me përmasa të papara.

Mediet tradicionale dhe të reja vazhduan të jenë arena në të cilat propaganda e ndyrë dhe agresive zëvendësuan informatat, duke e mjegulluar pasqyrën për atë që vërtet ndodh në vend. Civili i ndjek këto sfida që nga viti 2008, duke sjellë konkluzione se mediet, me përjashtime shumë të vogla, nuk mund t'i përgjigjen detyrës t'i informojnë votuesit për opsionet të cilat u ofrohen, sepse nisen, para së gjithash, nga interesat e partive politike.

Sistemi zgjedhor dhe administrativ, gjegjësisht Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ), janë një pjesë e madhe e parregullsive dhe mungesës së efikasitetit në procesin zgjedhor. Përpjekje tejet të mëdha vendore dhe ndërkombëtare, ekspertizë, përkrahje dhe legjislacione

cion të ri iu lanë në dispozicion Komisionit Shtetëror Zgjedhor, me të cilën gjë u siguruan mundësi të papara deri më tani që ky institucion ta mbrojë ligjshmërinë e zgjedhjeve. Por, në fakt, Komisioni Shtetëror Zgjedhor u bë njëri nga problemet më serioze të cilat iu imponuan procesit zgjedhor. KSHZ manifestoi një arrogancë të skajshme dhe i ofendoi qytetarët me heshtjen dhe mosveprimin e tij. Me këtë, KSHZ pengoi mijëra qytetare dhe qytetarë ta realizojnë të drejtën kushtetuese dhe të votojnë ditën e zgjedhjeve.

Njerëz të paqenë votuan ditën e zgjedhjeve, ndërsa qytetare dhe qytetarë të gjallë ishin të fshirë, pa ndonjë sistem të krijuar për kompensim të dëmit dhe shkeljes të së drejtës së votës. Prandaj, KSHZ duhet menjëherë të japë dorëheqje, së paku për këtë arsye, nëse jo për mangësitë e tjera të shumta.

Arroganca e institucioneve, duke filluar me KSHZ dhe duke vazhduar deri te agjencitë qeveritare dhe shtetërore, vazhdon më tej. Ata nuk reagojnë, e as që ia dolën të japin përgjigje për parregullsitë e shumta të regjistruara gjatë procesit zgjedhor në vend.

Procesi dhe fushata zgjedhore u plotësuan me një histori të vrazhdë nacionaliste, manipulime dhe mbjellje frike. Shoqëria nga ky proces doli edhe më e hutuar, më e tërbuar dhe me frikë më të madhe për ardhmërinë.

Keqpërdorimi i parave publike, si dhe keqpërdorimi i tërësishëm dhe i pamëshirshëm i administratës publike ishte më se i dukshëm. Kjo është një praktikë aq e rregullt dhe e gjatë që rrallë merret në konsideratë nga ana e entiteteve relevante dhe të pavarura. Kur vëzhguesit e Civilit parashtrajnë pyetje në lidhje me keqpërdorimin e administratës, reaksioni gjithandej është: “Kjo është gjë normale!”. Dështimet e vrazhda dhe sistematike janë aq thellë të rrënjësura dhe paraqesin një realitet në jetën e njerëzve një kohë aq të gjatë, që tanimë konsiderohen për “normalitet” dhe “banalitet”.

Megjithatë, disa gjëra ndryshuan dy vitet e fundit. Kjo mund të shpjegohet me një fjalë të vetme. Kundërshtim!

Gjatë periudhës parazgjedhore dhe në vetë ditën e votimit, zyra, ekipet e vëzhgimit edhe gjatë shumë ngjarjeve në organizim të CIVIL – Qendrës për Liri, ishim dëshmitarë të numrit rekord të qytetarëve të prekur në Republikën e Maqedonisë, të cilët dëshironin të marrin pjesë në procesin politik ose së paku ta shprehin pakënaqësinë e vet, ndërsa në disa raste edhe të ndajnë vështirësitë gjatë votimit. Kësaj i paraprinin dy vjet protesta

të vazhdueshme, kur rrugët rregullisht ishin përplot me dhjetëra mijëra qytetare dhe qytetarë të Maqedonisë të cilët kërkonin ndryshime të sistemit.

Lufta e qytetareve dhe qytetarëve për liri, demokraci dhe drejtësi u reflektua edhe në rezultatet e zgjedhjeve. Krahas presionit të madh dhe aktiviteteve mashtruese të partive në pushtet, një numër i madh i qytetareve dhe qytetarëve, megjithatë, votua për opozitën. Ndërsa partia në pushtet, VMRO-DPMNE, përgjegjëse për tendencat e rrezikshme të robërimit të shtetit dhe retorikës nacionaliste, përfundoi me një avantazh të vogël në rezultatet zgjedhore, krahas përpjekjeve të arrijë një fitore bindëse.

Ky proces zgjedhor kishte edhe një rezultat fantastik. Dhjetëra mijëra shqiptarë votuan për socialdemokratët, partia e të cilëve konsiderohet(hej) si parti politike maqedonase. Të gjitha bashkësitë etnike në vend dërguan një mesazh të fuqishëm kundër nacionalizmit dhe ndarjeve dhe njëkohësisht dhanë shpresë se qytetaret dhe qytetarët janë përcaktuar për multikulturalizëm dhe demokraci, në vend të urrejtjes dhe ndarjeve.

Megjithatë, Maqedonia është larg zgjedhjeve të lira siç i meriton.

Dhe, ja ku jemi. Me krenari jua paraqesim këtë publikim, i cili është rezultat i përkushtimit vetëflijujes të qindra njerëzve të cilët punuan së bashku drejt krijimit të një raporti dhe analize gjithëpërfshirëse të procesit politik dhe zgjedhjeve të parakohshme në vend. Ne i nxjerrim faktet reale, krahas presioneve dhe kanosjeve. Ne nuk bëjmë dhe kurrë s'do të bëjmë kompromis!


Kjo është fruta e punës së treqind njerëzve të cilët punuan me Civilin një vit të gjatë të përmbushur me sfida dhe presione. Shumë qytetare dhe qytetarë me të cilët takohemi rrugëve dhe shesheve na quajnë spartanë. Me krenari e bartim këtë nofkë dhe do të vazhdojmë me një vendosmëri dhe këmbëngulje t'i nxjerrim faktet e realitetit, pa dallim se sa e dhimbshme është e vërteta.

Në emër të Civilit, do të doja ta shpreh falënderimin tim ndaj donatorëve të projekteve të cilat kishin të bëjnë me procesin politik dhe mbikëqyrjen zgjedhore gjatë vitit 2016.

Më lejoni, gjithashtu, ta shpreh falënderimin tim për përkushtimin e të gjithë vëzhguesve të Civilit, të ekspertëve dhe të gjithë autoreve dhe autorëve të këtij Raporti. Falënderoj të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët na e dhanë besimin dhe këmbyen informata të vlefshme me ekipet tona.

Mund të premtoj:

CIVILët do të mbeten të vendosur dhe të singertë.

A handwritten signature in black ink, reading "Xhabir D. Deralla". The signature is written in a cursive, flowing style.

Xhabir Deralla
Kryetar i Civilit

PROJEKTI

"MAQEDONIA E

LIRË"



“Të gjitha kushtet e motit janë të përshtatshme për aktivizëm”

PROJEKTI “MAQEDONIA E LIRË”

SINISHA STANKOVIQ

Shkup – Makedonski Brod – Dollnen – Krushevë – Demir Hisar – Novaci – Manastir – Kumanovë – Shkup... Nga mëngjesi i hershëm deri natën vonë. Në fakt, deri të nesërmen, herët në mëngjes. Me një makinë, itinerar prej 500 kilometrave nëpër Maqedoni, vizitë gjashtë vendeve të banuara, për 18-19 orë... Vetëm një ditë nga projekti, zyrtarisht i quajtur “Përpara!” (Forward!), pjesë e aktiviteteve të CIVIL – Qendrës për Liri, me qëllim të forcimit të vetëdijes te qytetarët për rëndësinë e zgjedhjeve të lira për demokratizim të Maqedonisë. Për mua, si redaktor i CIVIL Media, edhe ky, edhe të gjitha projektet e tjera të cilët paralelisht i realizojmë/nim, janë pjesë e mega-projektit për çlirimin e Maqedonisë nga frika dhe autokracia.

Maqedonia 2016-ën. Shkurt-mars, prill-maj, shtator-nëntor, qytetaret dhe qytetarët e zhytur në indiferencë dhe depresion për shkak të varfërisë, institucioneve të kidnapuara, bredhjes në vend për një dekadë dhe frustrim nga pamundësia e rrugëdaljes...

Aktivistët e CIVIL – Qendrës për Liri, gjatë tërë vitit, nëpërmjet udhëtimit dhe vizitave, organizimit të ngjarjeve publike dhe takimet me qytetaret/ët, nëpërmjet hulumtimeve, anketave dhe analizave, nëpërmjet qindra teksteve, video-materialeve dhe fotografive, u përpoqën të tregojnë dhe dëshmojnë se bën edhe ndryshe, se edhe pas dhjetë vjet prapavajtjeje dhe vjedhje të paparë, Maqedonia vazhdon të ketë shans të kthehet në shtigjet euroatlantike. Dhe, na fund, të niset drejt rrugës së ngritjes në një vend të mirë për jetesë.

Shkup – Makedonski Brod – Dollnen – Krushevë – Demir Hisar – Novaci – Manastir – Kumanovë – Shkup... Nga mëngjesi i hershëm deri natën vonë. Në fakt, deri të nesërmen, herët në mëngjes. Me një makinë, itinerar prej 500 kilometrave nëpër Maqedoni, vizitë gjashtë vendeve të banuara, për 18-19 orë... Katër aktivistë, tre gazetarë, një vozitës, një drejtor, një redaktor, një profesoreshë, një politikolog, të gjithë së bashku, në fakt, megjithatë, vetëm katër CIVIL-ë, dy burra dhe dy vajza për shkak të “xhendër balancit”, por me të gjitha “funksionet” e tyre në shoqatën joqeveritare, në të cilën për çdo ditë, të gjithë punojnë gjithçka. Çka duhet. Sidomos kur vëzhgohet para zgjedhjeve, por edhe në ditën e zgjedhjeve dhe në vizitat paszgjedhore.

Ekipi i këtillë katëranëtarësh, zakonisht ishte vetëm njëri nga dy apo tre ekipet të cilët paralelisht, në periudhën e përgatitjeve të pritjeve të gjata dhe zgjedhjeve parlamentare të parakohshme dy herë të shtyra, vitin e kaluar, në tri rrugëtime të mëdha, endej nëpër Maqedoni. Dhe, e jepte edhe atomin e fundit, për ngjalljen e demokracisë, për vendosjen e rregullave të reja të lojës, në të cilat qytetarët mëvetësisht, pa presione, kërcënime dhe frikësime, do të vendosin se kujt do t’ia japin besimin dhe të drejtën ta udhëheqë shtetin. Në mënyrën e vet, atë të Civilit, të cilin shumica në sferën politike (fatkeqësisht edhe në punën “e zyrës” të sektorit qytetar në Maqedoni) nuk e kuptojnë dhe nuk e pranojnë. Por, edhe kjo, ose pikërisht kjo është Civili...

Apo... Shkup = Hanet e Mavrovës – Radostush – Qendra Zhupë – Dibër – Vevçan – Bellçisht – Botun – Shkup... Nga mëngjesi i hershëm deri natën vonë. Në fakt, deri të nesërmen, herët në mëngjes. Një makinë, itinerar prej 400 kilometrave nëpër Maqedoni, vizitë shtatë vendeve të banuara, për 18-19 orë... Turbo turne.

Me mijëra fllaera, dy banerë, dy altoparlantë, ndonjëherë edhe video-bim dhe projektues, me një tavolinë plastike të mbuluar me pllakate (si një stendë e improvizuar), në të cilën vendosen materiale dhe publikime informative dhe edukative në maqedonisht dhe shqip, por edhe turqisht, serbisht, në gjuhën rome... Materiale përmbajtja e të cilave flet për rëndësinë e shprehjes së lirë të vullnetit, për domosdoshmërinë që në Maqedoni më në fund të organizohen zgjedhje të lira, demokratike dhe korrekte, për të drejtat e votuesve dhe obligimet e shtetit. Tre-katër lap-topa, dy foto-aparate, projektor, një kamerë, e tërë kjo në gepek dhe në ulëset e pasme të makinës... Aktivizëm, zhurnalizëm, idealizëm. Tre në një. Në terren. Mes qytetareve dhe qytetarëve. Për t’u dëgjuar zëri i tyre. Të mësohet për brengat e tyre...

Biseda me përfaqësues të partive politike në nivel lokal dhe me anëtarë të shoqatave joqeveritare, paraqitje në mediet lokale dhe press-konferenca në këmbë, jashtë – përball banerit të Civilit ose përball ndonjë përmendoreje lokale, për parregullsitë e zbuluara para zgjedhjeve, për fushatat dhe procesin zgjedhor, për financimin e partive dhe votuesve të paqenë, për mosgatishmërinë e administratës zgjedhore në planin lokal...

Takime me qytetarët në vendet e banuara në sheshet qendrore, para dyqaneve të vegjël dhe në kafeteri, por edhe nëpër arra dhe oborre, në shtëpitë e tyre... Ndarja e fllaerave, shpjegimi i qëllimeve të projekteve për monitorimin e zgjedhjeve, mobilizimi i vëzhguesve, përforcimi i vetëdijes për rëndësinë e zgjedhjeve të lira për ardhmërinë e Maqedonisë.

Rregullsia dhe shpeshtësia ngjallin rinjohje, ndërsa këngët nga altoparlantët tanë, janë “paraqitja” se Civili ka ardhur përsëri si mysafir. Qytetarët, kryesisht, na afrohen me rezerva, duke mbajtur llogari se kush do t’i vërejë. Megjithatë, vinin edhe vetë, për t’u ankuar, për të reaguar, për të kërkuar ndihmë... Të kërkojnë punë për fëmijët e vet, mbrojtje sociale dhe shëndetësore, barazi para ligjit, trajtim human dhe të ndershëm nga institucionet shtetërore. Pastaj, edhe regjistrim dhe Listë Zgjedhore të pastër, edhe pushtet lokal i cili do t’i zgjidhë problemet lokale, jo “politikë të lartë”, edhe pallate të kulturës, edhe ambulanca dhe farmaci, mirë, diku edhe energji elektrike, edhe ujësjellës dhe kanalizim...

Në çdo udhëtim na përsëriteshin replikat për bukuritë natyrore të Maqedonisë dhe për varfërinë, por na ndodhnin edhe dhjetëra takime të rastësishme të cilat thjesht të plotësojnë dhe gjatë pas kësaj mbeten në kujtim. Pirja e çajit me kryetarin e komunës, votuesit e të cilit kryesisht jetojnë nga të hollat nga jashtë, nga familjarët e shpërngulur, por i cili beson se “njerëzit do të kthehen”, apo pirja e kafesë me përfaqësues të pushtetit lokal, të cilët e pranojnë se situata është jashtëzakonisht e vështirë, por vazhdimisht theksojnë se paraardhësit kanë qenë më të këqij dhe se qytetarët kanë qenë absolutisht në të drejtë kur i kanë zgjedhë ata, sepse, megjithatë, po punohet diçka... Ose, biseda në këmbë me një traktorist i cili premtonte se do t’ia japë fllaerin djalit, i cili “ka kryer shkollë”, por edhe pse pa punë, i shmanget traktorit... Ose, një “transfer” i padhembshëm – nga thirrjet ironike nga një grup banorësh të moshuar, të cilët pinë birra, të ulur në arka para shitores së mëhallës e cila ka mbetur me “renditjen e brendshme” dhe me ofertën e raftëve në vitet e gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar – në një debat politik për partitë dhe zgjedhjet në mënyrë maqedonase, të plotësuar me parashikimet gjeostrategjike për vendin e Maqedonisë në agjendën e politikës së jashtme të SHBA dhe Rusisë...

Të gjithë bashkëbiseduesit tanë, pa dallim të rajonit në të cilin jetojnë, përkatësisë etnike, fesë... kishin dëshirë të bisedojnë për atë që i mundon, për mungesën e drejtësisë dhe padrejtësinë, për problemet ekzistenciale, të cilat i pakësojnë familjet dhe e rrisin shpërnguljen nga Maqedonia. Por, ajo që në pjesën e parë të vitit 2016 na rrëqethte gjatë takimeve me qytetaret/ët ishte – frika. Në sytë, në gjestet, në mënyrën e shqiptimit të fshehtë të disa fjalëve kalimthi...

Pothuajse niveli i pabesueshëm i informimit të banorit mesatar në vendet e banuara në brendi të Maqedonisë, u mundëson(te) PR-ekspertëve dhe spinerëve partiak të manipulojnë dhe paskajshëm të frikësojnë, duke llogaritur pashpresën e murosur në dekadën e heshtjes (“Hesht, duro, mos bëhet më keq!”) dhe gënjeshtreve. Shumë, tepër shumë biseda me qytetaret/ët na kaluan në bindje – se pushtetarët lokal dhe egërsirat me uniforma partiake, pronari i kompanisë ose drejtori, ose profesori fëmijëve, ose madje edhe mjeku, ose inspektori, ai i policisë apo i njësisë rajonale të pushtetit qendror..., s’guxojnë t’u kanosen dhe, thjesht, s’mund ta dinë se kush si ka votuar... Se askush nuk e xhiron vendin e votimit dhe se mundin lirisht të shprehen dhe ta zgjedhin për përfaqësues të vetin atë të cilit i besojnë dhe të mos u nënshtrohen kanosjeve për të bërë vepër penale me fotografimin e fletës së votimit apo me sigurimin e “listës së garancisë” prej 10-15-30 miq, kolegë, fqinj apo farefis, të cilët gjithsesi do të votojnë për “tanët”.

Megjithatë, ajo që inkurajon është ulja e frikës dhe çlirimi nga presioni i Partisë – Shtet. “Bombat”, protestat studentore, Revolucioni i Larmë, i hapën dyert e dyllosura... Diçka, më në fund, filloi të ndryshojë. Me erën e entuziazmit të kolegëve të rinj në shpinë, e kuptova se projekti i Civilit, për kthimin e shpresës, po korr sukses... Sepse e ka patjetër. Thjesht, sepse s’ka alternativë. Maqedonia e ka patjetër të shkojë përpara! Drejt lirisë...

(Sinisha Stankoviqi është gazetar dhe shkrimtar, kryeredaktor i CIVIL Media – njësi organizative e CIVIL – Qendrës për Liri.)

REKOMANDIME

(PARA)ZGJED-

HORE TË CIVILLIT



Konferencë: "Zgjedhje të lira" (22.11.2016)

REKOMANDIME (PARA)ZGJEDHORE TË CIVILIT

Publiku duhet ta ketë në dijeni se CIVIL – Qendra për Liri në mënyrë shumë aktive përpiket të japë kontribut drejt zgjidhjes së krizës politike nga vetë fillimi në vitin 2008 dhe sidomos pas eskalimit në fillim të vitit 2015.

Civili u involvua në vëzhgimin e zgjedhjeve në vitin 2008 dhe fitoi një përvojë të madhe në këtë fushë, duke ofruar qasje dhe metodologji të reja të cilat korrespondojnë me realitetin në vend. Kriza politike, sipas nesh, filloi që në vitin 2008 dhe vazhdonte të thellohet, sidomos pas largimit të dhunshëm të deputetëve opozitar më 24 dhjetor 2012. Pas daljes në shesh të bisedave të përgjuara të kryera me urdhër të qeverisë, të cilat i zbardhi opozita, bashkësia ndërkombëtare ofroi asistencë dhe ndërmjetësim, e cila rezultoi me nënshkrimin e marrëveshjeve politike më 2 qershor dhe 15 korrik.

Civili publikoi analiza dhe rekomandime të shumta për procesin në tërësi, duke përfshirë edhe ato për procesin zgjedhor. Këtu është e rëndësishme të rikujtojmë se Civili zbuloi një numër të madh të mashtrimeve zgjedhore në raportet e veta “Lufta e paskrupullt për pushtet” për zgjedhjet lokale në vitin 2013 dhe “Demokraci e diskualifikuar” për zgjedhjet

presidenciale dhe ato të parakohshme parlamentare në vitin 2014. Bisedat e përgjuara të cilat i publikoi opozita janë një dëshmi e hidhur e zbulimeve tona për zgjedhjet, si dhe të raporteve të shumta për gjendjen me të drejtat e njeriut në vend, të cilat i publikuam gjatë dekadës së kaluar.

Këtu dëshirojmë t'i paraqesim rezymetë e rekomandimeve tona kryesore të publikuara gjatë periudhës së kaluar, me qëllim që t'ia rikujtojmë publikun vendas dhe atë ndërkombëtar për problemet më të mëdha të cilat duhet të zgjidhen ose janë në proces të zgjidhjes.

NJË NJËSI ZGJEDHORE; LISTA TË HAPURA; VOTIMI I DIASPORËS

Maqedonia duhet të jetë një njësi zgjedhore, me lista të hapura të kandidatëve në zgjedhje. Këto zgjedhje u ofruan në publik një kohë të gjatë, por u injoruan nga partitë në pushtet. Modeli zgjedhor i Republikës së Maqedonisë ka ndryshuar shumë herë, por kurrë nuk u morën në shqyrtim zgjidhje të cilat do të sjellin deri te përfaqësimi i të gjitha bashkësive dhe i partive të vogla politike, siç është modeli sipas të cilit i tërë vendi do të jetë një njësi zgjedhore.

Njëkohësisht, listat e hapur të kandidatëve do të sigurojnë një demokraci më të madhe brenda partive dhe më e rëndësishmja se kjo është se do ta rrisin përgjegjësinë e deputetëve ndaj trupit votues.

Votimi i diasporës duhet të rridefinohet dhe të mundësohet në mënyrë që do të barabësohet vlera e votës së të shpërngulurve me atë të votuesve në vendin amë. Kjo do të arrihet në mënyrë më efikase nëse të shpërngulurit votojnë në një njësi zgjedhore, kjo është Maqedonia.

Civili ofroi edhe zgjidhje të tjera në kuadër të sistemit zgjedhor në vend dhe do të vazhdojë me përfaqësimin e tyre para të gjitha qytetarëve dhe qytetarëve, jo vetëm pjesëmarrësve në negociata prapa dyerve të mbyllura.

Propozojmë zgjidhje konkrete , me masa të thjeshta dhe të qarta, të cilat duhet patjetër të ndërmerren që të eliminohen mangësitë serioze të sistemit zgjedhor, për të pasur së paku një shtet normal.

Kuptohet, jemi të vetëdijshëm se nevojitet një vullnet politik dhe vyrstit për sjelljen dhe realizimin e tyre.

ZGJIDHJE PËR GJENDJE KATASTROFALE ME LISTËN ZGJEDHORE

Lista zgjedhore është në gjendje katastrofale. Civili në zgjedhjet e vitit 2013 dhe 2014 e shpalosi problemin me hyrjet, ndërtesat, banesat e shpikura, i gjeti votuesit e paqenë, ia doli ta zbulojë intervenimin demografik dhe operacionin “Pustec” dhe një sërë problemesh të tjera të cilat u siguruan një votim të paharrueshëm qytetareve dhe qytetarëve në ciklet zgjedhore nga viti 2008 e këtej. Si përkujtim për këto zgjedhje jashtëzakonisht të mundimshme dhe të turpshme, mund të shërbejnë raportet “Lufta e paskrupullt për pushtet” i vitit 2013 dhe “Demokraci e diskualifikuar” i vitit 2014.

Prandaj, e përkrahim modelin e regjistrimit aktiv të votuesve, i cili duhet të jetë i obligueshëm për të gjithë. Në këto suaza, duhet të përmirësohet Ligji për paraqitjen e vendbanimit dhe vendqëndrimit, që të shmangen manipulimet plotësuese me numrin e votuesve dhe intervenimin demografik. Problemi me dokumentet e shumëfishta i cili u paraqit gjatë zgjedhjeve vitin e kaluar do të tejkalohet me vënien e shenjës me gisht gjatë regjistrimit aktiv.

REFORMA NË KOMISIONIN SHTETËROR ZGJEDHOR (KSHZ)

Reformat në KSHZ janë me rëndësi thelbësore për zgjedhjet. Ne besojmë se Komisioni Shtetëror Zgjedhor duhet të jetë një trup profesional i përbërë nga ekspertë të vendit dhe të huaj dhe përfaqësues të shoqërisë qytetare, jo nga përfaqësues partiak. Duke pasur parasysh rrethanat, reforma e këtillë thelbësore duket e pamundur në këtë periudhë, por duhet pasur parasysh që në një të afërme të afërt kjo edhe të zbatohet.

Në rast se reforma e tillë s'është e mundur në këtë periudhë, me rëndësi është që opozita të ket shumicë në Komisionin Shtetëror Zgjedhor, që të sigurohen kushte për zgjedhje të lira. Kjo shumicë duhet të jetë e realtë dhe jo fiktive, siç ishte rasti me përbërjen e deritanishme të KSHZ, kur opozita praktikisht ishte pakicë.

Njëkohësisht, KSHZ duhet të jetë bartësi kryesor i proceseve zgjedhore i të gjitha masave dhe projekteve lidhur me procesin zgjedhor. Ingerencat e KSHZ duhet të rriten edhe realisht, jo vetëm në letër. Njëra nga ingerencat më të rëndësishme e KSHZ duhet të jetë Lista Zgjedhore, siç është rasti me Ministrinë e Punëve të Brendshme.

REFORMA E SERVISIT PUBLIK RTVM DHE AMSHAA

Vetëm me reformimin e servisit publik RTVM efekti do të jetë minimal, sepse edhe më tej do të mbeten praktikat korruptive sa u përket medieve të tjera në vend, ndikimi i të cilëve është shumë më i madh.

Rrjedhimisht, nevojitet një kontroll i Agjencisë Mediatike për Shërbime Audio dhe Audio-Vizuale, ndërsa Agjencinë për Komunikime Elektronike (AKE) ta marrë opozita, në bashkëpunim me ekspertët e pavarur dhe shoqërinë qytetare.

VETËM ZGJEDHJET E
LIRA JANË NJË SHANS
PËR TË RIVENDOSUR
SUNDIMIN E LIGJIT



Interesim i madh i publikut në çdo eveniment të CIVIL kushtuar procesit zgjedhor (fotor regjistrim nga konferenca: "Zgjedhje të lira 2016" (22.11.2016)

VETËM ZGJEDHJET E LIRA JANË NJË SHANS PËR TË RIVENDOSUR SUNDIMIN E LIGJIT

Fuqishëm jemi të bindur se afati i dhënë për përgatitjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në prill të vitit 2016 është shumë e shkurtër. Rekomandimi ynë i fuqishëm është që të zgjatet kjo periudhë deri në 18 muaj ose më shumë, me qëllim që të krijohen kushtet e nevojshme për zgjedhje të lira. Më saktësisht, rekomandojmë që kjo periudhë të llogaritet nga data e formimit të qeverisë së përkohshme – ishte një nga rekomandimet e Civil – Qendrës për Liri, të botuara më 9 qershor 2015, me të cilat kërkuam masa urgjente për tejkalimin e krizës politike dhe kthim të demokracisë në Republikën e Maqedonisë.

Shtatë muaj më vonë, Maqedonia ende është e shqyer nga kriza politike, e plotësuar me fushata politike agresive dhe të pista, presion të fuqishëm mbi trupin votues, manipulim mediatik dhe keqpërdorim të resurseve dhe administratës publike. Situata në Maqedoni nuk përmirësohet, ndërsa partitë në pushtet mbeten të shurdhëra për të gjitha kërkesat dhe rekomandimet e CIVIL-it dhe të një sërë organizatave relevante të shoqërisë civile dhe

ekspertëve. Partitë në pushtet vazhdojnë të shkelin të drejtat e njeriut dhe të ngulfatin lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias.

Përkundër marrëveshjes për tejkalimin e krizës politike (Përzihino 2 qershor /15 korrik) me ndërmjetësimin e bashkësisë ndërkombëtare, me të cilën kryeministri Nikolla Gruevski mori obligimin për të zbatuar reforma urgjente në fusha kyçe lidhur me sundimin e ligjit, mediet dhe proceset zgjedhore, ato jo vetëm që nuk janë zbatuar, por abuzimet dhe sundimi jodemokratik vetëm u thelluan gjatë vitit të kaluar.

Civili edhe para nëntë muajve kërkoi dorëheqjen e mbarë Qeverisë, si përfundim i vetëm i logjikshëm i krizës politike, përgjegjësi për abuzimet dhe krimin për të cilin ka indikacione në bisedat e përgjuara që i publikoi opozita, e pastaj të krijohet një qeveri e përkohshme ekspertësh që do të zbatojë reforma të shpejta, por edhe thelbësore.

Ky proces nënkupton rishikimin e Kodit Zgjedhor, ndryshimin e sistemit zgjedhor me të cilin Maqedonia do të jetë një njësi zgjedhore si dhe inkuadrimin e listave të hapura, pas-trimin dhe përmirësimin e Listës së Votuesve, reformë e Komisionit Shtetëror Zgjedhor, ndarje e partisë nga shteti, reforma në medie dhe rregullimin mediatik, me qëllim të eliminimit të diktateve partiake mbi mediet, formim i një komisioni apo institucioni për hetim bazuar në bisedat e përgjuara, hetim për krizën në Kumanovë, ndërsa në fund të këtij procesi – të zbatohen zgjedhje të lira.

Negociatat nuk japin rezultate, ndërsa në pushtet mbetet pjesa më e madhe e strukturës mbi të cilën as që mund dikush të mendojë për të zbatuar çfarëdo forme të kontrollit demokratik dhe qytetar. Kjo është struktura që është drejtpërdrejt përgjegjëse për krizën politike shumëvjeçare dhe erozionin e demokracisë, sundimin e ligjit dhe të drejtave të njeriut.

Me pak fjalë, me zbatimin e këtyllë të marrëveshjes politike, agonia e Republikës së Maqedonisë vetëm se ka vazhduar.

Më saktësisht, mbeti në funksion makineria me të cilën drejtojnë Nikolla Gruevski dhe kushëriri i tij Sasho Mijalkov, i cili vetëm formalisht u largua nga funksioni drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim. Regjimi i Nikolla Gruevskit vazhdoi praktikën e mirënjohura të shpërdorimit të resurseve publike dhe administratës, me korrupsionin politik dhe manipulimet mediatike.

Të prirur nga përvoja e vëzhgimit afatgjatë të zgjedhjeve, të proceseve sociopolitike dhe gjendjeve me të drejtat dhe liritë e njeriut në Maqedoni, Civili edhe para nëntë muajve insistonte në zbatimin e masave prioritare, që ndërliidhen me një sërë kërkesash të tjera, të cilat nuk u diskutuan fare gjatë negociatave.

Civili kërkon dhënien fund të persekutimit politik që nga viti 2010, lirinë e të gjithë të burgosurve politikë dhe mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme presidenciale dhe lokale bashkë me zgjedhjet parlamentare, atëherë kur do të ketë kushte minimale që ato të jenë të lira.

Për fat të keq, dështuan të gjitha përpjekjet që përfaqësues të shoqërisë civile, duke përfshirë edhe ata të Civilit, që procesi për të kapërcyer krizën politike të jetë transparent dhe të përfshijë më shumë palë të prekura, e jo vetëm liderët e katër partive politike kryesore.

Të përkujtojmë, kriza politike zgjat që nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2008, ndërsa arriti kulmin gjatë “të hënës së zezë” më 24 dhjetor 2012, me dëbimin e dhunshëm të deputetëve të opozitës dhe gazetarëve nga parlamenti në mënyrë që, me çdo kusht, të aprovohet Buxheti jashtëzakonisht i lartë në Maqedoninë gjithnjë e më të varfër.

Nëse shikohet përvoja e Civilit vetëm në tre vitet e fundit, e të mos përmendim organizatat tjera të shumta dhe institucionet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, vërehet se alarmi është nderur që moti. Civili zbuloi shumë mashtrime zgjedhore në raportet “Luftë e paskrupullt për pushtet” në 2013 dhe “Demokracia e diskualifikuar” në vitin 2014, pas të cilëve pasuan analizat e shumta dhe rekomandime mbi situatën e të drejtave të njeriut dhe proceseve sociopolitike. Në këtë kuptim, mund të veçohet analiza dhe shqyrtimi i sfi-dave dhe rekomandimeve i publikuar më 17 shtator “Rasti Maqedonia: të përkujtohem”, si dhe raportet e paradokohshme që kishin të bëjnë me presionet brutale politike mbi të punësuarit në administratën publike dhe ndërmarrjet publike, si dhe forcimi i presioneve të partive politike mbi kuadrin arsimor.

Negociatat e katër liderëve të partive kryesore parlamentare me të vërtetë sollën deri te nënshkrimi i marrëveshjes politike, mirëpo opstruksionet nga ana e qeverisë për zbatimin e saj, e rrezikojnë edhe më tej vetë idenë e mbajtjes së zgjedhjeve të lira më 24 prill.

Thjesht, marrëveshja për zgjidhjen e krizës politike është shndërruar në një shpërblim për kryeministrin Gruevski, një mjet për të zgjatur jetën e tij politike dhe për të ruajtur politikat dhe praktikat jodemokratike në vend.

Pushteti vazhdon me presionet, shantazhet dhe kërcënimet ndaj opozitës dhe qytetarëve të pavendosur, Gruevski i jep forcë fushatës së tij përmes medieve, merr borxhe dhe sillet papërgjegjshëm e dorëshlirë me paratë e taksapaguesve me të cilat, në fakt, vetëm blen besnikërinë e tyre. Për më tepër, me fushatë të shtrenjtë dhe të pistë, ai demonizon opozitën, shoqërinë civile, e jo rrallë edhe komunitetin ndërkombëtar.

Njëra nga poentat kryesore të popullizmit agresiv të Gruevskit është të tregojë se gëzon mbështetje të gjerë popullore, se sundimi i tij ishte më shumë se kaq, se ai është shpëtimtari. Kjo nuk është edhe aq e vështirë për t'u arritur, duke pasur parasysh burimet e pakufizuara të cilat ai ka përvetësuar. Kështu, përveç zbatimit të politikave kriminale, ai i kriminalizon edhe marrëdhëniet në shoqëri, ndërsa vetë qytetarët i bën bashkëpunëtorë në prapësinë e tij.

Prandaj, rekomandimi i vetëm që në këtë moment mund të jepet për komunitetin ndërkombëtar, deri te Uashingtoni dhe Brukseli, është që të japin dritën e gjelbër për shtyerjen e zgjedhjeve, por pa anulim të afatit për dorëheqjen e kryeministrit Gruevski.

PRESION

BRUTAL

POLITIK



PRESION BRUTAL POLITIK

Raportet për diskriminimin, mobingun dhe kërcënimet në bazë të përkatësisë politike janë intensifikuar pikërisht pas nënshkrimit të Marrëveshjes për tejkalimin e krizës politike më 2 qershor dhe 15 korrik 2015. Raportet e CIVIL – Qendrës për Liri përgatiten në bazë të deklaratave të qytetareve dhe qytetarëve në mënyrë elektronike apo personalisht, në takime me përfaqësues të shoqërisë civile, të punësuar në sektorin publik, por edhe në atëe privat, partive politike në nivel lokal, në seminare për trajnime dhe në shumë baza tjera.

Informata për presione politike arrijnë nga anembanë vendit. Ky raport është edhe një në serialin e gjatë të raporteve dhe informatave të cilat Civili i publikon me vite dhe bazohet në më shumë dëshmi për presion brutal politik në më shumë komuna në vend.

Fotografi, video përmbajtje dhe deklaratat anonime nga më shumë burime flasin për keqpërdorim sistematik dhe presion në bazë politike, me qëllim të kontrollimit të trupit votues. Bashkëbiseduesit tanë thonë se presin presione edhe më të mëdha përballë zgjedhjeve.

Ekipi hulumtues i Civilit erdhi deri te fotografi nga SMS-a dhe lista në të cilat duhet të gjinden “votues të sigurt”, si dhe korrespondenca nga rrjetet sociale. Burimet tona janë kategorikë se duan të mbesin anonim, nga frika se ata dhe më të afërmit e tyre mund të ballafaqohen me presione edhe më të mëdha, me përjashtime nga puna dhe me një sërë “dënimesh” të tjera të parapara për të padëgjueshmit.

Të punësuarit në komuna, shkolla fillore dhe të mesme, kopshte të fëmijëve, ndërmarrje komunale dhe një sërë institucionesh në nivel lokal dhe qendror janë në shënjestër të përpunimit politik sistematik të agjit-propit.

Për Civilin jep dëshmi edhe një avokat në një nga komunat më të mëdha në Maqedoni, i cili thotë se kohën e fundit rritet numri i të punësuarve në sektorin publik, të cilët te ai kërkojnë mbrojtje nga presionet politike nga ana e kuadrit udhëheqës. Sipas burimit tonë, të punësuar në ndërmarrësit publike deklarojnë se shefat e tyre i ftojnë në shtabe partiake dhe në komuna dhe aty marrin urdhra që t’i detyrojnë punëtorët të përpilojnë lista me nga 5-6 apo më shumë qytetarë politikisht të papërcaktuar. Ky “operacion” ka për qëllim të ndikojë te votuesit e papërcaktuar të votojnë për partinë në pushtet në zgjedhjet në prill vitin e ardhshëm.

Burimet thonë se këto presione janë edhe më agresive në krahasim me vitet e kaluara. Të punësuarit obligohen që personave udhëheqës në ndërmarrjet publike t’u dorëzojnë lista, në të cilat duhet të japin emra, mbiemra dhe numra telefoni.

Të punësuarve në ndërmarrjet publike dhe në administratën publike, më së shpeshti u kërcënohen me largim nga puna apo largim nga puna të më të afërmeve të tyre, të punësuar në të njëjtin apo në ndonjë tjetër institucion apo ndërmarrje publike. Atyre, të cilët kanë kontrata me afat të caktuar, u kërcënohen se nuk do t’ua vazhdojnë. Gjithashtu, të punësuarit të cilët nuk do të dorëzojnë lista degradohen ose zhvendosen në vende pune, me të cilën gjë u vështirësohet puna.

Presioni politik në administratën publike dhe në ndërmarrjet publike shoqërohet me llojet më të ndryshme të diskriminimit dhe mobingut mbi të punësuarit, që është në kundërshtim me Ligjin për Administratë dhe që është vepër penale kundër Ligjit për zgjedhje dhe procesin zgjedhor.

Mobingu deri më tani ka raste të rralla me përfundim gjyqësor, kështu që mënyra e vetme për ta mbrojtur vendin e vet të punës dhe ekzistencën themelore për të punësuarit në

administratën publike është që të nënshtrohen dhe të bëhen bashkëfajtorë në shkeljen e ligjeve, ashtu siç i detyrojnë udhëheqësit e vendosur prej partisë.

Të punësuarit në sektorin publik nuk janë viktimat e vetme të presionit politik. Nën presionin politik janë të eksponuar edhe punëtorët në kompanitë private.

Presionet, të cilat i vuan sektori privat, janë një rrëfim në vete, varësisht nga presionet që bëhen nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave Publike. Si afrohet koha e zgjedhjeve, presionet do të intensifikohen.

Nuk është e njohur a ka marrë guximin ndonjë qytetar të iniciojë procedurë kundër presioneve politike, në përputhshmëri me rregullat ligjore.

*

Ekipi hulumtues dhe vëzhguesit afatgjatë të Civilit erdhën deri te një sërë informatash dhe dëshmish për atë se si kryhet presion i vazhdueshëm politik edhe ndaj kuadrit mësimdhënës në disa shkolla fillore dhe të mesme anembanë vendit. Më saktë, Civili mori dëshmi konkrete për situatën e vështirë të kuadrit mësimdhënës në pesë komuna të mëdha jashtë Shkupit, si dhe në katër institucione arsimore në kryeqytet.

Kuadri mësimdhënës në vitet e fundit gjendet në një situatë të vështirë, ndërsa presionet që janë kryer, mësimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme i kanë sjellë në pozitë nënçmuese. Ky raport bazohet në dëshmi dhe në dokumentacionin që na e dhanë bashkëbiseduesit tanë të shumtë që insistonin të mbeten anonim, nga frika se mund të humbin punën e tyre. Megjithatë, u shprehim mirënjohje për atë se më në fund guxuan të flasin dhe të na ndihmojnë për ta shpalosur politikën dhe praktikën skajshmërisht të dëmshme të pushtetit, i cili tërësisht e partizoi arsimin në vend.

“Me aq shumë ndryshime sipërfaqësore në ligje, me të gjitha ata projektet për çdo fëmijë dhe çdo mësues, me aq shumë reforma të qeverisë, ne arriam ta kemi arsimin në një situatë të mjerueshme”, thotë një profesreshë e shkollës së mesme.

Mësimdhënësit ballafaqohen me një numër të madh të procedurave diskriminuese, me presione, shantazhe dhe kërcënime, kryesisht në bazë të përkatësisë politike të viktimave të praktikave të tilla. Kur flitet për përkatësinë politike, është e dukshme dhe e theksuar se shumë prej bashkëbiseduesve tanë, në fakt, janë politikisht të papërcaktuar, por kanë trajtim të barabartë si mbështetës të opozitës. Në disa raste, ekipi ynë ka marrë raporte

nga dëshmitarë të cilët pohojnë se të papërcaktuarit politikisht i nënshtrohen presionit akoma më të madh sesa mbështetësit e opozitës.

Sa i përket sistemit arsimor, është e dukshme një gjendje në të cilën në vend që të kryejnë punën e tyre, mësime të cilëve janë të stërngarkuar me të gjitha llojet e përgjegjësi administrative dhe përballen me presione, shantazhe dhe kërcënime të llojllojshme. Pikërisht kjo i inkurajoi aktivitetet e mësuesve, të cilët njohën politikën fatale arsimore të qeverisë dhe kërkuan ndaljen e reformave të këqija në arsim. Ata dolën në mbështetje të nxënësve të tyre, ndërsa fituan mbështetjen e prindërve të shumë nxënësve.

Por, në vend se t'u dalë krah nevojave të nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve, qeveria nxitoi për të krijuar një fushatë të pistë kundër protestuesve, ndërsa aktivizmin qytetar të kuadrove mësime të nxori jashtë ligjit. Ata mësime të cilëve që guxuan të ngrihen për kërkesat e studentëve për arsimim më të mirë dhe kundër reformave të këqija, u ndeshën me presione, dënime, si dhe emërtime e etiketime të ashpra.

“Vazhdimisht ka presione, të çfarë do lloji. Për shembull, pas aktivitetëve të Plenumit të Mësime të cilëve, te drejtori ka një listë të saktë me pjesëmarrësit. Drejtori i thërret të gjithë në bisedë individuale, në të cilën ‘të pandehurit’ kërcënohen dhe fyhen në mënyrë vulgare. Çdo angazhim në plenum ose në ndonjë nga organizatat e “etiketuara”, siç është organizata CIVIL, denoncohet si tradhëti, dhe këto iniciativa dhe organizata janë quajtur me emra të ndryshme, si ‘jolegjitime, të pabesë, kriminelë, sorospi, forca të errëta’ e të tjera. Dhe ju patjetër duhet të qëndroni dhe t'i dëgjoni këto”, dëshmon një grup i mësuesve në një komunë në Maqedoni.

Për shkak të “papërshtatshmërisë politike” dhe “mosbindjes” ndaj udhëheqësve partiakisht të vendosur në shkollat, kuadrot mësime ballafaqohen me gjopa dhe pushim nga puna, ndërprerje të kontratave të punës, reduktim drastik të fondit të orëve apo të pagës. Përveç nga drejtuesit, mësuesit “të pabindur dhe të papërshtatshëm” janë të mbikëqyrur dhe shpesh gjenden nën presionin e ushtarëve partiakë mes kolegëve të vet.

Njëkohësisht, të gjithë punonjësit e institucioneve arsimore, në të cilët kemi burimet tona, kuptojmë se janë nën presion për të hartuar listat e “votuesve të sigurt”, siç është rasti me të punësuarit edhe në pjesë tjera të administratës publike dhe të ndërmarrjeve publike, siç publikuam më parë në raportin me titull “Civilizimi zbulon raste të presionit brutal politik.”


Qeveria zbaton kontroll dhe presion politik në arsim nëpërmjet ministrisë përkatëse, veçanërisht përmes Byrosë për Zhvillim të Arsimit, e cila kryen vizita dhe inspektime intenzive të pazakonshme. Zakonisht këto inspektime paralajmërohen, por kjo bëhet vetëm për mësimdhënëst e “përshtatshëm”, por jo dhe për mësimdhënësit tjerë.

Sipas burimeve tona, disa ndihmës-drejtorë dhe kujdestarë të klasave në shkollat e mesme janë shkarkuar, gjegjësisht u janë marrë klasat, për shkak të mbështetjes së Plenumit të Gjimnazistëve.

CIVIL – Qendra për Liri shumë herë në publik del me apel deri te punësuarit në administratën publike të ballafaqohen me presionet politike dhe t’i paraqesin rastet e këtilla në organizatën tonë.



CIVIL KËRKON QË
INSTITUCIONET
DHE PARTITË
POLITIKE T'I
NDËRPRESEN
KEQPËRDORIMET
DHE PRESIONET



CIVIL KËRKON QË INSTITUCIONET DHE PARTITË POLITIKE T'I NDËR- PRESIN KEQPËRDORIMET DHE PRESIONET

CIVIL- Qendra për Liri ka shpallur raportin periodik nga vëzhgimi i procesit zgjedhor. Raporti paraqet një sublimat mbi bazë të seleksionimit të shkurtë nga raportet e vëzhguesve afatgjatë të CIVIL, nga paraqitjet në onlajn formularin në ueb faqen Zgjedhje të Lira dhe nga Qytetaret dhe qytetarët gazetarë.

KOMISIONI SHETËROR ZGJEDHOR DHE LISTA E VOTUESVE

Qytetaret dhe qytetarët e Republikës së Maqedonisë kanë të drejtë të dinë se çfarë po ndodh me paratë e tyre të cilat janë dhënë në dispozicion Komisionit Shtetëror Zgjedhor dhe të gjitha institucionet tjera dhe partitë politike në vend.

Në vend të kësaj, shënojmë mungesë të plotë në proceset të cilat në këtë moment po afrohen nga përfundimi i tyre, në pritje të zgjedhjeve të caktuara për vetëm një muaj nga sot.

Revizioni i Listës Zgjedhore nuk jep rezultate. Te mbi 200 raste të votuesve fantazma, të dërguara deri te CIVIL gjatë muajve të pranverës së këtij viti, shënojmë se janë të zgjidhura vetëm dy raste, gjegjësisht, se korrigjuar të dhënat. Dy nga dyqind! Mirëpo, edhe më brengosës janë rastet kur votuesit fantazma janë të larguar nga adresa të caktuara, që për më tej, në të njëjtat adresa të paraqiten votues plotësisht të ri. Këto raste janë të paraqitura në CIVIL, pasi që qytetaret dhe qytetarët e prekur kanë paraqitur ankesa deri te KSHZ dhe deri te shërbimet burimore. Ato, gjithashtu lajmërojnë se janë trajtuar si topa ping-pongu mes institucioneve.

Rast i veçantë janë emigrantët të cilët ende figurojnë në Listën Votuese, ndërsa jetojnë jashtë vendit për më shumë se 20 vite. Edhe pse kuptuam se ekzistojnë paraqitje dhe ankesa për numër të caktuar të emigrantëve për largim nga lista, gjegjësisht, vendosjen e tyre në listë të veçantë, emrat e tyre ende gjenden në Listën e Votuesve, por jo në Listën e Votuesve me emigrantë. Gjithashtu, qytetaret dhe qytetarët ankohen se procedura nuk është e qartë, ndërsa të reagimet e të dhënave për statusin e paraqitjeve të tyre ose janë të thata ose mungojnë.

Një anëtare e ekipit vëzhgues të CIVIL ka bërë kërkime të hollësishme për procedurat të cilat i mundëson KSHZ për pjesëmarrjen e qytetareve dhe qytetarëve në revizionin e Listës së Votuesve, që për momentin është në kontrollim te ekipi juridik i organizatës, e të cilin pas hulumtimit, do ta publikojmë.

Në këtë kontekst, dëshirojmë të theksojmë se KSHZ dhe institucionet tjera kompetente duhet të jenë të vetëdijshme se për momentin mbështeten tepër në ndihmën e qytetareve dhe qytetarëve të vendit tonë, ndërsa, si shpërblim, nuk ofrojnë as minimumin e transparencës dhe cilësisë të shërbimeve. Përkundrazi, të ardhurat e tyre janë fantastike, ndërsa shpenzimet e rrugës për të cilat kanë kërkesa nga buxheti i KSHZ, janë sikur jetojnë në ndonjë nga planetet fqinje.

CIVIL ka konstatuar se procedurat dhe kompetencat në këtë proces, shpesh ndryshojnë dhe nuk janë plotësisht të qarta. Pavarësisht nga fushata dinamike për informimin e publikut dhe mirësjelljes së stafit të KSHZ dhe institucioneve tjera të cilat tentojnë të shpjegojnë se cilat janë të drejtat e qytetareve dhe qytetarëve më procesin e revizionit të Listës së Votuesve, shumë pyetje mbeten pa përgjigje, ndërsa qytetaret dhe qytetarët enden nëpër labirintet e institucioneve jo efikase dhe njësisive të tyre rajonale.

Ekipet tona vëzhguese dhe hulumtuesit kanë arritur deri te një numër i madh i rasteve në të cilat shtëpi të braktisura dhe rrënimë, mbase edhe objekte jo-ekzistuese, janë vendbanime të votuesve fantazma. Tregimi që vjen nga Prilepi, për votues të regjistruar në adresën e shtëpisë së braktisur dhe rasti me parkingun në Tetovë, janë vetëm ilustrim për gjendjet të cilat vërehen në tërë vendin.

Publiku duhet të dijë se ku janë të vendosur tani dhjetëra banorët e Pustecit, të cilët paraprakisht ishin të zbuluar në adresën në rrugën “Maksim Gorki” në qendër të Shkupit. Në cilat adresa gjenden votuesit në shumë raste të këtilla? Duam të dimë dhe kemi të drejtën të dimë, ndërsa institucionet janë të obliguara të përgjigjen!

Për më tej, në CIVIL kanë arritur paraqitje për adresa të dyfishta në vendbanim të njëjtë, me banorë të ndryshëm, nga të cilët një palë me të vërtetë ekzistojnë, ndërsa tjerët, jo. Çfarë po ndodh?

KEQPËRDORIMI I MË TË VARFËRVE PËR QËLLIME ZGJEDHORE

Keqpërdorimi i çështjeve lidhur me drejtësinë sociale në Republikën e Maqedonisë është famëkeq dhe me traditë të gjatë në proceset dhe kontekstet zgjedhore. Për më saktë, partitë politike rregullisht manipulojnë me pritjet e votuesve në vend

I tërë konteksti politik dhe shoqëror është i vendosur në kontekst zgjedhor, i shoqëruar me shkundje të rënda politike, kohë pas kohe me sfida të sigurisë dhe tensione, si dhe procese të shpeshta zgjedhore, mes të cilave edhe tre zgjedhje të jashtëzakonshme parlamentare në afat prej tetë vitesh. Të gjitha proceset e jashtëzakonshme zgjedhore mbahen në gjendje të mprehura në të gjitha sferat e shoqërisë dhe shtetit, të shoqëruara me shkelje serioze të të drejtave të njeriut, mungesë të demokracisë dhe të sundimit të së drejtës.

Opinionimi botëror dhe i vendit për një kohë të gjatë janë të njoftuar me faktet për sundimin e koalicionit qeveritar në Republikën e Maqedonisë. Ky sundim është i shoqëruar me indikacione serioze dhe dëshmi materiale për keqpërdorime të rënda kriminale të pushtetit, dhunë strukturore, korrupsion politik dhe vjedhje zgjedhore të cilat në tërësi e zbërthejnë indin shoqëror dhe sistemin politik në vend.

Në këto kushte, qëllimi kryesor i strukturave sunduese, është të mbahet dhe të forcohet pushteti, gjegjësisht, fuqia dhe kontrolli. Kjo arrihet me partizim të ashpër, me skllavërim të shtetit dhe shoqërisë. Me kontrollin mbi financat dhe ekonominë, strukturat sunduese e kishin lehtë të vendosin praktikë të lartë korrupsioni të blerjes së vazhdueshme të dashurisë së votuesve, në kombinim me dhunën strukturore dhe manipulimin e ashpër mediatik. Premtimet joreale, shpesh kufizohen me keqpërdorimin kriminal të resurseve publike, buxhetit dhe administratës në periudhat mes dy proceseve zgjedhore, që më vonë kjo të shndërrohet në keqpërdorim të hapur dhe sistematik dhe sundim kundër demokratik.

Sistemi shoqëror-politik është i nokautuar, e me të nokautohen edhe të gjitha vlerat në të cilat mund të mirëmbahet dhe zhvillohet demokracia dhe sundimi i të drejtës. Për këtë arsye, shema gjithëpërfshirëse e keqpërdorimeve të pritjeve të qytetareve dhe qytetarëve,

pavarësisht se sa është i qartë mashtrimi dhe kriminaliteti, duket si dukuri normale dhe e përditshme. Kjo nënkupton se premtimet për gjëra të cilat veç më u takojnë qytetareve dhe qytetarëve, sipas Kushtetutës dhe ligjeve, i përshkruhen lëmoshës së Partisë e cila silltet si pronar i jetës, privatësisë dhe synimeve të njerëzve. Ndasitë në të përshtatshëm dhe të papërshtatshëm bëhen kritere për atë se kush do të pranojë ndihmë sociale ose punësim për rrogë të mjerueshme dhe kushte të rënda, shndërrohen në arritje të lartë të politikës sociale të strukturave qeverisëse.

Pikërisht në domenin e çështjeve lidhur me drejtësinë sociale, pritjet qëllimisht rriten edhe atë në stil të korrupsionit të lartë. Korrupsioni politik është rrënjosur thellë në të gjitha poret e shoqërisë dhe shtetit, si në nivel lokal, ashtu edhe në atë social.

Këto praktika dhe politika sjellin deri në gjendje në të cilën proceset zgjedhore janë problematike dhe jo -legjitime, edhe nëse zhduken të gjitha manipulimet dhe keqpërdorimet tjera dhe vjedhjet e votave.

Krijimi i pritjeve joreale me premtim për punësim ose kushtëzimin e benefiteve sociale me lojalitet ose me votë në zgjedhje, janë forma më e shpeshtë e keqpërdorimit të qytetareve dhe qytetarëve të rrezikuar socialë. Shumë nga premtimet paraqesin diskriminim dhe keqpërdorim dhe vendosje praktike të korrupsionit politik në masa të mëdha, në të gjitha nivelet. Këtë, në këto kushte, mund ta zbatojnë vetëm partitë të cilat realisht janë pronare të pushtetit dhe kanë në dispozicion paratë e qytetareve dhe qytetarëve. Me këtë sjellje, partitë në pushtet paraprakisht manipulojnë me rezultatin zgjedhor, e shkelin Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë, dhe e ngushtojnë hapësirën e votuesve për shprehjen e lirë të vullnetit të tyre në ditën e zgjedhjeve.

PRESIONE, KUSHTËZIME DHE KËRCËNIME

CIVIL ka shënuar qindra raste të presioneve dhe kërcënimeve mbi qytetarët dhe qytetarët në tërë vendin. Pavarësisht nga përparimet formale në zbatimin e marrëveshjes politike mes katërshes udhëheqëse partiake, vërehet shkelja e të drejtave dhe lirive të njeriut në kontekst zgjedhor, dhuna strukturore dhe diskriminimi politik me tempo pothuajse të njëjtë.

NUK KA PËRPARIM NË SFERËN E MEDIAVE

CIVIL nuk vëren përparim thelbësor në sferën e mediave. Vazhdojnë shprehja e urrejtjes, thirrjet për ekzekutim të mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe fushata e fëlliqur e cila zbatohet përmes mediave të caktuara dhe apologjetë të eksponuar mediatik të pushtetit. CIVIL ka shënuar shprehje të urrejtjes edhe nga botime të caktuara interneti, të afërta me opozitën.

PENGESA NGA GJYKATA PENALE

Është brengosëse edhe sjellja e Gjykatës penale në Shkup, e cila përnjëherësh ka problem të jep vërtetime me kohë, për mos konviktësi të kandidatëve të Partisë Liberale dhe të LSDM. Kërkojmë përgjegjësi për ata që i bëjnë këto pengesa dhe i ftojme punëtorët e ndërgjegjshëm të administratës të ndajnë me ne fakte për keqpërdorime të administratës në këtë proces. U garantojmë anonimitet të plotë atyre që do të paraqesin raste të keqpërdorimeve dhe presioneve në administratë.

KEQPËRDORIM I RESURSEVE PUBLIKE DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Keqpërdorimi i resurseve publike është i vërejtur në numër të madh të rasteve në tërë vendin. Në rastin e fundit, me transportin e pjesëmarrësve në tubimin e Bashkimit të Grave të partisë qeverisëse me autobusë të JSP Shkup, vërehet heshtja e ndërmarrjes publike për atë se kush ka paguar për këtë shërbim. Gjithashtu, përdorimi i automjeteve zyrtare për qëllime partiake është evidente dhe duhet të ndërpritet.

Kërkojmë nga institucionet që ta respektojnë Ligjin për mbrojtje të të dhënave personale dhe të mos i ndajnë me shtabet partiake. Deri te CIVIL kanë arritur paraqitje prej të cilave shihet qartë se të dhënat personale të qytetareve dhe qytetarëve janë të keqpërdorura dhe shfrytëzohen për anketa, propaganda dhe presione partiake.

Në një rast, si ilustrim, vërejmë se një qytetare, numri i celularit i së cilës mban emrin e një anëtari tjetër të familjes, pranon thirrje nga një shtab partiak, dhe i drejtohen me emrin dhe mbiemrin e saj. Atë numër telefoni qytetarja e ka paraqitur si kontakt në një institucion shëndetësor dhe në një bankë. Nga këtu, del se një nga këto entitete e ka dhënë këtë kontakt personal për nevojat e partisë politike.

KEQPËRDORIMI I TË MITURVE

Në shkollat fillore dhe të mesme anembanë Maqedonisë, vërehet presion i madh mbi të miturit dhe kushtëzim i prindërve të tyre mbi shpinë të fëmijëve. Kjo praktikë duhet të ndërpritet menjëherë, ndërsa përgjegjësit për këtë sjellje kriminele ndaj fëmijëve dhe të rinjve, të ftohen për përgjegjësi. Të miturit duhet të mbrohen nga ky kontaminim i fëlliqur politik!

KORRUPSIONI DHE JO TRANSPARENCA E INSTITUCIONEVE DHE PARTIVE POLITIKE

E alarmojmë publikun dhe kërkojmë të ndalojnë praktikat korruptuese dhe jo transparencë e institucioneve, posaçërisht në aspektin e financimit të partive politike. Publiku ka të drejtë të dije mënyrën e financimit të partive politike, me sa mjete disponojnë për fushata, nga i kanë ato mjete dhe si shpenzohen! Më 19 korrik, CIVIL ka dërguar letër deri te 70 parti politike me kërkesë të japin të dhëna elementare për financimin e aktiviteteve të tyre politike dhe fushatës zgjedhore. Deri në këtë moment, vetëm pesë parti politike janë përgjigjur ndaj kësaj kërkesë: E Majta, Partia Liberale e Maqedonisë, Lëvizja për Rindërtim të Maqedonisë, Lëvizja Popullore e Maqedonisë, dhe Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë.

CIVIL do të drejtojë edhe një kërkesë për financimin e fushatës zgjedhore të partive politike. Do t'i përdorim të gjitha mekanizmat juridike që t'i detyrojmë partitë politike për llogaridhënie.

Kjo nuk është e tëra, CIVIL disponon me material të madh, i cili deri tani është përmbledhur nga raportet e vëzhguesve afatgjatë, afat-shkurtë dhe mobil, nga paraqitjet e qytetareve dhe qytetarëve, si dhe nga qytetarët dhe qytetarët gazetarë nga i tërë vendi. E shfrytëzojmë këtë rast të falënderojmë të gjithë për mbështetjen dhe besimin që na e japin vazhdimisht dhe çdo kund.

QYTETARË, MOS
U FRIKËSONI TË
VOTONI!



Konferencë për shtyp para KSHZ, 9 nëntor 2016

QYTETARË, MOS U FRIKËSONI TË VOTONI!

Maqedonia i pret zgjedhjet me rrëmujë të plotë në Listën e Votuesve. Pas të gjitha kryqëzimeve dhe kontrollimeve në terren, “fantazmat” ende janë në Listën e Votuesve, ndërsa rrëmuja është e plotësuar me zhdukjen masovike të qytetareve dhe qytetarëve të cilët deri tani nuk kanë qenë kontestues dhe të cilët deri në mbylljen e listës kanë qenë aty. Ata me vite jetojnë në adresat e njëjta dhe votojnë në vendvotimet e njëjta. Vetëm në periudhën nga 5 deri 10 dhjetor, CIVIL ka pranuar mbi 600 thirrje nga qytetare dhe qytetarë, të brengosur se a do të kenë mundësinë ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre për votë, në zgjedhjet e parakohshme parlamentare!

CIVIL kërkon përgjegjësi nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) për votuesit e zhdukur, të cilët, thjeshtë, pa fajin e tyre, “u zhdukën” nga Lista E votuesve, gjegjësisht, ata janë shlyer dhe të vendosur në situatë të pamundësisë të realizimit të së drejtës tyre të garantuar kushtetuese për votim.

Rrëmuja në listën elektronike të votuesve dhe partizimi i KSHZ nuk guxojnë të jenë shkas për edhe një manipulim zgjedhor me vullnetin e qytetarëve.

CIVIL kërkon nga KSHZ dhe nga Komisionet Zgjedhore dhe Bordet Zgjedhore, t’u mundësojnë të gjithë votuesve të votojnë me dokumente të vlefshme. CIVIL drejton mesazh të hapur deri te Bordet Zgjedhore, Komisionet komunale dhe deri te KSHZ – të respektojnë dhe zbatojnë ligjet dhe procedurën zgjedhore dhe në mënyrë përkatëse t’i informojnë qytetarët, posaçërisht nëse janë “zhdukur” nga Listat.

Nëse anëtarët e Bordit Zgjedhor verifikojnë se votuesi nuk gjendet në Listën e Votuesve, janë të detyruar ta udhëzojnë në zyrën rajonale të KSHZ, që të kontrollohet në faqen e

internetit www.izbirackispisok.gov.mk nëse ai është i regjistruar në Listën e Votuesve dhe nëse është i regjistruar, në cilin vendvotim mund të votojë. Atyre që kanë dokumente të vlefshme, ndërsa janë plotësisht të shlyer, tu mundësohet të votojnë përkatësisht, me interpretim maksimal të Kodit Zgjedhor.

CIVIL përsëri thekson se është rreptësisht e ndaluar të kushtëzohen dhe të frikësohen votuesit. Për fat të keq, deri në ditën e fundit të fushatës, vazhdojnë presionet mbi votuesit!

Nga fillimi i javës së dytë të fushatës parazgjedhore, deri te CIVIL kanë arritur edhe mbi 100 paraqitje nga të gjitha viset e Republikës së Maqedonisë. Gjithsej, mbi 170 raste të preisioneve, kërcënimeve, keqpërdorimeve dhe kategorive tjera të parregullsisve, kanë arritur në CIVIL nga 21 nëntori deri më 8 dhjetor, duke mos i numëruar paraqitjet që kanë të bëjnë me problemet me Listën e Votuesve.

CIVIL kërkon që menjëherë të ndalohet me frikësim, kushtëzim, presione dhe me blerje të votave. CIVIL u garanton anonimitetin të gjithë qytetarëve që do të paraqesin parregullsi dhe i inkurajon që menjëherë t'i paraqesin të gjitha parregullsitë dhe keqpërdorimet. I ftojme votuesit të dalin lirshëm më 11 dhjetor në zgjedhje, sepse askush nuk guxon ta shkelë ose uzurpojë të drejtën e tyre – për shprehje të lirë të vullnetit të tyre se kush duhet ta udhëheqë Maqedoninë në periudhën e ardhshme.

CIVIL kërkon nga partitë politike t'i respektojnë ligjet dhe rregullat për zgjedhje të drejta, të lira dhe demokratike. Kërkojmë nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor të ndihmojnë që zgjedhjet të kalojnë qetë dhe në atmosferë demokratike, pa dhunë!

Kërkojmë respektimin e heshtjes zgjedhore, ndërsa nga mediat, në ditën e zgjedhjeve të informojnë paanshëm, në mënyrë korrekte dhe objektive. Në veçanti paralajmërojmë të mos ketë shprehje të urrejtjes ose thirrje për dhunë.

CIVIL fton edhe vëzhguesit që në mënyrë korrekte ta kryejnë detyrën e tyre dha ta informojnë publikun e Maqedonisë për të gjitha parregullsitë e vërejtura, dhe shkeljet e të drejtave të votuesve.

Për mundësimin e të gjithë qytetarëve për realizimin e të drejtës tyre votuese, CIVIL u bën thirrje punëdhënësve t'u mundësojnë të punësuarve, të cilët të dielën janë nëpër vendet e punës, të dalin nga vendet e punës dhe të votojnë, ndërsa nga Bordet Zgjedhore kërkon që t'ua lehtësojnë qasjen deri te vendvotimet personave me aftësi të kufizuara.


Duke marrë parasysh jo-transparencën e financimit të fushatave të partive politike, CIVIL kërkon që publiku të ketë qasje deri te raportimet e plota dhe detajore financiare dhe realizim të mbikqyrjes së vërtetë, që të dihet se kush nga cilat burime i ka financuar partitë, me çfarë shuma dhe për çfarë janë shpanzuar ato mjete.

Publiku ka të drejtë të dijë!

Shteti është i obliguar ta respektojë të drejtën për votim!

Përgjegjësit për parregullsitë zgjedhore dhe për pengimin e procesit zgjedhor duhet të përgjigjen!

Vërejtje: Pas konferencës për shtyp para Komisionit shtetëror Zgjedhor, përfaqësues të CIVIL tentuan të dorëzojnë raste të dokumentuara për persona të "zhdukur" nga Lista e Votuesve, deri te përfaqësues relevant i KSHZ. Për befasi të madhe, kuptuam se në KSHZ praktikisht nuk kishte asnjë njeri që mund ta pranonte materialin që e përgatiti ekipi i CIVIL, duke tentuar t'u ndhmojë së paku 100 qytetarëve që ta realizojnë të drejtën e tyre. Në KSHZ nuk pati asnjë njeri.



ст. 6р.13

DITË E QETË E
VOTIMEVE, POR
E TENSIONUAR,
PËRPLLOT ME PAR-
REGULLSI

Име и презиме: **Илија Илиќ**
Адреса: **Улица Бр. 1 Прилеп**
Контакт телефон: **075/**
Општински комитет **Прилеп**
Број на избирачко место **1351**

Jas sum odgovoren za izleznosta na glasawe do 12:00 часот за slednite 15 lica:

бр.	Име и презиме	Адреса (улица и број и општина)	Телефон (фиксен и мобилен)	Општински комитет	Број на избирачко место
1.			048	Прилеп	1381
2.			076	Прилеп	1351
3.			076	Прилеп	1351
4.			048	Прилеп	1381
5.			076	Прилеп	1351
6.			048	Прилеп	1414
7.			048	Прилеп	1414
8.			048	Прилеп	1414
9.			048	Прилеп	1414
10.			048	Прилеп	1410
11.			048	Прилеп	1410
12.			048	Прилеп	1410
13.			048	Прилеп	1410
14.			048	Прилеп	1397
15.			048	Прилеп	1397
16.					
17.					
18.					
19.					
20.					
21.					
22.					
23.					
24.					
25.					
26.					
27.					
28.					
29.					
30.					

"Lista me "votues të sigurt"

DITË E QETË E VOTIMEVE, POR E TENSIONUAR, PËRPLLOT ME PARREGULLSI

XHABIR DERALLA
NË BASHKËPUNIM ME EKIPET E CIVILIT

Në ditën e zgjedhjeve, më 11 dhjetor, viti 2016, CIVIL –Qendra për Liri ka radhitur 308 vëzhgues zgjedhor. Mes tyre ishin edhe 41 vëzhgues afatgjatë, të cilët veç më ishin në terren që t'i vëzhgojnë vendvotimet , por edhe terrenin më të gjerë në të cilin veprojnë partitë politike. Vëzhguesit e drejtuan vëmendjen e tyre edhe nga përfaqësuesit kompetentë të organeve zgjedhore, dhe i vërejtën ankesat e votuesve të cilët kanë pasur probleme gjatë votimit, ose kanë dëshmuar për parregullsi dhe keqpërdorime. Gjatë ditës së zgjedhjeve, CIVIL ka mbajtur të hapura 10 lidhje telefonike për të gjithë qytetaret dhe qytetarët të cilët kanë pasur probleme gjatë votimeve, ose kanë qenë dëshmitarë për ndonjë parregullsi në panel. Pranuar mbi 1000 thirrje në ditën e zgjedhjeve.

Mbi 700 raportime për parregullsi arritën në qendrën analitike të CIVIL-it gjatë ditës së zgjedhjeve, më 11 dhjetor të vitit 2016, nga të cilat, janë miratuar 642 raportime. Raportimet e tyre u ndanë sipas kategorive në vazhdim:

1. Veprim i paligjshëm dhe shkelje e procedurave zgjedhore
2. Probleme me Listën e Votuesve
3. Shkelje e privatësisë së votimit
4. Ryshfet i votuesve
5. Shkelje e heshtjes zgjedhore
6. Keqpërdorim i të miturve
7. Kërcënime, keqpërdorime, presione dhe kushtëzime
8. Pengim i votimit
9. Votim familjar dhe grupor
10. Policia – tejkalime të kompetencave dhe keqpërdorime
11. Pengesa në punën e vëzhguesve
12. Dhunë
13. Dhunë me armë
14. Parregullsi tjera

Rastet e paraqitura të parregullsive zgjedhore shpesh kanë të bëjnë edhe me kategori dhe forma tjera të shkeljes së Kodit Zgjedhor, dhe lëndimin e të drejtës për votim, por edhe të të drejtave dhe lirive tjera të njeriut. Në procedurën e kategorizimit është mbajtur llogari se cili dimension i rastit është dominues, gjegjësisht, nga cila kategori del i tërë rasti.

Të gjitha raportimet nga vëzhguesit në ditën e votimeve iu nënshtruan kontrollit të dyfishtë, përmes bisedave individuale me një pjesë nga vëzhguesit, verifikim i paraqitjeve përmes ekipeve speciale monitoruese ose krahasim i raportimeve të vëzhguesve me lloj tjetër të informatave nga terreni, siç janë paraqitje përmes telefonit ose onlajn paraqitje nga qytetare dhe qytetarë, dhe nga ekipi hulumtues i CIVIL-it, i cili vazhdimisht ishte në terren.

Vëzhgimi në ditën e votuesve filloi në ora 6 të mëngjesit, dhe mbaroi me kryerjen e numërimit dhe dorëzimit të materialit zgjedhor të komisioneve komunale zgjedhore.

CIVIL e promovoi parimin ZERO TOLERANCË PËR PARREGULLSITË ZGJEDHORE gjatë periudhës parazgjedhore, dhe kërkoi nga vëzhguesit që t'i shënojnë edhe parregullsitë më të vogla gjatë ditës së votimit. Sidoqoftë, që në fillimin e ditës së votimit më 10 dhjetor, 2016, ishte e qartë se do të ketë numër të madh të parregullsive, kështu që ky raportim trajton vetëm informata dhe raportime të cilat, sipas CIVIL, janë më serioze, dhe të pa-pranueshme për procesin zgjedhor në një shtet demokratik, pretendues për anëtarësim në BE. Ekipi i CIVIL-it ka bërë edhe seleksionimin plotësues, më të ngushtë, nga paraqitjet për parregullsitë zgjedhore, me qëllim të ilustrimit të gjendjes dhe praktikave mashtruese dhe veprimeve gjatë zgjedhjeve, me qëllim ti jepet dukshmëri dhe aplikim praktik të Raportit.

Në këtë kapitull të Raportit do ti numërojmë parregullsitë më karakteristike, sipas kategorie të radhitura.

VËREJTJE E RËNDËSISHME:

Të gjitha raportimet të cilat i ka përpunuar qendra analitike e CIVIL, përmbajnë një sërë informatash, mes të cilave: lokaliteti i saktë për të cilin informohet, numri i vendvotimit, emri dhe mbiemri i vëzhguesit i cili i paraqet parregullsitë.

Një pjesë e madhe nga raportimet përmbajnë emra, përshkrime, ndërsa në një pjesë edhe video, audio dhe regjistrime fotografike, të vepruesve, dëshmitarëve, si dhe emra të përfaqësuesve të organeve dhe trupave të KSHZ, aty ku është relevante për raportin.

Vëzhguesve të CIVIL u ishte ndaluar rreptësisht të regjistrojnë ose të fotografojnë brenda, në vendvotimet.

1. VEPRIME JOLIGJORE DHE SHKELJE E PROCEDURAVE ZGJEDHORE

Ekipi analitik i CIVIL-it ka përpunuar dhe miratuar 196 raportime për veprime joligjore dhe shkelje të procedurave zgjedhore. Para së gjithash, ato kanë të bëjnë me punën e zyrtarëve të cilët janë pjesë e institucioneve, gjegjësisht, me organet e Komisionit Shtetëror Zgjedhor.

Në të shumtën e rasteve, veprimi joligjor është vepër e individëve – anëtarë të Bordeve Zgjedhore, mirëpo në numër të madh të rasteve bëhet fjalë për shkeljen e procedurave zgjedhore të Bordit Zgjedhor në tërësi.

Në përgjithësi, vërehet niveli i ulët i njohjes së procedurave, dhe mungesë e informatave për kompetencat, obligimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të bordeve zgjedhore. Kjo dukuri është e përhapur dhe e dukshme në ditën e zgjedhjeve, dhe nëse informohej për mosdijen dhe gabimet e paqëllimshme të anëtarëve të bordeve zgjedhore, ky Raport me siguri do të kishte numër tre herë më të lartë nga parregullsitë e regjistruara në këtë kategori.

Shpesh, parregullsitë zgjedhore të shkaktuara nga veprimet joligjore dhe shkeljet e procedurave zgjedhore nga ana e bordeve zgjedhore, ose përfaqësuesve të institucioneve tjera dhe trupave të KSHZ, janë të shoqëruara edhe me forma tjera të parregullsive, por gjenden në këtë kategori, sepse shpesh ndodhin brenda, në vendvotim.

Bordet zgjedhore kanë kryer shkeljen e heshtjes zgjedhore përmes agjitimit të hapur në interes të partive qeverisëse VMRO-DPMNE dhe partnerëve të tyre të koalicionit, përveç në një rast të agjitimit në interes të opozitares LSDM. Gjithashtu, shënohen dhjetëra raste në të cilat bordet zgjedhore nuk reagojnë në agjitimin nga aktivistë partiak brenda në vendvotim, e anashkalojnë votimin publik dhe i injorojnë udhëzimet nga vëzhguesit, se rastet e këtilla duhet të hyjnë në procesverbal.

Në mbi 50 raste të shënuara në raportimet e vëzhguesve të CIVIL, bordet zgjedhore i injorojnë sugjerimet për parregullsitë ose shkeljen e procedurës.

Në një rast, anëtar i Bordit Zgjedhor në Komunën Aerodrom, ka qenë dukshëm i shënuar me simbole partiake të partisë qeverisëse dhe një kohë të gjatë ka qenë këmbëngulës para sugjerimeve që t'i largojë simbolet nga vetja.

Bordet zgjedhore të më tepër votuesve në Komunën Aerodrom, jo vetëm se nuk u kanë ndihmuar votuesve të cilët kanë qenë të shlyer nga Lista e Votuesve në disa ditët e fundit para ditës së zgjedhjeve, por edhe plotësisht e kanë penguar votimin e tyre në mënyrë që i kanë shënuar me sprej, e mandej i kanë informuar se nuk janë në Listën Zgjedhore. Ashtu të shënuar, ata nuk kanë mundur më të votojnë në asnjë vendvotim tjetër, pavarësisht që i kanë drejtuar në vendvotime tjera.

Bordet zgjedhore kanë zbatuar kontrollime dhe mobilizim partiak të votuesve, ashtu që në numër të madh të vendvotimeve, në mënyrë të hapur kanë komunikuar me shtabet partiake gjatë tërë ditës, dhe u kanë lejuar vëzhguesve partiakë, posaçërisht të partive qeverisëse, t'i shfletojnë ekstraktet nga Lista e Votuesve.

Ata e tolerojnë votimin familjar dhe grupor, dhe nuk reagojnë as në asistencën gjatë votimit, që është në kundërshtim me procedurat. Gjithashtu, janë shënuar dhjetëra raste në të cilat presidenti ose anëtarët e Bordit zgjedhor u sugjerojnë votuesve të rrethojnë numrin 1 (VMRO-DPMNE). Për shembull, në Komunën Karposh, anëtarët e Bordit Zgjedhor në mënyrë të hapur i pyesin votuesit se për cilin do të votojnë.

Nuk ka pasur reagim për fotografime në vendvotim së paku në tre raste, ndërsa në një rast në Manastir, vetë anëtarët e Bordit Zgjedhor janë fotografuar mes vete, brenda në vendvotim. Në komunën e njëjtë, në vendvotim tjetër, anëtar i Bordit zgjedhor i ka mbikëqyrë votuesit gjatë votimit, me çfarë e ka lënduar parimin e privatësisë së votimit.

Bordet zgjedhore nuk janë munduar të zbatojnë rend në raste të turmave dhe rrëmujës në dhjetëra vendvotime, përkundër kompetencave të qarta ligjore të cilat ua mundësojnë ato. Shënohen edhe raste të leximit të zëshëm të emrit dhe mbiemrit të votuesve.

Anëtarët e bordeve zgjedhore, edhe pse janë kompetentë për përkujdesjen për materialin zgjedhor dhe vendvotimin, duke i përfshirë edhe kutitë votuese, shpesh janë të pakujdesshëm. Në më tepër raste nëpër tërë Maqedoninë shënohet se kutitë votuese nuk janë të mbyllura. Vetëm pas insistimit nga vëzhguesit, nga të cilët në një rast nga një mision ndërkombëtar vëzhgues, ata i mbyllin.

Bordet zgjedhore e zbatojnë numërimin e votave në mënyrë tepër të dyshimtë dhe të parregullt. Për shembull, gjatë shpalljes së fletëvotimeve të pavlefshme, Bordet Zgjedhore jo çdo herë i përmbahen Kodit Zgjedhor dhe vendosin ndryshe për rrethimin e numrit para kandidatit. Në mbi 50 raste shënohet se fletëvotimet në të cilat është shprehur qartë vullneti i votuesit, megjithatë, janë shpallur të pavlefshme, posaçërisht në raste kur është rrethuar numri 4 (LSDM). Fletëvotime, të rrethuara në mënyrë të njëjtë në Komunën Aerodrom dhe në Tetovë, trajtohen ndryshe. Derisa në Aerodrom shpallen si të pavlefshme, të njëjtat janë të vlefshme në Tetovë.

Është shënuar një rast në të cilin Bordi Zgjedhor në vendvotim në Komunën Kisella Vodë, sipas raportit të vëzhguesit, ka votuar një person i cili nuk është në Listën e Votuesve. Në Saraj, Bordi Zgjedhor i ka lejuar një qytetari të votojë në vend të vëllait që jeton jashtë vendit.

Në një rast të shënuar në raportin e vëzhguesit nga Komuna e Kumanovës, anëtar i Bordit zgjedhor, përndryshe anëtar i BDI, njëkohësisht ka qenë edhe vëzhgues partiak i asaj partie.

Në disa dhjetëra raste, vëzhguesit shënojnë se Bordi Zgjedhor nuk është i plotë, gjegjësisht, se së paku një anëtar nga përbërja e këtij trupi pothuajse asnjëherë nuk është në vendin e tij.

Në më tepër raste bordet zgjedhore sillen ashpër ndaj votuesve, i provokojnë dhe u bëjnë presione. Në një vendvotim në Komunën Butel, Bordi Zgjedhor, thjeshtë, e ka dëbuar vëzhguesin e CIVIL pa shpjegim, menjëherë pas legjitimitit të tij.

Në dy raste shënohet sjellje jashtëzakonisht e padenjë e Bordit Zgjedhor. Në tre vendvotime është shënuar konsumim i alkoolit dhe ngrënie gjatë ditës së votimit, situata në të cilat marrin pjesë edhe disa nga vëzhguesit e organizatave tjera dhe vëzhgues partiakë.

Shumica nga ata nuk mbajnë bexhe, nuk i njohin procedurat, dhe ndonjëherë bëjnë edhe lëshime dhe gabime të paqëllimshme, por shkeljet më të imëta të procedurave ishin aq të rregullta dhe të shumta sa që ato raste edhe nuk hyjnë në statistikën e këtij Raporti, përndryshe numri i rasteve në këtë kategori do të ishte shumë më i lartë.

Veprime joligjore dhe shkelje e procedurave zgjedhore është shënuar: Aerodrom (15 raste), Berovë (2), Manastir (17), Butel (3), Vallandovë (1), Veles (1), Gazi Babë (7), Gjevgjeli (3), Gjorçe Petrov (4), Gostivar (1), Dellçevë (3), Demir Hisar (15), Kavadar (3), Karposh (7), Kisella Vodë (6), Kërçovë (4), Koçanë (4), Kriva Pallankë (1), Krushevë (3), Kumanovë (4), Likovë (5), Mavrovë – Rostushë (1), Saraj (8), Sveti Nikollë (3), Strugë (1), Tearcë (1), Tetovë (9), Qendër (8), Çair (12), dhe Shuto Orizarë (18).

2. PROBLEME ME LISTËN E VOTUESVE

CIVIL paraqitet në publikun me më tepër se dhjetëra lajmërimë dhe informata të publikuara në ueb faqet e organizatës dhe në rrjetet sociale, me numër të madh të deklaratave për mediat, dhe konferenca për shtyp kushtuar kësaj teme.

Kishte edhe numër të madh të tentimeve të kontaktohet me Komisionin Shtetëror Zgjedhor, zyrtarisht, me shkrim dhe një numër të madh të thirrjeve telefonike me qëllim të ndihmohet në orvatjet për sigurimin e zgjedhjeve të lira dhe respektimin e të drejtës votuese

të të gjithë qytetareve dhe qytetarëve. Kjo nënkuptonte edhe mbështetjen e procesit për revidimin dhe pastrimin e Listës së Votuesve për të cilin CIVIL parashikonte se mund të jetë mjet i rëndësishëm për sigurimin e të drejtës votuese dhe një nga kushtet më të rëndësishme për mbajtjen e zgjedhjeve të lira.

Për fat të keq, kjo nuk ndodhi.

Në 83 raportime të përpunuara dhe të miratuara nga vëzhguesit e CIVIL, dëshmohet për qindra raste në të cilat qytetarët dhe qytetarët nuk kanë mundur ta realizojnë të drejtën e tyre për votim, sepse kanë qenë të shlyer nga Lista e Votuesve në disa ditët e fundit para ditës së votimit më 11 dhjetor, 2016.

Janë regjistruar edhe raste në të cilat disa votues janë gjetur në Listën e veçantë të personave të zhvendosur, por vetëm në disa raste, anëtarët e Bordeve zgjedhore janë kujtuar të kërkojnë atje.

Në shumicën e rasteve, thjeshtë, votuesit nuk kanë mundur ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre, edhe pasi kanë reaguuar në Komisionet Komunale Zgjedhore. Atje nuk kanë mundur t'u ndihmojnë, sepse Komisioni Shtetëror Zgjedhor nuk ka pasur sistem për mbrojtjen e të drejtave të votuesve, as ta përmirësojnë padrejtësinë ndaj votuesve, për shkak të rrëmujës në Listën e Votuesve, siç e emëroi CIVIL në komunikimin me publikun.

Në raportimet nga vëzhguesit e CIVIL-it lajmërohet edhe për raste të personave të vdekur, të cilët gjenden në Listën e Votuesve dhe numër i madh i votuesve fantazma, gjegjësisht, persona që nuk jetojnë në ato adresa.

Votuesit fantazma ishin në veçanti aktual gjatë proceseve zgjedhore në vitin 2013 dhe 2014, ndërsa u bë e qartë se një numër i madh i votuesve fantazma gjenden në Listën e Votuesve edhe në ditën e votimit më 11 dhjetor, viti 2016. Thjeshtë, votuan persona të vdekur dhe fantazma, ndërsa njerëzve të gjallë kjo u ishte pamundësuar.

Në tre raste të ndryshme, në raportimet e vëzhguesve të CIVIL paraqiten dyshime serioze se kanë votuar persona të vdekur dhe fantazma. Këto informata, sipas vëzhguesve, janë të mbështetura me paraqitje anonime nga burime relevante, duke i përfshirë anëtarët e Bordeve zgjedhore.

Raportime për problemet me Listën Zgjedhore vijnë nga komunat : Aerodrom (17), Haraçinë (1), Manastir (13), Butel (7), Vallandovë (2), Veles (2), Gazi Babë (9), Gjorçe Petrov (4),

Gostivar (2), Demir Hisar (6), Karposh (3), Kisella Vodë (2), Kërçovë (1), Krushevë (3), Kumanovë (8), Makedonski Brod (1), Ohër (6), Prilep (11), Probishtip (1), Radovish (2), Resnje (2), Saraj (3).

Në çdo raportim bëhet fjalë për numër më të madh të rasteve, gjegjësisht, lëndim i të drejtës votuese në këtë kategori.

Me rëndësi është të shënohet se gjatë ditës së votimit, në CIVIL janë lajmëruar rreth një mijë qytetare dhe qytetarë, nga të cilët dy të tretat kishin të bëjnë me probleme të lidhura me Listën Votuese.

Ekipe të CIVIL e trajtojnë këtë temë me vëmendje të veçantë edhe në pjesë tjera të këtij Raporti, si dhe në onlajn-kanale të organizatës.

3. LËNDIMI I PRIVATËSISË SË VOTIMIT

Lëndimi i privatësisë së votimit është rreptësisht i ndaluar me ligj. Kjo nënkupton edhe fotografimin brenda në vendvotimet, e posaçërisht fotografimi i fletëvotimit, gjë që tregon edhe për vepra penale tjera, të lidhura me zgjedhjet.

Vëzhguesit e CIVIL kanë dorëzuar 30 raportime me më tepër raste të lëndimit të privatësisë së votimit.

Në këtë kategori shënohen 18 raste të fotografimit të fletëvotimit, në komunat: Manastir (1 rast), Butel (1), Veles (1), Vrapçishtë (1), Gjevgjeli (1), Zelenikovë (1), Karposh (20, Krushevë (1), Kumanovë (2), Prilep (3), Qendër (2) dhe Çair (2).

Në 5 deri 18 raste të fotografimit të fletëvotimit nuk ka reagime nga Bordi zgjedhor, derisa në 13 raste ka reagim nga Bordi zgjedhor, ndërsa në më tepër se gjysma e rasteve, vëzhguesit tonë lajmërojnë edhe për intervenim policor në kohë të duhur, si dhe për reagim korrekt të anëtarëve të Bordeve zgjedhore në ato vendvotime.

Në raste tjera, në kategorinë Lëndim i privatësisë së votimit, në pjesën më të madhe bëhet fjalë për votim publik, si dhe për sugjerim të dukshëm dhe nxitje të votuesve të cilët kanë nevojë për ndihmë.

Sipas raportimeve, paravanet pas të cilëve votohet, kanë qenë të vendosur në pozita nga të cilat ka qenë lehtë të shihet se kush për cilin voton, ndërsa në dy raste, ka pasur paravane, pjesa e parme e të cilëve ka qenë e dëmtuar. Në shumicën e rasteve, pas sugjerimit nga vëzhguesit të CIVIL, janë bërë orvatje të korrigjohet mangësia.

Gjithashtu, është shënuar regjistrimi dhe fotografimi në dy vendvotime, në mënyrë në të cilën ka mundur të lëndohet privatësia e votimit, të bëhet presion dhe evidencë mbi votuesit.

Përveç rasteve të paraqitura me fotografim të fletëvotimit, vëzhguesit e CIVIL shënojnë edhe parregullsi tjera në këtë kategori, në komunat: Gjevgjeli (1), Gostivar (1), Demir Hisar (2), Kisella Vodë (2), Kërçovë (1), Kriva Pallankë (1), Ohër (1), Prilep (5 raste) dhe Strugë (1).

4. RYSHFET I VOTUESVE

Ryshfeti i votues në ditën e votimit, si dhe gjatë heshtjes zgjedhore, një ditë para, paraqet një nga format më të rënda të parregullsisë zgjedhore, por edhe sfida të madhe për vëzhguesit.

Në ryshfetin janë të kyçur aktivistë partiakë, të punësuar në administratë, por edhe përfaqësues të pushtetit në nivel lokal. Ky operacion, qartë, është zbatuar një kohë të gjatë para ditës së zgjedhjeve, por në këtë pjesë nga Raporti i CIVIL trajtohen vetëm tema të regjistruara në ditën e zgjedhjeve, më 11 dhjetor.

Gjatë heshtjes zgjedhore, në ditën para zgjedhjeve, vëzhguesit e CIVIL kanë regjistruar 11 raste të ryshfetit të votuesve, në Manastir, Veles, Demir Hisar, disa komuna në Shkup dhe Resnje. Në 5 nga këto raste, CIVIL ka shënuar edhe intervenim të policisë.

Ryshfet të votuesve, sipas 12 raportimeve të përpunuara nga dita e zgjedhjeve, janë shënuar në komunat: Berovë (1), Manastir (2 raste), Veles (2), Prilep (2), Resnje (1), Sveti Nikollë (1), Staro Nagoriçane (1), Strugë (1) dhe Shtip (1).

Vëzhguesit kanë dorëzuar edhe material të regjistruar në foto, video dhe audio formate me dëshmi të personave të cilët insistojnë të mbesin anonimë.

5. SHKELJE E HESHTJES ZGJEDHORE

Edhe pse shkelja e heshtjes zgjedhore është rreptësisht e ndaluar dhe dënohet, sikur nuk ekzistoi gjatë heshtjes zgjedhore, një ditë para, dhe gjatë votimit më 11 dhjetor.

Praktikisht, nëpër tërë vendin shënohet shkelje e heshtjes zgjedhore, ndërsa kjo shpesh është komponentë edhe në të gjitha kategoritë tjera të parregullsive, si parregullsi e dytë ose e tretë në pothuajse të gjitha raportimet nga vëzhguesit e CIVIL.

Për shembull, në pjesën më të madhe nga raportimet në kategorinë Veprime lojigjore dhe shkelje e procedurave zgjedhore, dëshmohet edhe për shkelje të heshtjes zgjedhore, pikërisht nga ana e bordeve zgjedhore, vëzhguesve partiakë, por në disa raste shënohet edhe shkelje e heshtjes zgjedhore edhe nga vëzhgues të organizatave jopartiake (joqeveritare). Për këtë arsye, kjo pjesë nga Raporti i CIVIL duhet të trajtohet si plotësim në kuptim të raporteve të përpunuara posaçërisht për këtë kategori të parregullsive zgjedhore, që të shërbejnë si ilustrim për shkeljen e ashpër të ligjeve dhe standardeve demokratike.

Kjo dukuri duhet në veçanti të trajtohet në periudhën post –zgjedhore dhe të kërkohet zgjidhje për kulturën jashtëzakonisht të ultë, dhe prirjes për paligjshmëri, praktikisht nga të gjithë anëtarët në procesin zgjedhor.

Aktivistët partiak, madje edhe përfaqësuesit e pushtetit, në rol të vëzhguesve partiak, në mënyrë të hapur bëjnë agjitim edhe në vetë vendvotimet. Kështu, vëzhguesi i VMRO –DPMNE qëndron në derë të një vendvotimi në Prilep, dhe u tregon njerëzve që hyjnë, të rrethojnë numrin 1 (VMRO- DPMNE).

Në Manastir, në afërsi të qendrës për punë sociale, aktivistët partiakë të VMRO-DPMNE janë ndarë ndy grupe. Njëri grup në mënyrë të hapur i ndalon kalimtarët dhe gjiton, ndërsa grupi tjetër ndan sanduiçe.

Vëzhguesit e VMRO – DPMNE në vendvotimin në Komunën Karposh e kanë pyetur secilin votues që ka hyrë, se për cilin do të votojë, ose, thjeshtë, i janë drejtuar me fjalët “Voto për Maqedoninë!”

Shkelja e heshtjes zgjedhore shkon deri aty, që para vendvotimit në Prilep, një turmë aktivistësh të VMRO-DPMNE thërrisnin slogane politike.

Një vëzhgues i një organizate joqeveritare agjiton para vendvotimit në Radovish. Raste tjera të këtilla janë vërejtur në Shtip, Veles dhe Shkup.

Ashtu si në raportimet në kategoritë tjera, në të cilat shkelja e heshtjes zgjedhore është komponentë shoqëruese e formës dominante të parregullsisë zgjedhore, edhe në këtë kategori, vëzhguesit e CIVIL shënojnë shkelje tepër më të mëdha nga ana e qeverisësës VMRO-DPMNE dhe partnerëve të tyre koalicionues, para së gjithash Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) në komunat në të cilat jetojnë Shqiptarë, si dhe Bashkimi i Romëve të Maqedonisë, në komunat në të cilat jetojnë Romë.

Janë shënuar tre raste të shkeljes së heshtjes zgjedhore nga aktivistë partiakë të LSDM në Komunën Karposh (Shkup), Kumanovë dhe Strumicë.

Nga parregullsitë tjera në këtë kategori, mund të veçohet se në disa dhjetëra raste, materiali propagandues nuk është i mënjanuar nga vendvotimet, ose nga afërsia e tyre. Ky është element shoqërues edhe në vargun e raportimeve tjera nga terreni, por është trajtuar si parregullsi anësore.

Në këtë kategori veçohen 39 raportime, edhe pse, siç tregohet edhe më lartë, shkelja e heshtjes zgjedhore është në masë të madhe dhe e vazhdueshme nëpër tërë Maqedoninë. Raportime të veçuara nga terreni për shkeljen e heshtjes zgjedhore janë: Berovë (1 raportim), Manastir (2), Veles (1), Gostivar (1), Demir Hisar (6), Karposh (3), Kërçovë (1), Kumanovë (1), Likovë (1), Llozovë (1), Prilep (3), Probishtip (1) Radovish (1) Strumicë, Qendër (3) Çuçer Sandevo (10 dhe Shuto Orizarë (6 raportime).

6. KEQPËRDORIMI I TË MITURVE

Keqpërdorimi i fëmijëve dhe të miturve është i pranishëm në të gjitha proceset zgjedhore dhe nuk mungoi as te ky proces zgjedhor. CIVIL e ka gjykuar ashpër dhe kategorikisht keqpërdorimin politik të të miturve gjatë fushatës zgjedhore, dhe ka drejtuar kritika të rrepta në konferencat për shtyp edhe në ditën e votimeve.

Në ditën e zgjedhjeve, më 11 dhjetor, janë shënuar 12 raste të keqpërdorimit të të miturve, për dallim nga periudha parazgjedhore, kur CIVIL publikoi numër të madh të keqpërdorimeve nga i tërë vendi. Për këto keqpërdorime, në veçanti shkruhet edhe në këtë Raport.

Është karakteristik keqpërdorimi i të miturve në Shuto Orizarë, ku grupe të të miturve vërehen në gjashtë raste se si thërrasin dhe marrin pjesë në propagandë dhe shkelje të heshtjes zgjedhore në afërsi të vendvotimeve në këtë komunë.

7. KËRCËNIME, KEQPËRDORIME, PRESIONE DHE KUSHTËZIME

Votuesit ishin nën presion të vazhdueshëm gjatë gjithë periudhës, për një kohë të gjatë para fillimit zyrtar të fushatës parazgjedhore. CIVIL në vazhdimësi publikon raportime dhe analiza për shumë raste, të cilat në këtë Raport përfshihen në një kategori: Presione, keqpërdorime, kërcënime dhe kushtëzime. Bëhet fjalë për raste komplekse të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut në kontekst zgjedhor. Pa përjashtim, në të gjitha rastet bëhet fjalë për pasoja nga dhuna strukturore dhe korrupsioni politik me përmasa të mëdha.

Lëndimet dhe veprimet kundërligjore dhe praktikat e institucioneve dhe të strukturave tjera të fuqisë, udhëzojnë edhe në pjesëmarrje të më tepër entiteteve të ndryshme dhe paraqesin gërshetim të rrethanave të krijuara ose të shkaktuara nga këto praktika.

Votuesit janë nën presion që nga orët e hershme të mëngjesit në ditën e votimeve. Një numër i madh nga ata veç më gjenden në listat e “votuesve të sigurt” dhe pranojnë thirrje telefonike nga shtabet partiake të dalin në votim.

Aktivistë partiakë i presin me automjete që t’i transportojnë, ose, i presin para vendvotimeve, në të cilat aktivistët partiakë me lista në duar, i shënojnë të gjithë që janë paraqitur në votim.

Para vendvotimeve shpesh gjenden ushtarë partiakë, shpesh të punësuar në administratë dhe i përshëndesin në mënyrë “miqësore” dhe i përkujtojnë se “për cilin duhet të votojnë”. Ka raste kur transportin e organizuar e realizojnë të punësuar në administratë, me automjete zyrtare. Në disa raste automjetet të cilat përdoren për “kontrollimin e daljes”, nuk kanë targa.

Në disa raste është e shënuar se përkatës të njësisë speciale Alfa e zbatojnë “mobilizimin” e votuesve.

Në një rast, dy persona përcjellin një votues deri te vendvotimi në Komunën e Manastirit dhe i tregojnë si të votojë, pa asnjë reagim nga Bordi zgjedhor.

Kjo kategori është e pranishme si element edhe në të gjitha kategoritë tjera, posaçërisht në kategoritë: Veprim joligjor dhe shkelje e procedurave zgjedhore, të cilën në pjesë më të madhe e zbatojnë bordet zgjedhore dhe vëzhguesit partiakë, Lëndim i privatësisë së votimit, që është pasojë nga presioni mbi votuesit ta fotografojnë fletëvotimin ose të

votojnë publikisht; Ryshfet i votuesve të cilin në masë të madhe zbatojnë të punësuar në administratë, si dhe funksionarë të pushtetit të nivelit lokal; Shkelje e heshtjes zgjedhore; Pengim i votimit, në raste kur pengohen votuesit të cilët do të votojnë “për anën kundërshtare” ta realizojnë të drejtën e tyre votuese; Policia – tejkalime dhe keqpërdorim...

Ata votues që e fotografojnë fletëvotimin, sepse janë të detyruar – janë të detyruar të dëshmojnë se kanë votuar për partinë qeverisëse, e cila i ka bindur se janë të obliguar të votojnë për atë. Në të kundërtën, ata janë nën rrezik dhe të kushtëzuar me vendin e punës, ndihmë sociale, shërbime shëndetësore ose ndonjë tjetër shërbim “zemërgjerë” nga administrata.

Në ditën e votimeve shënohen 55 raste të kërcënimeve, presioneve, keqpërdorimeve dhe kushtëzimeve të ndryshme, në komunat: Aerodrom (3 raste), Berovë (1), Manstir (3), Butel (1), Gazi Babë (5), Gjevgjeli (1), Gostivar (1), Dellçevë (2), Demir Hisar (2), Zelenikovë (1), Kavadar (1), Karposh (3), Kisella Vodë (4), Kërçovë (1), Krushevë (2), Llozovë (2), Prilep (6), Radovish (3), Resnje (1), Saraj (2), Sveti Nikollë (5).

8. PENGIM I VOTIMIT

Pengimi i votimit në shumicën e rasteve do të thotë se aktivistët partiakë tentojnë t'i pengojnë të votojnë ata persona për të cilët supozojnë se do të votojnë për kundërshtarin politik. Këtyre aktiviteteve shpesh u paraprinë përgatitje dhe përpunim i listave të votuesve për të cilët është vërtetuar se janë “papërshtatshëm”, gjegjësisht, anëtarë ose mbështetës të partisë tjetër. Kjo kategori shpesh është e lidhur edhe me kategoritë Ryshfet i votuesve dhe Shkelje e heshtjes zgjedhore.

Kështu, në Komunën e Llozovës janë vërejtur dy grupe të aktivistëve të VMRO-DPMNE, nga të cilët njëri grup gjendet para vendvotimit dhe agjiton, ndërsa grupi tjetër është me automjet nga i cili kohë pas kohe dalin aktivistët dhe i ndalojnë votuesit për të cilët supozojnë se do të votojnë për opozitën. Në raportimin e tij, vëzhguesi i CIVIL-it e përshkruan gjendjen me fjalët “presion i pabesueshëm”...Përshkrim i ngjashëm i atmosferës vërehet edhe në raportimet që vijnë nga Komuna e Prilepit, por edhe nga komunat më të vogla dhe rurale nëpër Maqedoni.

Pengim i votimit shënohet në 32 raste në komunat: Manastir (3raste) Butel (2), Gazi Babë (4), Dellçevë (1), Zelenikovë (1), Kërçovë (1), Llozovë (2), Prilep (8), Resnje (2), Strugë (2), Strumicë (1), Çeshinovë-Obleshevë (1) dhe Shuto Orizarë (2 raste).

9. VOTIM FAMILJAR DHE GRUPOR

Një person me aftësi të kufizuara arrin në vendvotimin në Probishtip, i shoqëruar nga prindi, i cili pas paravanit shkon të votojë vetë, në emër të personit me aftësi të kufizuara, pa u konsultuar. Pastaj prindi ia jep fletëvotimin personit me aftësi të kufizuara, i cili gjatë vendosjes së fletëvotimit në kuti, thotë: “Kam frikë” – thuhet në raportimin e vëzhguesit nga Probishtipi.

Në një vendvotim në Demir Hisar, kur vëzhguesi i CIVIL-it ka treguar për rast të votimit grupor, anëtarët e Bordit Zgjedhor kanë reaguar me fjalët: “Aman, këtu të gjithë njihemi!”. Në Saraj, Bordi Zgjedhor i ka lejuar një personi të votojë për pesë persona, për veten, për vëllain, për nënën, për të cilën ka thënë se nuk shef mirë, dhe për dy persona të cilët nuk kanë qenë në lidhje familjare me atë.

Vëzhguesit e CIVIL-it kanë dorëzuar 78 raportime me së paku një rast të votimit familjar ose grupor, edhe atë në komunat: Aerodrom (1 raportim), Haraçinë (2), Berovë (1), Manastir (5), Butel (4), Veles (4), Vrapçisht (1), Gazi Babë (8), Gjevgjeli (2), Dellçevë (1), Demir Hisar (3), Kavadar (2), Karposh (1), Kisella Vodë (3), Kërçovë (1), Krushevë (1), Likovë (1), Llozovë (1), Ohër (2), Prilep (6), Probishtip (2), Saraj (5), Strugë (1), Strumicë (1), Tetovë (3), Qendër (1), Çair (3), Çeshinovë- Obleshevë (1), Shuto Orizarë (9 raportime).

10. POLICIA – TEJKALIMET E KOMPETENCAVE DHE KEQPËRDORIMET

Në këtë kategori, për dallim nga proceset tjera zgjedhore, policia ka treguar nivel të lartë të profesionalizmit. Sidoqoftë, në dy raportime shënohen parregullsi në të cilat ka marrë pjesë policia. Në një rast vërehet situatë simptomatike në të cilën votuesve në Prilep u jepen letërnjoftime në ditën e zgjedhjeve, në numër jashtëzakonisht të madh.

Në Komunën Çeshinovë – Obleshevë shënohet një rast i intervenimit seleksionues i policisë në shtabin zgjedhor të LSDM, për të cilin veç më ekziston raportim për shkelje të heshtjes zgjedhore. Shtabi i LSDM ka qenë përkohësisht i mbyllur dhe është hapur vetëm pasi janë mënjanuar materialet propaganduese.

Mirëpo e njëjta parregullsi është vërejtur edhe në shtabin zgjedhor të VMRO-DPMNE, ku policia nuk ka reagu.

Në Komunën Demir Hisar, zyrtarë policorë kanë bërë kontrollin dhe evidencën votuesve për nevojat e degës lokale të VMRO-DPMNE.

11. PENGESA NË PUNËN E VËZHguesVE

CIVIL shënon numër rekordi të rasteve të pengimit të vëzhguesve të CIVIL-it gjatë ditës së votimeve, për dallim nga proceset tjera zgjedhore, që paraqet tregues specifik për gjendjet dhe cilësinë e zbatimit të procesit zgjedhor. Pjesa më e madhe e rasteve të pengimeve vijnë pikërisht nga përfaqësuesit e trupave të Komisionit Shtetëror Zgjedhor, më saktë, nga anëtarët e Bordeve Zgjedhore, por një pjesë nga raportimet tregojnë për sjelljen e papranueshme të aktivistëve të partive qeverisëse, të cilët, në disa raste kanë ushtruar presion të fuqishëm mbi vëzhguesit tonë. Në tre raste bëhet fjalë edhe për kërcënime me vdekje për vëzhguesit tonë. Në një rast, vëzhguesi ynë ishte i mbajtur në mënyrë joligjore nga aktivistë të VMRO-DPMNE, ndërsa ishte i liruar pas intervenimit policor. Në një rast tjetër, vëzhguesi ynë ka qenë i detyruar të kërkojë intervenim policor, për arsye të qëllimit të qartë për sulm fizik, dhe mandej ka pasur edhe kërcënim dhe ndjekje.

Në këtë ndërlidhen raste në të cilat anëtarë të Bordeve Zgjedhore veprojnë në mënyrë të paligjshme ndaj vëzhguesve të CIVIL-it, i marrin autorizimet ose në mënyra tjera e pengojnë punën, e të mos flasim për komente të ashpra dhe provokuese, pyetje dinake që janë në kundërshtim me procedurat dhe autorizimet e Bordeve Zgjedhore.

Kjo nuk është e pranueshme! CIVIL doli me disa thirrje publike deri te institucionet që ta mbrojnë të drejtën e vëzhguesve të akredituar për ta kryer punën e tyre në mënyrë të papenguar, gjatë ditës së zgjedhjeve dhe edhe një herë, në këtë Raport, kërkon që kjo praktikë të merr fund.

Pengime në punën e vëzhguesve të CIVIL-it shënohen në 21 raportim, edhe atë në komunat: Manastir (2 raste), Vallandovë (1), Gazi Babë (2), Gjevgjeli (2), Gostivar (1), Demir Hisar (1), Kavadar (1), Krushevë (1), Kumanovë (1), Ohër (1), Prilep (2), Probishtip (1), Saraj (3), Strumicë (1) dhe Shtip (1).

12. DHUNË

Dita e zgjedhjeve kaloi qetë dhe pa dhunë, është konstatimi i përgjithshëm i misionëve vëzhgues të vendit dhe të huaja. CIVIL i bashkëngjitet këtij vlerësimi të përgjithshëm, por jo plotësisht.

Janë regjistruar 9 raste të dhunës gjatë ditës së zgjedhjeve, edhe atë në komunat: Manastir (2 raste), Vallandovë (1), Veles (1), Kavadar (1), Kërçovë (2), Resnje (1) dhe Saraj (1).

Është karakteristik rasti i shënuar nga një vëzhgues i CIVIL, i cili informon se një person me aftësi të kufizuara ka qenë i mbyllur në garazh, që të parandalohet të votojë. Policia ka intervenuar pas paraqitjes së vëzhguesit të CIVIL.

13. DHUNË ME ARMË

CIVIL nuk shënon raste të dhunës me armë gjatë ditës së votimeve. Megjithatë, përdorimi i armëve të zjarrit në raste të gjuajtjes festive shënohet në 27 raste në tërë vendin, duke i përfshirë shumicën e komunave edhe në Qytetin e Shkupit.

14. PARREGULLSI TJERA

Në këtë kategori janë të zhvendosura 43 raste të cilat kanë të bëjnë me parregullsi ose gjendje të cilat nuk i përkasin asnjë kombinimi paraprak, ose janë kombinim i më tepër kategorive të ndryshme të parregullsive.

Në këtë kategori është e rëndësishme të shënohet se një numër i madh i vendvotimeve nuk kanë qasje adekuate për personat me aftësi të kufizuara. Kjo gjendje vërehet në disa procese tjera zgjedhore dhe e shkaktoi vëmendjen dhe mospajtimin e një numri të madh të qytetarëve, si dhe misionëve vëzhgues nga vendi dhe të huaja.

KSHZ duhet të sigurojë qasje deri te vendvotimet, për të gjithë votuesit.

Në këtë kategori përfshihen edhe kushtet tepër të këqija për punë në Bordet Zgjedhore në dhjetëra objekte në të cilat zhvillohet votimi. Në dy raste, qytetarët janë organizuar të dërgojnë nxehtësi në vendvotimet në të cilat anëtarët e Bordeve Zgjedhore janë ngrirë nga i ftohti.

KSHZ duhet të sigurojë kushte normale për punë në të gjitha vendvotimet në shtet.

Në dy raportime të vëzhguesve të CIVIL në Resnje shënohen votues nga Pusteci, Shqipëri, të cilët nuk janë banorë të komunës. Ata nuk kanë ditur ku duhet të votojnë dhe kane ecur

prej një vendvotimi në tjetër. Për disa nga ata, vëzhguesit tonë kanë dëshmuar se kanë votuar. Në këtë komunë është vërejtur edhe automjet me targa të Shkupit, me të cilin është kryer transporti i votuesve nga Pusteci.

Një person i panjohur ka vjedhur një fletëvotim dhe ka ikur, kështu që vendvotimin për-kohësisht e kanë mbyllur. Për këtë rast epilogu nuk është i njohur.

Në procesverbalet nga Bordet Zgjedhore rrallë regjistrohen emrat e vëzhguesve të organizatave joqeveritare, dhe shpesh as të vëzhguesve partiakë.

*

Ky Raport është përmbledhje nga materiali të cilin e ka përmbledhur ekipi analitik i CIVIL, gjatë ditës së votimeve. Burimet, fotografitë, video dhe audio regjistrimet, procesverbalet nga Bordet Zgjedhore dhe shumë materiale tjera, janë pjesë e arkivit të mbrojtur të CIVIL, i cili do t'i shërbejë organizatës për hulumtime të mëtejme, përpilimeve të strategjive dhe metodologjive për vëzhgim dhe rekomandime për reforma në vendin.

RIVOTIM NË
TEARCË,
ILUSTRIM I VOGËL
PËR PROBLEME TË
MËDHA



Tearcë, 25 dhjetor 2016

RIVOTIM NË TEARCË, ILUSTRIM I VOGËL PËR PROBLEME TË MËDHA

Rivotimi në vendvotimin 2011 në Tearcë, më 25 dhjetor të vitit 2016, paraqet një ilustrim të vogël dhe përkujtim të rëndë për probëmet e mëdha me procesin zgjedhor në Republikën e Maqedonisë. Bëhet fjalë për një vendvotim me 714 votues të regjistruar, në komunë të vogël rurale, etnikisht të përzier, për të cilën Gjykata Administrative ka gjykuar se duhet të bëhet rivotimi, pas ankesës nga Lidhjes Social Demokratike të Maqedonisë (LSDM).

Ky vend i vogël ka mundur të bëjë dallim të madh në rezultatin përfundues të betejës së rëndë zgjedhore të 11 dhjetorit. Në Njësinë e Gjashtë Zgjedhore, dallimi mes koalicioneve rivale, të udhëhequra nga qeverisësja VMRO –DPMNE dhe opozitarja LSDM, ishte 303, gjegjësisht, me rivotimin, 207 vota në llogari të partisë qeverisëse. Për këtë arsye, Tearca ishte e rëndësishme për dy partitë kundërshtarë. Fitore me dallim më të lartë për 303 vota në llogari të LSDM do të thonte edhe barazim i numrit të fituar të deputetëve, nga të tanishmet 51:49 në interesin e VMRO-DPMNE, në numër plotësisht të barazuar të deputetëve, 50:50.

ÇFARË NDODHI NË TEARCË?

Shkurtimisht, rivotimi në Tearcë ishte pothuajse si ushtrim i porositur tregues se si nuk duhet të zbatohen zgjedhjet.

CIVIL – Qendra për Liri, vëzhguesit e të cilës janë në fazë të vëzhgimit post-zgjedhor, ka caktuar vëzhgues menjëherë pas vendimit të Gjykatës Administrative për rivotim në vendvotimin 2011, më 20 dhjetor. Partitë kanë pasur vetëm tre ditë për përgatitje dhe promovim plotësues të programeve të tyre, duke pasur parasysh që një ditë para zgjedhjeve hyn në fuqi heshtja zgjedhore.

E pritur, veç më gjatë ditës së parë pas vendimit të Gjykatës Administrative, vëzhguesit e CIVIL kanë arritur deri te informatat e para se menjëherë ka filluar presion i fuqishëm zgjedhor mbi votuesit.

Ata kanë shënuar një varg parregullsishë edhe gjatë rivotimit në Tearcë më 25 dhjetor, e të cilat janë në përputhje me natrën e parregullsive të regjistruara edhe gjatë procesit zgjedhor më 11 dhjetor 2016.

Sipas raportimeve nga terreni, në katër ditët para rivotimit, të mbështetura me dëshmi nga dëshmitarë, është kryer ryshfet ndaj votuesve.

Nga votuesit është kërkuar të mos dalin në votime, ndërsa në këmbim u janë ofruar shuma të mëdha të parave, kështu që ata kanë qenë të detyruar ti lënë dokumentet t tyre personale “ në ruajtje” deri në ditën pas rivotimit, me qëllim të zvogëlohet dalja e votuesve për të cilët është supozuar se do të votojnë për opozitën. Çmimi për abstenimin nga votimi, ka qenë nga 50 deri 100 euro për votues, gjegjësisht, ka arritur edhe shuma prej 500 deri 1000 euro për familje. Tjerë votues kanë pranuar “shpërblim” financiar për votë më tepër për njërin ose tjetrin opion politik.

Përskaj tentimeve të mediave të caktuara për diskualifikim të informatave të CIVIL për ryshfet të votuesve, më në fund, këto raste ishin të vërtetuara edhe me paljmërim nga MPB në ditën e rivotimit, sipas të cilit, për dy persona është ngritur procedurë për këtë vepër.

Vëzhguesit e CIVIL –Qendrës për Liri kanë arritur edhe deri te të dhëna jozyrtare se rreth 40 letërnjoftime të votuesve në Tearce janë kthyer gjatë ditës së rivotimit.

Sa i përket heshtjes zgjedhore, ajo sikur nuk ekzistonte. Si dhe gjatë heshtjes zgjedhore para votimit më 11 djetor, kështu edhe në këtë rrethinë të vogël, edhe më tepër ishte e dukshme se heshtja zgjedhore nuk respektohet. Aktivistët partiak nga të gjitha partitë politike, pa ndalesa, kanë agjituar gjatë heshtjes zgjedhore.

Vëzhguesit e CIVIL e kanë vëzhguar rivotimin në vendvotimin 2011 në Tearcë nga ora 6:30. Materiali zgjedhor në vendvotimin nuk ka qenë i rregulluar me kohë, por ka qenë i tërësishëm. Votimi është mundësuar disa minuta pas orës 7.

UV llambat nuk kanë funksionuar. E para është prishur në ora 8:30 të mëngjesit, ndërsa e dyta është prishur në ora 8:55, që në ora 9:05 të vendoset se ato megjithatë funksionojnë. Tetë, ose më tepër votues janë kthyer kur UV llambat kinse nuk kanë punuar. E çuditshme se si pikërisht këto dy llamba nuk kanë punuar sot. Bëhet fjalë për një vendvotim!

1 Sipas raportimeve të vëzhguesve të CIVIL-Qendrës për Liri, të cilët e kanë ndjekur rivotimin në vendvotimin 2011 në Tearcë, anëtarët e Bordit Zgjedhor kanë qenë në komunikim të vazhdueshëm telefonik. Në periudhat kur nuk ka pasur votues në vendvotim, ata vazhdimisht e kanë shfletuar dhe e kanë kontrolluar Listën Zgjedhore, e pastaj janë lajmëruar, që me siguri, t'i informojnë shtabet partiake për të cilat kanë punuar, për daljen e votuesve që janë nën kontroll.

CIVIL publikisht i ka përkujtuar anëtarët e Bordit Zgjedhor, se ndarja e informatave me shtabe partiake dhe mobilizimi i votuesve është në kundërshtim me ligjin dhe procedurat zgjedhore.

Komunikimi mes Bordit Zgjedhor dhe ekipeve gazetare në momente ishte me ton të lartë, ndërsa kameramanët dhe fotoreporterët fotografonin dhe regjistronin secilin votues. Sipas vëzhguesve të CIVIL, disa qytetare dhe qytetarë janë ankuar se nuk ndjehen mirë nën vëmendje aq të madhe të mediave.

Një person pa akreditime ka hyrë në vendvotimin dhe pa leje ka regjistruar me kamerë, pas çfarë është kërkuar nga ai të ndalojë regjistrimin, por kjo nuk është shënuar në procesverbal edhe përkaq vërejtjes së vëzhguesit të CIVIL.

Bordi Zgjedhor nuk ka qenë i aftë t'i ndihmojë një votuesi i cili nuk është gjetur në Listën e Votuesve, edhe pse paraprakisht ka qenë në verzionin onlajn.

Ishte e dukshme prezenca e madhe e forcave policore në Tearcë, ku realizohej rivotimi në vendvotimin numër 2011. Policia silllej në mënyrë profesionale dhe korrekte, ndërsa prania e zmadhuar ishte me qëllim të sigurohet e drejta për votim dhe ligjshmëria e procesit.

RRËMUJË: LIS-
TA E VOTUESVE
DHE KOMISIO-
NI SHETETËROR
ZGJEDHOR



Konferencë për shtyp e Civilit para KSHZ, 9 dhjetor, 2016

RRËMUJË: LISTA E VOTUESVE DHE KOMISIONI SHTETËROR ZGJEDHOR

BILJANA JORDANOVSKA

Sipas raportimit për zgjedhjet e zbatuara parlamentare të Komisionit Shtetëror Zgjedhor, në kaptinën e dytë “Evidenca e të drejtës votuese”, gjithsej 1.784.416 votues kanë pasur të drejtën për votë më 11 dhjetor:

- 1.531.368 votues të regjistruar në Listën e Votuesve
- 230.122 votues në Listën e Veçantë me punë të përkohshme ose qëndrim jashtë vendit, ndërsa nuk kanë dorëzuar kërkesë në përfaqësitë Diplomatike-Konsullore
- 20.573 të regjistruar në ekstraktet e veçanta të Listës së Votuesve për votim në institucionet penale korrektuese
- 325 votues, anëtarë dhe zëvendës anëtarë jashtë vendit
- 13 votues, të cilët sipas ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale konsiderohen si persona të zhvendosur brenda vendit

Nga ata, 28, 341 votues nuk kanë qenë të regjistruar në Listën e Votuesve, gjegjësisht, pas kontrollimeve kryqëzuese janë regjistruar si votues të kontestueshëm.

Në ditën e votimit, më 11 dhjetor të vitit 2016, të drejtën për votë e kanë realizuar gjithsej 1.153.962 qytetare dhe qytetarë.

Sipas raportimit përfundimtar nga vëzhgimi zgjedhor i CIVIL, në ditën e votimeve në Listën e Votuesve të drejtën për votë nuk e kanë realizuar.

- Më 10 nëntor të vitit 2016 CIVIL publikon paraqitje të mbi 200 rasteve të votuesve fantazma, të dorëzuara deri te CIVIL në muajt e pranverës, të cilat deri në momentin e publikimit fare nuk kanë qenë të zgjidhura dhe ende kanë figuruar në Listën e Votuesve.
- Në datën e njëjtë në fshatin Perovë e Poshtme, Resnje, 60 fantazma, por edhe banorë nga Prespa e Vogël, që janë të evidentuar edhe me vendbanim në fshatin.
- Më 21 nëntor të vitit 2016, në Listën e Votuesve janë evidentuar 66 votues në fshatin Strimë, Komuna e Likovës. Në fshat nuk jeton asnjë banor.
- Më 28 nëntor në komunën e Resnjes, nga gjithsej 17.011 votues, për rreth 1.000 ekzistojnë indikacione serioze se janë fantazma.
- Në periudhën prej 5 deri 8 dhjetor, CIVIL ka pranuar mbi 600 paraqitje nga qytetare dhe qytetarë, të brengosur nëse do të kenë mundësinë ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre për votë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare më 11 dhjetor. CIVIL atëherë u dorëzoi gjashtëdhjetë raste të dokumentuara mirë dhe të arsyetuara shërbimeve të KSHZ.
- Mbi 1.000 qytetare dhe qytetarë nga të gjitha viset e Maqedonisë, më 11 dhjetor të vitit 2016 deri në ora 18 nuk kanë mundur ta realizojnë të drejtën e tyre votuese, mbi bazë të paraqitjeve të përpunuara për raste në këtë kategori, të cilat arritën deri në ora 18 në ditën e votimeve.
- Pas përpunimit të gjithsej 750 raportimeve nga vëzhguesit e CIVIL në ditën e votimeve, numrit prej 1.000 paraqitje të qytetareve dhe qytetarëve, iu shtuan edhe 500 votues të cilët mbi baza të ndryshme nuk kanë qenë të evidentuar në Listën e Votuesve.

Paraprakisht, në periudhë prej 25 ditë, nga 26 korriku deri 19 gushti, Lista e Votuesve përsëri ishte në inspektim publik për qytetaret dhe qytetarët, pas dështimit nga prolongimi i dyfishtë i zgjedhjeve në prill dhe qershor të vitit 2016. Nga 39.502 votues të

kontestueshëm, vetëm 8.922 paraqitje kanë arritur në adresën e Komisionit Shtetëror Zgjedhor, nga të cilët 3.620 kanë qenë të dorëzuara personalisht deri te KSHZ ose deri te zyrat e tyre rajonale, derisa 5.302 janë dorëzuar përmes aplikimit elektronik. Për numrin prej 30.467 persona të pa paraqitur, duhej në mënyrë plotësuese të vendoset në ditën e shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 18 tetor të vitit 2016.

Atëherë, pas miratimit të Raportit për inspektim publik në Listën e Votuesve më 23 gusht, Dr. Subhi Jakupi, zëvendës- presidenti i mëparshëm, tani anëtar i KSHZ, deklaroi se KSHZ nuk është fajtor për rezultatet prej 20% nga numri total i votuesve të kontestueshëm, të paraqitur në kontrollimin aktiv të Listës së votuesve, pavarësisht nga apeli publik, ftesat personale (përmes postës), fushatës në mediat digjitale dhe të shtypura, madje edhe nga aparati mobil. Sipas tyre, për dështimin kanë qenë fajtorë kushtet e motit dhe pushimet vjetore.

Kjo është periudha kur CIVIL u drejtua deri te KSHZ, për kushedi sa herë, me pyetje të lidhura me Listën e Votuesve dhe, në përgjithësi, me punën e këtij institucioni. Përgjigje nuk kemi pranuar deri në mbylljen e këtij publikimi në janar të vitit 2017.

Numrin e votuesve të kontestueshëm KSHZ e ka reduktuar në 28.341 votues, të cilët kanë mbetur me status të pazgjdhur. Atij numri, një javë para zgjedhjeve iu shtua numër i madh i qytetareve dhe qytetarëve me të drejtë vote, por pa mundësi për realizim të kësaj të drejte.

CIVIL –Qendra për Liri më 9 dhjetor të vitit 2016 tentoi t’u dorëzojë përfaqësuesve të këtij institucioni raste të dokumentuara të personave të “zhdukur” nga Lista e Votuesve. Për befasi të madhe dhe të pakëndshme, në KSHZ nuk ka pasur askush që mund ta pranojë materialin që e përgatiti ekipi i CIVIL, në tentim t’u ndihmojë së paku njëqind qytetareve dhe qytetarëve ta realizojnë të drejtën e tyre. Në KSHZ nuk gjendej askush. Në KSHZ një javë nuk pati njeri të përgjigjet në lidhjet telefonike dhe të takohet me nevojat e trupit votues, ndërsa kur dikush “ mashtrohej” të ngrejë dëgjuesen, qytetaret dhe qytetarët udhëzoheshin që vetë të gjinden nëpër labirintet institucionale. Dhe askush për asgjë nuk qe përgjegjës. Fajtorë ishin votuesit!

Si erdhi në të vërtetë deri te kjo rrëmujë në Listën e votuesve, dhe kush është përgjegjës? Komisioni Shtetëror mbeti i pazëshëm. Gjatë javës para mbajtjes së zgjedhjeve, qytetaret dhe qytetarët e ndjenë mosfunksionimin dhe jo-transparencën e institucioneve. Duket se institucionet bashkëpunonin vetëm në pengimin e të drejtës kushtetuese për votim.

PARAQITJE NGA QYTETARË, RAPORTIME NGA VËZHGUES

Raste në të cilat shtëpi të braktisura, rrënoja, madje edhe objekte jo-ekzistuese janë vendbanim i votuesve fantazma...adresa të dyfishta në vendbanim të njëjtë, me banorë të ndryshëm, nga të cilët një palë realisht ekziston, ndërsa tjerët jo..Persona të vdekur të cilët paraqiten me vite, mandej zhduken, që përsëri të paraqiten në ditën e zgjedhjeve në Listën e Votuesve...Votues fantazma, njerëz që nuk ekzistojnë, e të cilët paraprakisht ose nuk kanë qenë ose janë zëvendësuar për të vjetrit, të shlyerit..Lagje të tëra, mëhalla dhe fshatra me më shumë fantazma se sa banorë të vërtetë...Votues të cilët deri në mbylljen e inspektimit në Listën e Votuesve kanë figuruar në atë, ndërsa në ditën e zgjedhjeve nuk janë..Këto janë vetëm disa nga rastet për situatën reale në të cilën gjendej Lista e Votuesve. Thjeshtë, kjo gjendje shpesh ngjante si skenë nga ndonjë tragjikomedi surrealist.

Revolta dhe dëshpërimi te qytetaret dhe qytetarët ishte shkatërruese. Në një situatë, pas paraqitjes së dorëzuar, një qytetare iu drejtua ekipit të CIVIL me fjalët: “Me fat zgjedhjet. Unë edhe ashtu nuk kam të drejtë të votoj”.

Tregimi të cilin qytetarja e mllëfosur e tregoi në CIVIL në një rast tjetër, edhe më mirë e ilustron rrëmujën që sundonte në KSHZ, vetëm disa ditë para zgjedhjeve. Pasi nuk është gjetur në Listën e Votuesve, qytetarja J. D. Ka kërkuar shpjegim nga KSHZ. Gjatë vetëm një bisede telefonike me repartin për Lista Votuese në KSHZ, ka pranuar së paku pesë përgjigje të ndryshme! Së pari i është thënë se ndoshta tani nuk gjendet në Listë, sepse kanë problem teknik, por se “të dielën me siguri do të jetë në Listë”. Kur ajo ka insistuar ta sheh emrin e saj në listë para ditës së zgjedhjeve, i janë përgjigjur se kjo nuk është e mundur, për arsye se sipas të dhënave të tyre, letërnjoftimi i saj është me afat të mba-

ruar. Por letërnjoftimi i qytetares ka vlen deri vitin 2020! Pastaj i është thënë se qenka në listën e ashtuquajtur të votuesve të kontestueshëm, dhe se duhet të paraqitet në afatin e përcaktuar kohor për paraqitjen e personave që figurojnë si votues fantazma. Kur ajo ka shpjeguar se në adresën e saj nuk ka votues fantazma, ka pranuar përgjigje të lajmërohet në MPB dhe t'i paraqesë banorët tjerë, sepse në atë adresë paska shumë banorë. Me fjalë tjera, ta paraqet familjen e saj si fantazmë!

Në fund, përfundimi nga KSHZ është, se- Lista e Votuesve është e mbyllur dhe se emri i saj me siguri nuk do të gjendet në të, gjegjësisht, se ajo nuk do ta realizojë të drejtën e saj të garantuar votuese, edhe pse deri tani, 20 vite ka votuar në të njëjtën adresë pa problem! Kur ka pyetur se nëse dorëzon ankesë deri te KSHZ, vallë do të arrijë të bëjë diçka, ka pranuar përgjigje se kjo është e drejta e saj qytetare, por se ankesa e tillë nuk do të ndikojë mbi vendimin e tyre – të jetë e shlyer nga Lista e Votuesve!

Përveç 200 rasteve “pranverore” të cilat mbetën të pa shqyrtuara, në adresën e CIVIL vazhduan të arrijnë raportime nga qytetarë, por edhe nga ekipet tona vëzhguese, të cilët kanë paraqitur numër të madh të parregullsisve në Listën e votuesve deri në ditën e zgjedhjeve më 11 dhjetor të vitit 2016, dhe pas.

Ekipi i CIVIL Media, pas gjurmëve të raportimeve nga vëzhguesit afatgjatë dhe paraqitjeve nga qytetarët dhe qytetarët, ka publikuar një numër të madh të rasteve në ueb-faqen e CIVIL, ndërsa mediat e pavarura kanë marrë një numër të madh nga këto, dhe në mënyrë plotësuese e kanë hulumtuar temën. Në këtë Raportim do të transferojmë një pjesë nga gjetjet të cilat i ka publikuar CIVIL Media.

Sipas Listës së publikuar në vendbanimin Strimë, Komuna e Likovës, në vendvotimin 1123, në shkollën fillore “Dituria”, duhet të votojnë 66 banorë. Në fshatin Strimë nga viti 2000 gjatë verës mund të gjendet ndonjë njeri, ndërsa në disa vitet e fundit jeton vetëm një njeri, por gjatë dimrit edhe ai nuk është aty. Megjithatë, në të gjitha zgjedhjet në këtë fshat paraqiten të gjithë 66 votuesit, siç informon vëzhguesi ynë afatgjatë.

Në Ohër, në bulevardin “Turistiçka” nr. 24, jeton vetëm një person, T.L. ndërsa në adresë janë të regjistruar persona të cilët nuk jetojnë e që nuk kanë jetuar asnjëherë në atë adresë. Një nga personat G.V. jeton në SHBA, ndërsa personi që jeton në këtë adresë ka paraqitur se në ditën e zgjedhjeve, do të jetë në Slloveni. Pavarësisht nga paraqitja e rregullt në KSHZ, edhe pas mbylljes së Listës së Votuesve, katër personat e paraqitur ende figurojnë në Listën e Votuesve.

Në rrugën “Spas Banxhov” nr. 12, si votues që votojnë në Njësinë votuese 1276 në Ohër, në listën e Votuesve figurojnë 12 persona të cilët nuk ekzistojnë, ndërsa në atë adresë jeton vetëm një person i cili nuk gjendet në Listën e Votuesve.

Në Resnje, Lista nuk është e pastruar nga votuesit fantazma as pas kontrollimit të fundit deri në mbylljen më 11 nëntor. Në rr. “29 Nëntori” nr. 116, familja, që prej kontrollimit të parë të Listës së Votuesve në mars të këtij viti ka paraqitur në KSHZ. Gjatë kontrollit të fundit, votuesit fantazma ende janë në Listë, por anëtari i familjes, i cili ndërkohë ka vdekur, është shlyer nga lista.

Vendvotimi 1651, fshati Nakolec, ka gjithsej 262 banorë sipas regjistrimit nga viti 2000, ndërsa tani janë evidentuar 325 votues. Vendvotimi 1652 i cili i përfshin banorët e dy fshatrave: Krani dhe Arvati me 553 banorë, ndërsa janë të evidentuar 702 votues. Vendvotimi 1649 në fsh. Brajçino është me 134 banorë, dhe 180 votues. Në këtë vendbanim, sipas gjetjeve tona, jetojnë gjithsej 60 njerëz dhe gjatë një viti, mezi një person arrin moshën madhore. Vendvotimi 1670 në fsh. Stenje, mes tjerash ka 8 votues nga fsh. Oteshevë. Ndërsa Otesheva nuk ka banorë, sepse është vetëm lagje turistike dhe njerëzit aty shkojnë vetëm gjatë verës, për fundjavë ose pushime. Vendvotimi 1659 në fshatin Grnçarë ka gjithsej 417 banorë, por 644 votues.

Tre banorë të Resnjes të cilët kanë gjetur se kanë votues fantazma në adresat e tyre, i kanë paraqitur rastet me kohë. Kanë dorëzuar ankesa deri te KSHZ, por nuk ka pasur efekt. Ndërkohë një nga tre personat ka vdekur, por të afërmit e tij thonë se ai me emergjencë është shlyer nga Lista e Votuesve, ndërsa fantazmat edhe më tej janë aty.

Në Shkup në rr. “Pushkinova” nr. 5/2-10, gjatë kontrollimit të Listës së Votuesve në prill, në inspektimin e fundit janë shtuar ende votues fantazma. Kjo adresë me të rejën është e regjistruar si rr. “Pushkinova” nr. 1/2 -10 dhe votuesit janë të zhvendosur në tjetër vendvotim, gjegjësisht, nga vendvotimi 2740, në vendvotimin 2739. Pavarësisht nga paraqitja e rregullt në KSHZ, edhe në mars dhe në gusht, askush nuk ka reaguuar për këtë paraqitje.

CIVIL e ka shpallur publikimin “Zgjedhje të lira: Kusht për të cilin nuk ka negociata” në korrik të vitit 2016. Në atë janë të publikuar një numër i madh i rasteve për votuesit fantazma, si dhe një sërë raportimesh dhe analizash që mund të jenë udhëzues i çmueshëm për atë se si NUK organizohen zgjedhje, dhe se si NUK zbatohen reforma në drejtim të krijimit të kushteve për zgjedhje të lira.

DITA E ZGJEDHJEVE

“Mbi 100 votues nuk janë në Listën e Votuesve në vendvotimet 1456, 1456/1 dhe 1457 në lagjen Trizlla në Prilep”

“Në vendvotimin 1018 në Kumanovë, 25 persona nuk janë në Listën e Votuesve, ndërsa një votues figuron në dy vendvotime”.

“Në vendvotimet në Sh.F. “Murat Llabunishti” në Strugë, vërejtjet kryesore të vëzhguesve janë, se një numër i madh i votuesve, me letërnjoftime të vlefshme, nuk kanë mundur ta realizojnë të drejtën e tyre për vot, sepse nuk janë në Listën e Votuesve. Në periudhë prej 30 minuta ka pasur më tepër se 20 raste të votuesve të revoltuar pa të drejtë vote. Votuesit kanë qenë tepër të befashuar nga mosekzistimi i tyre në Listën e Votuese, pasi që paraprakisht pa problem e kanë realizuar të drejtën e tyre . Gjithashtu, Bordet zgjedhore kanë pasur probleme me gjetjen e votuesve në Listën e Votuesve, duke treguar se votues të cilët asnjëherë nuk kanë qenë jashtë vendit, janë vendosur në Listën plotësuese”.

Në rr.”Ivan Kozarov” nr. 16 në lagjen Kisella Voda, gjatë kontrollimit elektronik të Listës së Votuesve ka pasur 8 votues fantazma, në Listën e Votuesve në ditën e zgjedhjeve ende kanë qëndruar fantazmat dhe e kanë realizuar të drejtën për votë. Vëzhguesi i CIVIL ka kontrolluar se këto persona kanë votuar”.

“Në listën zgjedhore 2527 në SH.F. “Vera Jociq” në lagjen Gazi Babë deri në ora 13:00 nuk ka 10 votues në Listën e Votuesve.”

“Në vendvotimin 2807 në Komunën Qendër, familje prej 5 anëtarë nuk gjendet në Listën e Votuesve. Në vendvotimin 2680/1 në SH.F. “Bllazhe Koneski” Aerodrom, 7 familje nuk janë gjetur në Listën e Votuesve”.

“Në vendvotimin 1964 në Tetovë 15 fantazma në Listën e Votuesve dhe 27 votues që jetojnë jashtë shtetit”.

Më 11 dhjetor, me secilin votues të paraqitur që nuk figuron në Listën e Votuesve, nga vëzhguesit ka arritur informatë se Bordet Zgjedhore, të gjithë votuesit që nuk gjenden në Listën e Votuesve, i kanë dërguar deri te komisionet Komunale Zgjedhore. Kryetarët e KKZ nëpër tërë Maqedoninë, duke u konsideruar si kompetentë, i kanë dërguar votuesit deri në KSHZ ose zyrat rajonale të KSHZ, në të cilat një pjesë e madhe nga ata nuk kanë qenë në dispozicion

ose kanë dhënë përgjigje se nuk mund të veprojnë asgjë, do të ketë zgjedhje tjera, mjafton që kanë paraqitur.

Tearcë, 25 dhjetor, rivotim në vendvotimin 2011, 8 votues nuk e kanë realizuar të drejtën e tyre për votë!

“Gjendja katastrofale e Listës së Votuesve ka pamundësuar që një numër i madh i qytetareve dhe qytetarëve ta realizojnë të drejtën e tyre votuese. Fantazma dhe persona të vdekur kanë votuar, ndërsa njerëz të gjallë nuk kanë mundur të votojnë. Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) nuk arriti t’ua mundësojë të drejtën për votim të gjithë qytetareve dhe qytetarëve me të drejtë votimi. Përgjegjësit për këtë gjendje duhet të përballen me pasojat nga rrëmuja e Listës së Votuesve, dhe shkelja e të drejtës për votim. Mirëpo, nëse KSHZ e konsideron veten si institucion relevant për vendosjen e besueshmërisë së Listës së Votuesve, nëse të gjitha institucionet e përfshira në kontrollimin e kryqëzuar të listës e hedhin fajin njëri tjetrit dhe nëse veç më edhe vetë subjektet politike në zgjedhjet u pajtuan dhe e legjitimuan Listën e Votuesve si të pastruar, atëherë kush do të marrë përgjegjësinë? Qytetarët dhe qytetarët, si çdo herë.

Në pritje të zgjedhjeve lokale në vitin 2017, duhet të realizohet analizë dhe hulumtim emergjent për punën e KSHZ dhe organeve të Komisionit, si dhe reforma urgjente të këtij institucioni. Kjo në mënyrë plotësuese do të mundësojë formimin urgjent të modelit zgjedhor për pastrimin e Listës së Votuesve, si një nga bazat për mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe demokratike.” – është përfundimi i CIVIL nga vëzhgimi i zgjedhjeve, në konferencën për shtyp, menjëherë pas mbylljes së vendvotimeve më 11 dhjetor të vitit 2016.

Përgjigje, e edhe më pak përgjegjësi nga institucionet, ende nuk ka.

RAPORTIME TË
MISIONEVE TË
HUAJA VËZHGUESE
- BASHKËPUNIM ME
CIVIL



Nga seminaret e shumta të Civilit

RAPORTIME TË MISION- EVE TË HUAJA VËZHGUESE – BASHKËPUNIM ME CIVIL

BILJANA JORDANOVSKA

Me përvojën shumëvjeçare dhe metodologjitë unike, CIVIL, si organizatë për të drejtat e njeriut, u rrit në organizatë të njohur dhe relevante e cila zbaton vëzhgim të proceseve zgjedhore. Ky konstatim bazohet mbi interesin e madh dhe besimin të cilin e shprehin qytetarët dhe qytetarët e Maqedonisë ndaj organizatës CIVIL, por edhe një numër i madh i organizatave në nivel ndërkombëtar.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Republikën e Maqedonisë, prej të cilave pritej të jenë vendosëse për shumë çështje të cilat ndikojnë mbi zgjidhjen e krizës politike në Maqedoni, ka tërhequr vëmendje të madhe nga misionet e huaja vëzhguese. Pa përjashtim, të gjitha misionet ndërkombëtare dhe diplomatike në vend, e kanë ndjekur punën e CIVIL, kanë kërkuar informata dhe mbështetje, ndërsa me një numër të madh të organizatave ndërkombëtare është krijuar edhe bashkëpunim i rëndësishëm në periudhën e kaluar.

Përfaqësues të CIVIL kanë mbajtur mbi 30 konferenca dhe prezantime për përfaqësuesit më të lartë, si dhe për vëzhguesit nga misionet ndërkombëtare vëzhguese dhe përfaqësitë diplomatike. Në terren, ekipet e vëzhgimit të CIVIL, kanë qenë plotësisht të

hapur dhe bashkëpunues, kështu që i kanë ndarë informatat e tyre dhe u kanë dhënë mbështetje vëzhguesve ndërkombëtarë gjatë ditës së votimit më 11 dhjetor. Në këtë raportim do të ndajmë pjesë nga raportimet për vëzhgimin zgjedhor nga disa organizata me të cilat ka bashkëpunuar CIVIL.

SILBA – INICIATIVË PËR DIALOG DHE DEMOKRACI (DANIMARKË)

SILBA – Iniciativa për dialog dhe demokraci nga Danimarka (www.silba.dk) është mision i huaj me afat të shkurtë të vëzhgimit të zgjedhjeve, e cila në bashkëpunim me CIVIL, ka arritur të mbulojë 67 njësi zgjedhore në rajonin e Shkupit.

Të ndarë në 7 ekipe, me 14 vëzhgues afat-shkurtë, vëzhguesit e SILBA, të cilëve përfaqësues i CIVIL u mbajti prezantim detajor, me sukses e kanë aplikuar diturinë nga trajnimet e CIVIL për vëzhgim të zgjedhjeve në Maqedoni, me qasje të veçantë ndaj parregullsisive për të cilat duheshin të kujdesen gjatë vëzhgimit të tyre.

Sipas raportimit përfundimtar, dita zgjedhore ka kaluar relativisht e qetë. Vërejtjet e tyre kanë të bëjnë me gabime teknike, atmosferë të tensionuar nëpër vendvotime, posaçërisht para orës 19:00.

Në raportimin e SILBA referohet vërejtje serioze për qasjen e pamundësuar të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha vendvotimet te të cilat kanë kryer vëzhgimin.

Nga vëzhguesit e SILBA shënohen disa raste të votimit familjar, sjellje pa-përkatëse të vëzhguesve partiakë të pranishëm në vendvotimet, dhe ndërhyrje në punën e Bordeve Zgjedhore, si dhe sugjerime votuesve se për cilin të votojnë.

Sipas raportimit të SILBA, probelmin më të madh e kanë vërejtur pas mbylljes së vendvotimeve dhe procesit të numërimit të votave.

Në tre nga gjashtë vendvotime në të cilat kanë qenë të pranishëm vëzhguesit e tyre, në punën e Bordit Zgjedhor kanë marrë pjesë edhe vëzhguesit partiakë, në numërimin e votave dhe vlerësimin e tyre si të vlefshme ose të pavlefshme. Sipas tyre, kjo sjellje ka ndi-

kuar mbi besueshmërinë e votave, shumë dhe rritjen e rrezikut nga sjellja mashtruese.

Vërejtje edhe më të madhe në raportimin e SILBA, referohet për zbatimin kaotik dhe të parregullt gjatë numërimit të votave, i cili në vend se të zhvillohet pas dyerve të mbyllura, dhe se vëzhguesit partiakë dhe vëzhguesit nga organizatat qytetare, vazhdimisht kanë hyrë ose kanë dalë nga vendvotimi.

Gjithashtu, anëtarët e bordit zgjedhor nuk e kanë respektuar Kodin Zgjedhor dhe mosnjohja e tyre e udhëzimeve për zbatimin e procesit të numërimit të votave, ka qenë e dukshme.

KËSHILLI PËR DIPLOMACI PUBLIKE I KATALONISË (DIPLOKAT)

Me ftesë zyrtare nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ), më 27 nëntor, Këshilli për Diplomaci Publike i Katalonisë (DIPLOKAT), ka krijuar Misionin për vëzhgim të zgjedhjeve (DEOM) për vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare me 5 ekipe vëzhguese të vendosur nëpër tërë vendin gjatë periudhës prej 10 ditë.

Misioni ishte i përbërë nga 5 ekipe me 12 vëzhgues të vendosur nëpër tërë vendin në periudhë prej njëmbëdhjetë ditë, nga 4 deri më 14 dhjetori. Nga 27 nëntori, misioni ka realizuar takime me numër të madh të qytetarëve të Maqedonisë dhe pjesëmarrës në procesin zgjedhor, siç janë përfaqësues të Komisionit Shtetëror Zgjedhor, parti politike, grupe vëzhguese, organizata qytetare, akademikë dhe gazetarë.

Komunikimi dhe bashkëpunimi mes CIVIL dhe DIPLOKAT, përveç me takime pune dhe prezantime, zhvillohej edhe përmes vëzhguesve të CIVIL, të cilët i udhëzuan për vendvotime kritike, drejtime për vëzhgim dhe vrojtim të fushatës zgjedhore në nivel lokal.

Vëzhguesit e tyre kanë vizituar 55 vendvotime në gjashtë njësitë zgjedhore, të ndarë në ekipe.

Në raportimin e DIPLOKAT, shënohet se personave me aftësi të kufizuara, të sëmurëve dhe personave në paraburgim shtëpiak nuk u janë siguruar kushte për votim në privatësi.

Në ditën e zgjedhjeve paravanët për persona me aftësi të kufizuara janë larguar nga anëtarët e Bordit Zgjedhor në disa vendvotime, ndërsa, pothuajse të gjitha vendvotimet nuk kanë pasur qasje, e disa nuk kanë qenë as në nivel përdhësë, në objektet nuk ka pasur rampa ose elevatorë që të sigurohet qasja më e lehtë e personave me aftësi të kufizuara.

Përfundimi i misionit është se, pavarësisht nga atmosfera e qetë të zgjedhjeve, numri i madh i parregullsive len vend për përmirësim.

FORUMI EVROPIAN I STUDENTËVE (AEGEE)

Forumi Evropian i studentëve (AEGEE), është një nga organizatat më të mëdha interdisciplinare në Evropë. Në kornizat e aktiviteteve të tyre bëjnë vëzhgime të proceseve zgjedhore në tërë Evropën. Në misionet vëzhguese janë të kyçur të rinjtë që bëjnë vëzhgimin dhe vlerësimin e cikleve zgjedhore.

Sipas forumit Evropian studentor, të rinjtë në Evropë janë në masë të pamjaftueshme të kyçur në zgjedhjet.

Mes 6 dhe 12 dhjetorit, Forumi Evropian Studentor, për vëzhgimin e zgjedhjeve në Maqedoni ka vendosur 21 vëzhgues nga 16 vende, në 90 vendvotime në Shkup – Karposh, Gjoççe Petrov, Butel, Gazi Babë, Çair, Shuto Orizarë, Qendër, Manastir, Kumanovë, Saraj, Tetovë dhe Veles, me vlerësim të pjesëmarrjes së të rinjve në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të mbajtura më 11 dhjetor.

Sipas raportimit të tyre, 20% deri 30% nga votuesit që dolën në ditën e zgjedhjeve, ishin të rinjë. Organizata thekson se nuk ekzistojnë të dhëna statistikore për strukturën e moshës së votuesve. Megjithatë, konstatojnë se në krahasim me vitin 2014, pjesëmarrja e të rinjve në politikë në Maqedoni, është në rritje.

Vlerësimi i tyre i përgjithshëm është se të gjitha partitë politike kanë kandidatë të rinj në listë, edhe pse nuk qëndrojnë lartë në listat e tyre.

Forumi Evropian Studentor vlerëson se të rinjtë me moshë nën 30 vite, në vendvotimet e vizituara ishin të përfaqësuar në numër të kufizuar në Bordet Zgjedhore, si vëzhgues të partive dhe vëzhgues tjerë të vendit.

Për pasqyrë më të qartë të gjendjes politike dhe mënyrës së zbatimit të zgjedhjeve në Maqedoni, ata kërkuan mbështetje, informata dhe brifingje nga CIVIL, si organizatë relevante në monitorimin e zgjedhjeve.

QENDRA NDËRKOMBËTARE E STUDIMEVE PËR ZGJEDHJE (QNSZ)

Qendra Ndërkombëtare e Studimeve për Zgjedhje (QNSZ), është organizatë joqeveritare e formuar në vitin 2013 nga Qendra Ndërkombëtare Liberale e Suedisë (QNLS) dhe Qendra për Studime të Evropës Lindore, me qëllim –promovimin e vlerësimit jopartiak të procesit zgjedhor, edukimit dhe përhapjes së praktikave më të mira në administratën zgjedhore, ligjet dhe rregullat në bazë të standardeve ndërkombëtare.

Më 11 dhjetor, Qendra Ndërkombëtare e Studimeve për Zgjedhje, ka dalur me 16 vëzhgues nga lëvizja Ruse GOLLOS, 1 vëzhgues nga Qendra Ndërkombëtare liberale e Suedisë (QNLS) dhe 3 vëzhgues nga Qendra për Studime të Evropës Lindore. CIVIL, me kërkesë të Qendrës Ndërkombëtare të Studimeve për Zgjedhje, ka mundur mbështetje të plotë ndaj këtij misioni dhe i ka ndarë informatat dhe gjetjet me vëzhguesit e tre organizatave të cilat e përbënin këtë mision.

Nga përfundimet e vëzhgimit zgjedhor të Qendrës Ndërkombëtare të Studimeve për Zgjedhje, veçohet se:

- Duhet të sigurohet barazi më e madhe gjinore në Bordet zgjedhore,
- Vendvotimet të jenë funksionale për personat me aftësi të kufizuara
- Të rregulloet numërimi i votave, me qëllim të shmangies së anshmërisë dhe ndërhyrjes së vëzhguesve në punën e Bordeve zgjedhore.

Vërejtje interesante e këtij misioni është foto dhe video kufizimi dhe në këtë mënyrë dokumentimi i shkeljeve të mundshme zgjedhore nga vëzhguesit. Ata e interpretojnë Kodin tonë Zgjedhor në atë mënyrë që theksojnë që në atë qëndron se është i ndaluar fotografimi ose regjistrimi i fletëvotimit gjatë votimit. Me këtë, sipas tyre, në të gjitha rastet tjera, vëzhguesit duhet të kenë mundësi për dokumentim në ditën e zgjedhjeve.

Megjithatë, CIVIL ka këshilluar të mos fotografohet brenda në vendvotimet dhe ka dërguar instruksione plotësuese dhe të sakta deri te vëzhguesit e tyre që në asnjë mënyrë të mos përdorin kamera brenda, në vendvotimet.

MAQEDONISË I
DUHET NJË
XPROCES I
NGJASHËM ME
DENACIFIKIMIN



D-r. Sasho Ordanoski, pres qendra e Civilit, 11 dhjetor 2016

MAQEDONISË I DUHET NJË PROCES I NGJASHËM ME DENACIFIKIMIN

DR. SASHO ORDANOSKI

Procesi zgjedhor në Maqedoni, i cili sapo përfundoi, mund të vlerësohet nga dy aspekte. Njëri është mënyra në të cilën u zbatuan zgjedhjet, teknikisht dhe politikisht. Aspekti i dytë është rezultati zgjedhor. Në gjithmonë këto analiza përqipemi t'i fillojmë me qëndrimin se Maqedonia ende nuk është një vend demokratik dhe se në kushte të tilla, zbatimi i zgjedhjeve është çështje e kompromiseve paraprakisht të vendosura të cilat pranojnë. Ndryshimet demokratike s'do të ndodhin vetvetiu, por ky duhet të jetë një proces në të cilin një vend jodemokratik do të bëhet demokratik. Në kushte të tilla, do të thotë jo demokratike në tërësi, Maqedonia kishte, nga aspekti teknik, zgjedhje të realizuara korrekte. Me shumë lëshime, kuptohet, në të cilat edhe një herë u vërtetua se problemet kryesore janë në dy nivele.

Problemi kryesor në Maqedoni janë partitë politike dhe, sidomos në rastin tonë, ajo në pushtet, gjegjësisht partitë politike në pushtet, nga burojnë të gjitha keqpërdorimet e mundshme në mënyra të ndryshme mbi procesin zgjedhor. Simbioza mes këtyre partive politike dhe organeve dhe trupave gjoja të pavarura shtetërore, të cilat duhet të realizo-

jnë jo vetëm zgjedhje, por edhe politika në shtet, është aq e fuqishme dhe e politizuar, që praktikisht s'mund të vini deri te zgjedhjet e realizuara nga një strukturë institucionale shtetërore neutrale. Në këtë kuptim, pjesa më e madhe e problemeve doli në atë nivel.

Dhe, i dyti është, gjithmonë, niveli personal. Në fund të fundit, se si do të realizohen zgjedhjet varet, në pjesën më të madhe, nga dhjetë njerëz dhe nga integriteti profesional dhe, po deshët, njerëzor të këtyre njerëzve. Organizimi mund të ishte edhe më i mirë, ndërsa me këtë kapacitet dhe integritet njerëzor të mos arrihej qëllimi, dhe e kundërta. Kështu, në parim, Maqedonia edhe këtu e pa pasqyrën e vet.

Ekziston problemi me integritetin e njerëzve të cilët janë në pozita kulmore, të obliguar për realizimin e zgjedhjeve. Ata janë rezultat i kompromiseve të llojllojshme politike, ndikimeve partiake etj. E qartë është se këta njerëz nuk ia dalin të grumbullojnë integritet të mjaftueshëm profesional dhe njerëzor për të thënë "Jo" atëherë kur duhet thënë "Jo" dhe t'u përmbahen disa parimeve dhe fjalës së ligjit, atëherë kur kjo gjë është e domosdoshme. Në këtë kuptim, ne i patëm lëshimet e pritura.

Sidoqoftë, erdhëm deri te rezultatet zgjedhore të cilat nuk janë kontestuar. U konstituua Kuvendi me legjitimitete të deputetëve, pa dallim nga e tërë asaj që u tha ndërkohë, mandatet e deputetëve të të cilëve nuk janë kontestuar. Kjo është njëra pjesë e vlerësimit të procesit zgjedhor.

SHOQËRIA MAQEDONASE ËSHTË VIKTIMË E AMBIENTIT JODEMOKRATIK

Pjesa e dytë janë rezultatet zgjedhore. Ne, më duket, fituam një pasqyrë të qartë të asaj se çfarë në të vërtetë ndodhi në Maqedoni. Edhe matematika apo statistika në një mënyrë shumë të shkathët luajti me parashikimet dhe analizat politike të cilat bëheshin muajt, madje edhe vitet e kaluara. E shihni se Maqedonia autokrate vazhdon të ketë përkrahje dhe e shihni se një Maqedoni pro demokratike ka përkrahje edhe më të madhe. Dhe, kjo s'duhet të na habitë, sepse shoqëria jonë është e ndarë.

Shoqëria jonë është viktimë e ambientit jodemokratik. Edhe në kushte të tilla jodemokratike, është çudi e vërtetë të prisni se pushteti do të rrëzohet me metoda demokratike.

Prandaj, fitorja e atyre të cilët dëshirojnë ndryshime është aq e rëndësishme, sepse ajo është e shprehur qartë, në shifrën e tërësishme të njerëzve të cilët kanë votuar për ndërrimin e këtij pushteti.

Mendoj se Maqedonia në këtë çast është zbratur nga përmbajtja politike rreth formimit të pushtetit. Është e qartë kahja e votuesve shqiptarë etnik, të cilët në një pjesë të madhe janë përcaktuar për ndryshime, të cilat janë tej përkatësisë etnike.

MAQEDONIA S'MUND TA ZGJIDHË KRIZËN POLITIKE VETËM ME NJË PROCES ZGJEDHOR

Pjesa më e madhe e analizave të cilat u bënë para zgjedhjeve dhe, sidomos, pas zgjedhjeve, aludojnë se Maqedonia s'mund ta zgjidhë krizën e thellë politike vetëm me një proces zgjedhor. Si pasojë, cilado qeveri që të krijohet, sipas të gjitha gjasave, zgjedhje të parakohshme do të kemi në një të ardhme të afërt. Por, vendimtare është se kush do ta krijojë qeverinë pas këtyre zgjedhjeve, sepse kjo do ta përcaktojë kahen në të cilën do të ecim deri te ato zgjedhje të jashtëzakonshme.

Një qeveri e krijuar nga VMRO-DPMNE dhe BDI do ta çojë Maqedoninë drejt thellimit të krizës politike. Me një shumicë tjetër, të udhëhequr nga LSDM, Maqedonia fiton një shans që të nisët në drejtim të ndryshimeve të cilat, megjithatë, s'do të kurorëzohen me një lloj restaurimi total të demokracisë në periudhën deri te zgjedhjet e ardhshme. Por, në shumë pika thelbësore, do të restaurohen në mënyrë që këto zgjedhje të ardhshme të mund të jenë hapi i madh drejt zgjidhjes përfundimtare të krizës politike.

Mendoj se në këtë drejtim, bashkësia ndërkombëtare duhet të ketë një rol aktiv, pikërisht për shkak se njëra nga rrymat kryesore politike në vend dëshiron ta izolojë Maqedoninë nga bashkësia ndërkombëtare. Maqedonia s'do të ekzistonte as si shtet, në rast se bashkësia ndërkombëtare nuk qëndronte prapa saj. Kjo duhet thënë qartë, zëshëm dhe hapur dhe vazhdimisht duhet përsëritur.

Maqedonia është shtet i cili ka një kapacitet të tillë demokratik dhe një histori demokratike çfarë e ka dhe kjo vazhdon të kërkojë një rol aktiv të bashkësisë ndërkombëtare, e cila

deri më tani, kryesisht, është treguar si pozitive. Prandaj, ne na presin procese të këtij lloji në periudhën në vijim. Sidoqoftë, këto procese thellë do të reflektohen mbi Prokurorinë e Posaçme Publike (PPP).

PPP është, sipas të gjitha gjasave, institucioni më i rëndësishëm rreth të cilit do të shkojë restaurimi demokratik i Maqedonisë. Por, s'do të jetë PPP viktima kryesore, në rast se nuk vjen deri te ndryshimi i pushtetit. Viktimë do të jetë i tërë sistemi demokratik, e me një zhvillim të tillë të ngjarjeve, PPP do të jetë një institucion i cili do të zhduket ose s'do ta kryejë punën. Domethënë, ne jemi drejtuar para një zgjedhjeje të qartë. Rezultati zgjedhor tregon se ky proces s'do të jetë i thjeshtë.

MAQEDONIA GJENDET PARA ARDHMËRISË SË VET

Maqedonia është një vend të cilit domosdoshëm i duhet një proces i riprogramimit të tërësishëm të sistemeve kyçe. Kjo është një manovër shoqërore, shumë e ngjashme me atë që në një kohë quhej "denacifikim". Neve, de fakto, na duhet një proces i cili do të na nxjerrë nga kahja shumë e gabuar në të cilën ecim gjatë viteve të kaluara. Fituam një gjeneratë njerëzish të cilët nuk mbajnë mend asgjë më të mirë nga kjo që u ndodhë. Fituam një gjeneratë njerëzish të cilët janë të gatshëm të largohen nga vendi, madje edhe pavarësisht asaj se kush dhe si do të sundojë me të. Këto procese s'mund të pengohen me formimin e sërishëm të personave të njëjtë dhe platformave të njëjta si deri më tani. Dhe, prandaj them se Maqedonia tani do ta zgjedhë ardhmërinë e vet dhe ne do ta jetojmë këtë ardhmëri, si do që të bëhet zgjedhja.

FITORJA E RËNDËSISHME E SHOQËRISË QYTETARE

Shoqëria qytetare në Maqedoni, struktura, lloji i politikave që janë prezent, e pasqyron realitetin politik. S'mund të prisni që shoqëria qytetare të jetë shumë më e mirë apo më e keqe nga ajo që ndodhë në planin politik. Kjo është nga njëra anë.

Nga ana tjetër, kështu edhe duhet të jetë. Nuk shoh se pse shoqëria qytetare do të ishte 90 për qind demokratike, kur shteti ynë s'është demokratik dhe kur aktorët kryesor politik në Maqedoni s'kanë disponim demokratik. Prandaj, në shoqërinë qytetare do të shihni një gonxhe të demokracisë, siç do të shihni dhe një shprehje të klaustrofobisë, që është një shprehje reale e asaj që na ndodhë në shoqërinë qytetare.

Shoqëria qytetare maqedonase ka një problem thelbësor dhe një përparësi thelbësore. Përparësia dhe cilësia janë në atë që ajo disponon me një kapacitet ekspertësh të diturisë, që në çaste kyçe gjatë rrjedhës së krizës politike tregoi një kapacitet që herë ishte i rrafshët herë madje edhe më i mirë se kapaciteti politik dhe demokratik i atyre që do të duhej ta kenë institucionet shtetërore, partitë politike, elita politike etj. Ky kapacitet u tregua shumë produktiv dhe në fund të fundit, fitoi një përkrahje të caktuar.

Mangësia e shoqërisë qytetare është se s'ka një konstituent të madh, s'ka një bazë të madhe. Domethënë, ne kemi qindra njerëz cilësor të cilët punojnë në shoqatat joqeveritare, të cilët janë rezultat i një shoqërie korporative qytetare, të cilën e kërkon BE dhe mënyrat bashkëkohore mbi të cilat funksionon demokracia, por të cilët kanë një bazë të dobët në popullsi. Dhe, s'është kjo vetëm çështje e "grass-root", ajo që quhet nivele të shoqatave joqeveritare, por edhe kjo është realisht një shkoqje nga ajo, se si mendon një pjesë e masës popullore dhe si mendon një shoqëri qytetare eksperte e kualifikuar.

Rezultatet zgjedhore treguan se shoqëria qytetare shkoi tej pritshmërive të mia, në dy bashkësi kyçe në Maqedoni, te maqedonasit etnik dhe, do të thosha, sidomos te shqiptarët etnik. Domethënë, këta njerëz të shumtë, të cilët shëtiten para kamerave, jo vetëm në kuptimin e protestave, por edhe të analizave nëpër medie, dhanë informata të mjaftueshme dhe një sasi të ideve inovative politike, për një pjesë të madhe të njerëzve, për shumicën e votuesve në Maqedoni të përcaktohet për ndryshime. Dhe, mendoj se kjo është, jo shumë e madhe, por një fitore e rëndësishme politike e sektorit qytetar në Maqedoni, sidomos kur e kemi parasysh fuqinë e kundërshtarit. Histeria të cilën VMRO-DPMNE e prodhoi pas zgjedhjeve, mes tjerash edhe kundër sektorit qytetar, ju flet se nga ana tjetër ju keni pasur një pushtet i cili absolutisht nuk përmbahej prej asgjëje, ta shtyjë anash edhe në nivel personal edhe në atë organizativ. Dhe, prandaj, aq më e rëndësishme është fitorja, sepse sektori qytetar tregoi një rezistencë e cila është më e madhe edhe nga partitë politike. Edhe kësaj radhe me qëllim flas në shumës, nuk them vetëm VMRO-DPMNE dhe nuk them vetëm BDI, por në të i përfshij edhe partitë e tjera politike.

MAQEDONIA KA POTENCIAL PËR INCIDENTE, POR JO EDHE PËR KONFLIKTE!

Kapacitet për konflikte në Maqedoni gjithmonë ka. Çështja është se në ç'masë do të ishin këto konflikte, por kjo është edhe çështje resursesh. Dhe, çështja e resurseve është gjithmonë një çështje rreth asaj se kush do të ndalet prapa këtij lloji të konflikteve. Një gjë është të arrihet deri te incidente, ndërsa tjetër është të arrihet deri te destabilizime më serioze, të cilat kërkojnë një lloj tjetër të përkrahjes, resurseve, llojeve të tjera të motivimeve dhe mobilizimeve.

Maqedonia në këtë çast s'ka potencial për konflikte më të mëdha. Ka potencial për incidente të caktuara, por ato s'do të mund të ndodhin në rast se nuk inspirohen politikisht nga ana e strukturave formale partiake dhe rreth kësaj s'kam dyshim edhe nga ana e strukturave të sigurimit dhe të parasigurimit.

Mund të them se në 26 vitet e fundit pothuajse edhe s'ka pasur incidente më serioze në Maqedoni, prapa të cilëve një apo në tjetër mënyrë qëndrojnë strukturat e sigurimit, ndonjëherë të motivuara edhe nga jashtë, por në të shumtën e rasteve edhe nga shteti. Edhe analiza e të gjitha ngjarjeve tona të këndshme dhe të pakëndshme në këto 26 vjet do t'ju tregojë se këto struktura llogarisin edhe në kalkulime të caktuara politike me konflikte dhe incidente, për shkak të arritjes të ndonjë qëllimi politik.

Mendoj se struktura e deritanishme në pushtet absolutisht s'ka kapacitet të realizojë diçka serioze, përveç se edhe pak të fundoset në atë që mendojnë ta bëjnë dhe kjo në asnjë mënyrë s'do të dalë mirë për ta. Në fund, ata u përpoqën në maj të vitit 2015 në Kumanovë ta bëjnë atë që e bënë. Kjo përfundoi me një debakël të madh.

Në realizimin e kësaj pune në Kumanovë u përfshinë profesionistë. Nuk ishte kyçur sektori qytetar. Hynë profesionistë në kuptimin qytetar dhe në kuptimin e sigurimit dhe kjo përfundoi me fiasko me përmasa dramatike. Kuptohet, edhe si tragjedi njerëzore, sepse atje u vrana më shumë se dhjetë njerëz.

Kur ata s'mund ta realizojnë këtë me sukses, gjithçka tjetër, sidomos pas aq muajve dhe me rezultate të këtilla zgjedhore, është çështje e ekskursioneve aventuristike.

Por, mos harroni, në politikë gjithmonë ka edhe nesër!

Ju do të bëni sot një incident, ndoshta edhe nesër mund ta përsërisni, por pasnesër çfarë do të bëni? Edhe këtu u tregua se nga këto lloj politikash s'ka dobi politike, as afatshkurta, as në afat të mesëm, sidomos jo afatgjatë.



@Ladybug1490



Follow

@Ladybug1490 доаѓа ќосето вечер. Има пискотници да се слушаат. Две ипол години го малтретирате цел народ. На врата ќе ви свони.



ATY KU KA FRIKË,
NUK EKZISTON
DEMOKRACIA!



Dragan Zeliq, GONG, Kroaci, pres qendra e Civilit, 11 dhjetor, 2106

ATY KU KA FRIKË, NUK EKZISTON DEMOKRACIA!

DRAGAN ZELIQ

Së pari, duhet t'u urohet të gjithë qytetarëve të Maqedonisë për këto zgjedhje të rëndësishme, pas të gjitha krizave politike gjatë viteve të kaluara, pas të gjitha maltretimeve politike, sidoqoftë u arritën disa standarde minimale për mbajtjen e zgjedhjeve, dhe urime për daljen e madhe. Dëshiroj t'i uroj edhe organizatës CIVIL, si dhe vëzhguesve tjerë të cilët i vëzhguan zgjedhjet, sepse kjo nuk është punë e lehtë, posaçërisht në kushte të këtilla. Urime deri te vëzhguesit tuaj të cilët kanë kryer detyrë të rëndësishme dhe me përgjegjësi të madhe – të informojnë për parregullsitë zgjedhore të cilat kanë ndodhur.

VLERËSIMI I DITËS SË ZGJEDHJEVE

Pjesa më e madhe e qytetarëve kanë mundur ta realizojnë të drejtën e tyre për votim përkundër kushteve të vështira në vend. Mirëpo, hije serioze mbi procesin zgjedhor, hedhin rastet në të cilat qytetarë të caktuar të Maqedonisë, qindra, ndoshta edhe mijëra qytetarë, nuk kanë mundur ta realizojnë të drejtën e tyre për votim. Do të thotë, unë mund të votoj, ndërsa ju nuk mund të votoni, gjegjësisht, nuk jemi në pozita të barabarta. Nuk duhet të harrohet se Maqedonia është candidate për hyrje në Bashkimin Evropian, ndërsa në një vend-kandidat, gjëra të këtilla nuk guxojnë të ndodhin. Këto punë nuk ndodhin me inerci, ekzistojnë institucione të cilat duhet ta punojnë këtë dhe t'i mundësojnë secilit qytetar të mund të votojë, për fat të keq, te ju kjo nuk ndodhi.

Për fat të keq, nuk mund të them se bëhet fjalë për gabime teknike. Është e çuditshme, “fantazmat” duhej të pastrohen, ndërsa është e qartë se nuk janë të pastruar. Por, janë të shlyer njerëz të gjallë e të shëndoshë, të cilët nuk kishin frikë, të cilit kishin dëshirë të votojnë dhe ta realizojnë të drejtën e tyre qytetare, ndërsa ata ishin të panguar! Dikush mund të thotë se është gjë normale të bëhen gabime, por kur ndodh gabimi, patjetër duhet të ekzistojë një sistem, duhet t’u tregohet njerëzve dhe të gjendet mënyra t’u mundësohet të votojnë.

Pamë se sot u dhanë letërnjoftime, dhe është mirë që njerëzit të cilët e kanë këtë të drejtë, tu jepen letërnjoftime, mirëpo është e pabesueshme, njerëzit që nuk janë “fantazma” të mos mund të votojnë. Në Kroaci, nëse nuk jeni në Listën Zgjedhore, në ditën e zgjedhjeve duhet të shkoni në Zyrën e administratës së përgjithshme ku ju japin vërtetim për legjitimitetin tuaj. Dhe, me atë vërtetim shkoni të votoni. Është e pabesueshme se pse në Maqedoni nuk u veprua në këtë mënyrë në ditën e zgjedhjeve.

Unë nuk mund të largohem nga përshtypja se bëhet fjalë për veprime me motivim politik. Nuk pati vullnet të mjaftueshëm politik që të rregullohet Lista e Votuesve, kjo nuk është ndonjë shkencë e veçantë, kjo mund të bëhet dhe nuk e di se cila është arsyeja që shumë qytetarë sot mbetën pa të drejtën e tyre për votim.

PUNA E PARË ME TË CILËN DUHET TË MERRET QEVERIA E RE JANË SISTEMI ZGJEDHOR DHE ADMINISTRATA

Maqedoninë e pret punë e madhe rreth rregullimit të legjislaturës zgjedhore dhe regjistrimit të popullsisë, siç edhe Kroacia ka punë rreth legjislaturës zgjedhore. Edhe ne kemi pasur probleme me Listën e Votuesve, por tani situata është mjaft më e mirë, dhe në atë aspekt mund të përcillet ndonjë përvojë dhe dituri. Qeveria e re do të duhet t'i jep përparësi kësaj, nëse dëshiron të ekzistojë shtet ligjor, siç ka theksuar CIVIL shumë herë.

Ka një thënie –“ Më lehtë është të gjuash në mjegull”. Maqedonia nuk duhet patjetër ta rregullojë Listën e Votuesve, por atëherë, dikush do të gjuajë në mjegull. Nëse në njësi të caktuara zgjedhore sonte arrihet deri te rezultat i ngushtë, ku mund të vendosin edhe disa qindra vota, dhe me siguri se do të jetë kështu, dikush do të mund ta parashtojë pyetjen: vallë do ta vendosin fituesin ata që sot nuk patën mundësi të votojnë në ato njësi zgjedhore?

Ajo që më befason në mënyrë negative, është heshtja e institucioneve, ndërsa CIVIL flet për këtë një kohë të gjatë. Është e papranueshme që Komisioni Shtetëror Zgjedhor po aktron sikur kjo nuk është lojë e tyre, dhe sikur ata nuk janë të autorizuar të vendosin për këto çështje. Vallë nuk kuptojnë se sa është me rëndësi të shprehen dhe të tregojnë së paku diçka, që publiku të mos e humbë besimin në procesin zgjedhor? Besimi në procesin zgjedhor është gjëja më e rëndësishme. Nëse qytetarët nuk kanë besim në rezultatin zgjedhor, atëherë e tërë arqitektura politike rrënohet dhe do ata të dyshojnë në çdo gjë.

Gjatë viteve të kaluara, në Maqedoni keni pasur pushtet “të fuqishëm”, i cili ka qenë mjaft “prezent” në shumë institucione të cilat duhej të jenë të pavarura. Pasojë nga e tërë kjo është frika që u paraqit te një pjesë e qytetarëve. Unë mendoj se kjo i shënoi këto zgjedhje. Plotësisht i kuptoj qytetarët që frikësohen kur dikush do t'u lajmërohet t'i pyesë nëse kanë votuar. Qytetari ndoshta nuk dëshiron të dalë nga shtëpia dhe nuk dëshiron të votojë për asnjërin, por frikësohet se nesër mund ta humbë punën, se bashkëshortja do ta humbë punën, ose dikush nga familja, këto nuk janë situata të këndshme.

Gjatë qëndrimit tim këtu, e ndjeva atmosferën e kësaj frike, ndërsa aty ku ka frikë, nuk ekziston demokraci!

Maqedonia nuk është rast i vetëm. Edhe në Kroaci në zgjedhjet lokale ka njerëz të cilët kanë frikë nga sherifët lokalë. Kundër kësaj duhet të gjithë të luftojmë, e në veçanti për këtë, CIVIL jep kontributi të madh. Edhe MOST dhe organizatat tjera joqeveritare, ndërsa shoh se edhe mediat pak janë liruar. Mendoj se më në fund, mediat do të kuptojnë se cili është roli i tyre, sa e fortë është pozita e tyre, dhe se do të mbrohen nga presionet politike dhe do të vendosin standarde demokratike në këtë vend.

PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE

Komisioni Shtetëror Zgjedhor është i obliguar për Listën e Votuesve, në bashkëpunim me Ministrinë për Punë të Brendshme. Në një situatë të këtillë, kur KSHZ nuk ka ofruar shpjegim, nuk ka ofruar zgjidhje, janë fshehur si minjtë në vrimë, së paku do të ishte korrekte t'i ofrojnë mandatet e tyre në dispozicion, e të mos flasim për dorëheqje. Këtu bëhet fjalë për punë serioze. Këtu nuk bëhet fjalë për shkurtimin e ndonjë të drejte, por bëhet fjalë për të drejta themelore kushtetuese, të cilat janë bazë e demokracisë, e kjo nuk është punë e vogël.

Aq sa kam ndjekur, fëmijët nuk ishin vetëm sot të keqpërdorur në kontekst zgjedhor, por edhe paraprakisht kanë qenë të keqpërdorur. Kjo është për çdo gjykim, kjo është tregues se sa politikanët janë mizorë. Kudo në botë, jo vetëm në Maqedoni, flas edhe për Kroaci, politikanët të ulen në nivel aq të ulët të shfrytëzojnë fëmijë në fushata!? Kjo është për gjykim dhe është mirë që ju nga CIVIL këtë e gjykuat dhe flisni për këtë. Në Kroaci, për fat të keq, ndodhin këto gjëra edhe më tej, por Avokatja e Popullit për të drejtat e fëmijëve me automatizëm reagon.

Është në rregull të reagojnë organizatat joqeveritare, mediat të përcjellin, por pse i kemi institucionet? Ato institucione i paguajnë qytetarët e Maqedonisë dhe ato institucione duhet të lajmërohen dhe t'i gjykojnë publikisht këto gjëra! Dhe ndoshta në zgjedhjet e ardhshme kjo nuk do të ndodh më.

PROMOVIM, E JO RREZIKIM I VLERAVE DEMOKRATIKE

Nëse një qeveri, e kaluara, e tanishmja ose cila do qeveri nuk punon për ndryshime, ajo qeveri nuk punon për zhvillimin e vendit. Do të mbetet presioni nga qytetarët, presioni nga organizatat joqeveritare, do të ketë edhe media të veçanta që do të bëjnë presione. Dhe nuk janë të përjashtuara as rrugët...Nëse në mënyrë të mirë paralajmërojmë, ofrojmë zgjidhje, e ju nuk dëgjoni, atëherë do të dilet në rrugë, e pastaj do të shohim se si do të bëhet, sepse kjo është mjet demokratik. Kuptohet, në mënyrë paqësore, por edhe këtu ka nuanca.

Unë do ta tregoj rastin me Kroacinë, ne i kemi pasur HDZ me vite në pushtet, pastaj i kishim SDP, me të vërtetë për më pak vite, por njerëzit kuptuan se as HDZ e as SDP si parti të mëdha, nuk janë ajo që pretendojnë. Ishin të dëshpëruar nga ato parti të mëdha, dhe u paraqitën lojtarë të rinj, si "Most" (Ura) dhe "Zhivi zid"(Muri i gjallë). Dhe kjo është porosia kryesore politike deri te partitë politike të Maqedonisë, të kuptohet seriozisht demokracia, të lirohen mediat, të mbrohen këto vlera, ta promovojnë demokracinë, dhe të mos e rrezikojnë! Kjo është puna themelore e çdo qeverie. Në të kundërtën, do të vijnë lojtarë të rinj dhe do të marrin një pjesë të votave, që është demokratike, dhe mendoj se kjo mund të ndodhë edhe në Maqedoni.

(Dragan Zeliq, ekspert për sisteme zgjedhore dhe vëzhgim zgjedhor nga GONG, Republika e Kroacisë.)



U SHKEL E
DREJTA E
VOTËS!



Aleksandar Novakoski, avokat dhe ekspert juridik

U SHKEL E DREJTA E VOTËS!

ALEKSANDAR NOVAKOSKI

Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut përcakton se çdo qytetar ka të drejtë të jetë pjesë e shoqërisë së lirë, të mund të zgjedhë apo të zgjidhet . Standardet ndërkombëtare për zgjedhje dalin nga të drejtat politike dhe liritë fundamentale – të përcaktuara me marrëveshjet e përgjithshme dhe rajonale dhe të drejta politike.

Instrumenti themelor i përgjithshëm juridik dhe Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut. Nga e tërë kjo del edhe E Drejta Publike Ndërkombëtare edhe Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejta Qytetare dhe Politike, të cilat rregullojnë edhe rregulla dhe standarde zgjedhore. Këto dokumente u nënshkruan nga më shumë se 160 vende dhe bëhen pjesë e obligimit të detyrueshëm për vendet nënshkruese. Instrumentet ndërkombëtare kanë një fuqi politike dhe morale, ndërsa instrumentet, dispozitat dhe aktet juridike të këtilla, tani më janë të obligueshme në proceset zgjedhore në vendet demokratike.

Në tërë këtë, para së gjithash është qytetari, liritë dhe të drejtat e veta, ndërsa nëpërmjet qytetarit dhe lirive të tija, vlerësohet edhe liria në shoqëri. S'ka qytetarë të lirë pa zgjedhje të lira dhe korrekte! S'ka parlament të zgjedhur në mënyrë demokratike pa zgjedhje demokratike, korrekte dhe të lira! S'ka shoqëri të lirë, pa vendosjen e sistemit në të cilin

besojnë qytetarët. Për të qenë pjesë e bashkësisë demokratike ndërkombëtare, duhet t'i përmbushni të gjitha standardet ndërkombëtare dhe të keni legjitimitet në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Për t'u ndërtuar kjo, duhet të përmbushni një sërë parakushtesh:

- T'i zbatoni standardet zgjedhore ndërkombëtare të parapara me Të Drejtën Publike Ndërkombëtare,
- T'i zbatoni praktikat e mira zgjedhore,
- Të krijoni një ambient të mirë politik,
- Të keni një administratë të mirë zgjedhore, profesionale, legjislacion të mirë zgjedhor dhe Listë Zgjedhore të saktë,
- Të keni fushatë të matur zgjedhore, të rregullt, dhe medie të lira.
- Të keni sektor joqeveritar të mirë dhe të paanshëm dhe shumë procedura të tjera të lidhura me çështjet teknike (numërimi i rezultateve, edukimi, procedura ndaj ankesave, shpallja e rezultateve...).

KUSHTE PËR ZGJEDHJE TË LIRA

Për të pasur zgjedhje korrekte dhe demokratike dhe për të zgjedhur një parlament demokratik me legjitimitet të plotë, për të fituar një vlerësim në pajtim me standardet ndërkombëtare, nuk mjafton të keni vetëm zgjedhje të qeta dhe teknikisht mirë të realizuara.

Shteti është përgjegjës për krijimin e medieve të lira, organizatave joqeveritare të lira dhe të pavarura dhe trupa rregullator profesional dhe me këtë edhe për respektimin e ndarjes së pushtetit.

Republika e Maqedonisë është duke dalë ose është në fillimin e daljes nga kriza e madhe. Duhet ta kuptojmë se tani mund të bëjmë vetëm përpjekje dhe me këtë të arrihet deri te një vlerësim i caktuar se zgjedhjet kanë qenë kredibile dhe të qeta, teknikisht mirë të realizuara dhe është arritur një pjesë e standardeve të caktuara me dokumente

ndërkombëtare. Për të arritur deri te ky vlerësim, nevojitet një fushatë e qetë, ndërgjegje e pjesëtarëve në garën zgjedhore, ndërgjegje të organizatave joqeveritare dhe, gjithsesi, i medieve.

KSHZ duhet të zgjohet, të kuptojë se nuk është çështja vetëm e punës teknike. Punën teknike le t'ia lënë shërbimit, ndërsa anëtarët e KSHZ duhet të përgjigjen për çdo parregullsi zgjedhore, të vendosin dhe të jenë në tërësi në mbrojtje të rregullsisë së procesit zgjedhor.

Në Republikën e Maqedonisë, për fat të keq, askush nga kompetentët nuk arriti t'ua kthejë besimin votuesve në procesin zgjedhor dhe në procedurat që u ndërmorën, por edhe t'i eliminojë të gjitha vërejtjet që u evidentuan në raportet e mbikëqyrësve ndërkombëtar në zgjedhjet e mëparshme. Ne kemi vërejtje serioze për shkeljen e dispozitave të Kritereve të Kopenhagës. Një pjesë duhej ta eliminojë KSHZ, një pjesë nënshkruetit e Marrëveshjes së Përzahinos dhe një pjesë institucionet.

Nga e shkruara më lartë, ne pas këtyre zgjedhjeve duhet të ulemi dhe pikë për pikë t'i tejkalojmë të gjitha vërejtjet, ta kthejmë besimin në procesin zgjedhor. Kështu që, në zgjedhjet e ardhshme do të mund të shpresojmë për një vlerësim – Zgjedhje të realizuara në pajtim me standardet ndërkombëtare, të lira dhe të rregullta. Për zgjedhje korrekte, demokratike dhe të lira mendoj se do të nevojitet reforma shumë më serioze dhe më themelore.

S'ka parlament të zgjedhur në mënyrë demokratike pa zgjedhje të lira, korrekte dhe demokratike. S'ka qytetarë të lirë pa zgjedhje të lira, pa respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe pa vendosjen e sistemit të cilit i besojnë qytetarët. Sot zgjedhjet demokratike nuk vlerësohen vetëm sipas procedurës së realizimit të tyre, por, përkundrazi, nga aspekti i të gjitha fushave të jetës shoqërore.

Vertikalisht, nëse qytetarët janë në vend të parë, ata ndiqen nga shoqëria e lirë, mediet e lira, organizatat e pavarura qytetare... Kjo është baza e shoqërisë së shëndoshë.

Në strukturën horizontale e cila i krijon këto kushte, i pari është shteti i cili krijon një ambient të lirë, i ndjekur nga besimi i përbashkët, nëpërmjet sundimit të së drejtës, ndarjes së pushtetit dhe krijimit të institucioneve të pavarura rregullatore. Shteti duhet të gjejë mekanizma për t'u ndarë nga partitë dhe lobi grupet e tjera dhe gjithmonë të ketë mekanizma që t'i distancojë interesat e partive dhe të liderëve të partive nga interesat e shtetit.

Nëpërmjet trupave të pavarura përgjegjëse për realizimin e zgjedhjeve dhe trupave të tjera të pavarura, shteti duhet të pengojë çfarëdo manipulimi, mashtrimi, dëmtimi të vlerave, standardeve dhe t'i lirojë qytetarët nga çfarëdo ndikimi nga këto interesa të cilat i lëndojnë dhe i frikësojnë dhe të cilat ua shkelin edhe liritë e përditshme të jetesës dhe, gjithsesi, edhe shprehjen e vullnetit.

Termi demokraci dhe zgjedhje të lira është shpjeguar dhe definuar nga shumë filozofë, shkencëtarë, historianë, por kurrë nuk është definuar dhe shpjeguar nga politikanë të zgjedhur në zgjedhje të dyshimta.

VLERËSIMI I PROCESIT ZGJEDHOR

Në tërësi, procesi zgjedhor – nga shpallja e zgjedhjeve, por edhe në periudhën para shpalljes, në Maqedoni, mund të ndahet në tri etapa.

Pikë së pari, kemi problem me Listën Zgjedhore, i cili nuk u tejkalua, dhe kjo u vërtetua në vetë ditën e zgjedhjeve. Sipas meje, problemi ka të bëjë me metodologjinë joadekuate dhe këtu duhet pritur vërejtje, duke u mbështetur në faktin se Lista Zgjedhore një kohë më të gjatë është temë e të gjitha proceseve zgjedhore, varësisht nga ajo se kush çfarë rezultatesh ka arritur.

Edhe këtë herë, zgjidhja e cila u përdor dhe aktivisht u përkrah nga shumica e faktorëve ndërkombëtar dhe organizatave joqeveritare, tregoi se përsëri nuk u gjet një zgjidhje. Nuk u gjet, sepse, sipas meje, u përdor një metodologji joadekuate, për të cilën u morën vesh katër partitë politike.

E dyta, mirë është që për tërë procesin zgjedhor u morën vesh partitë politike dhe ato në tërësi e morën përgjegjësinë, domethënë u eliminuan organet kompetente për realizimin e zgjedhjeve. Kështu, tekstualisht, edhe përbërja e Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) edhe mënyra e punës së saj në tërësi u përcaktua nga katër partitë politike relevante, të cilat i dhanë përfaqësuesit e vet në KSHZ. Ndryshimi i përbërjes së KSHZ nuk tregoi asnjë përparësi me atë që u emëruan tre ekspertë.

Vetë dita zgjedhore tregoi se shumë persona nuk gjendeshin në Listën Zgjedhore. Unë

vazhdimisht bëja me dije – se kjo do të ndodhë. Dhe, kjo ndodhi. Më pyesnin: “Pse kështu? Nga?”

Mendojnë se kanë një mbulesë ligjore. Realisht, ka një mbulesë ligjore për t’u mbrojtur teza të cilën e di se KSHZ do ta mbrojë: “E, po, ligji na lejonte!”... Për të gjithë ata për të cilët me të dhëna të kryqëzuara u dëshmuua se janë joadekuat dhe për ata të cilët s’do të paraqiten.

Por, harruan disa pyetje kyçe.

Ne bëmë një kombinim të përzier të regjistrimit aktiv dhe pasiv të votuesve. Pyetja ime është: Pse nuk u pranua regjistrimi aktiv, i cili u propozua nga shumë ekspertë? Edhe unë e propozova para dy vjet. Qëllimi ishte që e tërë Lista Zgjedhore të vihet nën pikëpyetje.

Mendoj se për herë të parë kemi një numër të madh të votuesve të cilët nuk kishin mundësi ta zbatojnë të drejtën e votës, gjë që me të gjitha standardet ndërkombëtare për zgjedhje është një shkelje e rëndë e të drejtës votuese. Nuk është i njohur numri i këtyre votuesve, por sado që të jetë, bëhet fjalë për shkelje.

Më intereson se si OSBE dhe ODIHR do ta komentojnë dhe do ta vendosin këtë në raport. Sepse, në raportet fillestare, edhe ata e përmendën si problem. Por, nëse këtu kemi parasysh ligjin, ndoshta do të përmbahen nga një vlerësim më të rëndë.

E treta, kishim një ditë të qetë zgjedhore dhe zgjedhje teknikisht mirë të organizuara. Por, duke pasur parasysh kapacitetin e KSHZ, është e turpshme të mos kemi një ditë zgjedhore teknikisht mirë të organizuar sa i përket materialit, përgatitjeve...

Sa i përket fazës finale, zgjedhjet ishin të qeta, sepse partitë politike garantojnë se do të jenë të qeta. Më duhet të them se për herë të parë kishim një qasje të balancuar të medieve. Kjo ishte e dukshme dhe duhet pranuar. Dhe, tani vijmë deri te vlerësimi i punës së KSHZ. Vetëm me vërejtjet KSHZ tregoi se është i politizuar, pra, përsëri nuk u gjet zgjidhje.

Pastaj, problemi me mospublikimin e rezultateve gjatë natës. Sipas meje, kjo është e papranueshme. Këtu shihen të gjitha kalkulimet politike, të cilat pastaj treguan se, ndoshta, është punuar nën presion. Me këtë presion dhe me rezultatet e ngushta në këto zgjedhje, i tërë presioni kaloi në KSHZ dhe rreth marrjes së vendimeve për parregullsitë. Mendoj se është e papranueshme për një përbërje me tre ekspertë, të cilët sikur të ishin ekspertë

dhe nëse nuk ishin në asnjë çast të anshëm, pa dallim të diskutimeve të përfaqësuesve politik, këto vërejtje mund t'i zgjidhnin shumë shpejt. Edhe këto afate u shkelën maksimalisht. Prandaj, do të bëhen ndryshime në Kodin Zgjedhor, sepse në ciklet e mëparshme zgjedhore janë zgjidhur ndoshta nga 200-300 vërejtje. Në zgjedhjet më të lira janë hapur nga 200-300 kuti zgjedhore dhe është numëruar i tërë materiali. Këtu konsideroj se bëhet fjalë për një problem të brendshëm: koordinim, organizim dhe menaxhim me procesin zgjedhor.

VËREJTJET E CIVILIT ISHIN ME VEND

Ju siguroj se vërejtjet e Civilit ishin me vend. Nuk ndërhyj në vlerësimin e cikleve të mëparshme zgjedhore. Ato janë raporte publike dhe finale, të cilat gjenden në ueb-faqe. Në këtu, tani, do të ballafaqohemi ndoshta përsëri me vërejtje të reja, të cilat i kemi merituar. Vërtet, afatet u shkelën në mënyrë të pashijshme, të palejueshme.

Kur për një numër aq të vogël të vërejtjeve shkelen afatet, automatikisht do të thotë se bëhet fjalë për presione dhe politizim. Mua më habit se pse anëtarët e këshillave zgjedhor nga partitë politike, kur e kanë parë se ka një numër aq të madh të fletëve të pavlefshme votuese, për shembull, nuk e kanë shënuar këtë në procesverbal.

Unë e kuptoj situatën në KSHZ, sepse afati për vendimmarrje është 48 orë. Civilit, si shoqatë joqeveritare, mund të sugjerojë. Por, problemi është më i madh kur anëtarët e këshillave zgjedhor nuk kanë bërë vërejtje për fletët e pavlefshme dhe, ndërkohë, kemi dy vërejtje, nga të cilat qëllimi është i qartë, që diçka të ndryshojë. Numri i fletëve të pavlefshme neglizhohet, ndërsa ai është i madh!

Domethënë, numri i fletëve të pavlefshme është i madh dhe tani spekulimi është se ato janë bërë të pavlefshme për arsye të caktuara, se numri më i madh i fletëve të pavlefshme është formuar nën rrethana të caktuara. Për t'u ikur këtyre spekulimeve, nëse kishte anëtarë të këshillave zgjedhor të partive politike të cilët i kanë bërë vërejtjet, KSHZ do të duhej t'i hap, t'i kontrollojë dhe atëherë edhe një laiku do ta kishte të qartë se a janë të pavlefshme nga revolta, apo ka qëllime të tjera.

Mua më kujtohet një proces zgjedhor kur vërtet kishte një numër të madh të fletëve të

pavlefshme, por gjatë hapjes së kutive u caktua se 90 për qind qëllimisht (nga revolta e qytetarëve) janë bërë të pavlefshme, me emra të aktorëve ose me fjalë fyese dhe kjo mund të kontrollohet.

Habit fakti se s'ka vërejtje nga anëtarët e këshillave zgjedhor. Kam koment edhe për këtë.

Partitë e kanë ditur se bëhet fjalë për një dallim të vogël dhe nuk kanë bërë vërejtje, sepse ka pasur raste të kundërta, kur kanë bërë vërejtje dhe këtë e ka shfrytëzuar partia e cila do të humbasë. Domethënë, përsëri arrijmë deri te ajo se kanë vendosur shtabet dhe s'kanë vendosur këshillat zgjedhor.

Nuk e kam ndryshuar qëndrimin për Listën Zgjedhore. E dini edhe për akuzat se s'ka pasur regjistrim, prandaj s'bën Lista Zgjedhore. Të gjitha këto punë qëndrojnë deri diku, por për t'u keqpërdorur në zgjedhje, këtë duhet ta lejojë Këshilli Zgjedhor. Në këtë mënyrë, Lista Zgjedhore do të keqpërdoret, në të kundërtën, s'mund të keqpërdoret. E dini se në qarqe të caktuara dalja përsëri ishte 50, madje edhe 60 për qind, që do të thotë se përsëri kemi 40 për qind të cilët kanë qenë në listë, por për arsye të ndryshme s'kanë dashur të votojnë. Nëse Këshilli Zgjedhor në mënyrë të ndërgjegjshme e ka kryer punën, s'do të lejonte këto vota të keqpërdoren.

Tani, doli një problem tjetër. Njerëz të cilët kanë shkuar të votojnë dhe s'janë në Listën Zgjedhore?!

Vetëm në burg keni 600 raste. Numrin tjetër nuk e di, por mund të bëhet një analizë pas rezultateve finale, se cili është numri i personave të cilët kanë qenë në votim, por kanë qenë jashtë Listës Zgjedhore. Do ta përsëris, nuk besoj se në këto zgjedhje ka mundur të keqpërdoret Lista Zgjedhore në mënyrë që dikush do t'i lejonte dikujt të votojë. Kishte një rast dhe për të kishte vërejtje. Nëse ka pasur më shumë raste, siç kishte paraqitje nga disa organizata joqeveritare, atëherë këshillat zgjedhor e kanë fshehur veten.

Përsëri kthehemi te këshillat zgjedhor. Ata i kanë informuar KKZ dhe KSHZ, ndërsa KSHZ nuk ka reaguuar. Nëse ju kujtohet pres-konferenca ditën e zgjedhjeve, kur u tha se kjo është asgjë, se janë vetëm 20 persona, në fund dolën 330 persona, ndërsa tani më nuk e dimë numrin. Për t'u bërë një vërejtje zyrtare, duhet dikush ta përgatisë, ndërsa qytetarët janë ngopur me gjithçka. S'ka çdokush kushte të vijë në Shkup, të dorëzojë vërejtje. Dhe, e dini se ç'ndodh me dërgimin elektronik të vërejtjeve. A u sulmua ueb-faqja, pastaj nuk u sulmua, pastaj s'mund të bëhej kontrolli...

Nëse ky numër është i madh, pa dallim se përfunduan zgjedhjet, ne kemi një problem serioz!

Domethënë, ne ua kemi hequr të drejtën e votës disa mijëra personave. Ndërsa këta mijëra persona, nëse kanë votuar më parë, kanë ndryshuar mandate, siç e patë edhe në vetë rivotimin.

Sa i përket vetë rivotimit dhe vendimeve të Gjykatës Administrative, unë dhashë një deklaratë, e cila skajshmërisht u keqpërdor nga ana e medieve. Thashë se KSHZ mund të anulojë votime edhe me detyrë zyrtare, nëse vëren parregullsi gjatë votimit, të shkaktuara nga këshillat zgjedhor, nëse ka pasur ndërprerje, nëse s'kanë punuar UV llambat... Mjafton që 30 minuta të mos punojë UV llamba dhe të bëhen keqpërdorime.

Pse tërë Këshillin Zgjedhor e vë në situatë të përgjigjet dhe të kërkohen ekspertiza?

Sepse zgjedhjet e ardhshme, ndonjë parti e papërgjegjshme, dhe ne kemi të tilla, do të paraqesë 1.000 vërejtje me 1.000 ekspertiza grafologjike. Dhe s'do të kemi përfundim të zgjedhjeve për gjashtë muaj!


Nëse është kështu, le të bëhet ndryshimi i ligjit! Afati është i shkurtër... Prandaj, prolongohet afati, shpallen rezultatet përfundimtare, ndërsa të gjitha punët e tjera i hulumtojnë organet kompetente.

Nëse një nënshkrim është problematik dhe vërtetohet se është apo s'është i keqpërdorur, atëherë ku janë të gjithë këta që s'mundën të votojnë, mijëra njerëz? Domethënë, sipas kësaj, vota e qytetares, nënshkrimit të së cilës iu bë ekspertizë, është më e fuqishme sesa vota e të tjerëve? Mirë është që u hap ky rast, por çështja është se kur ballafaqohemi me një parregullsi të tillë, s'ka nevojë të kërkohet grafolog! Votimi anulohet me obligim zyrtar dhe rivotohet! Në këtë rast Gjyqi Administrativ s'do të mund të bëjë asgjë.

Ky ishte mendimi im, jo se s'është dashur të kontrollohet. Gjithçka duhet kontrolluar. Por, në këto afate, nëse ju në mënyrë permanente nuk i edukoni anëtarët e Këshillit Zgjedhor të bëjnë vërejtje për fletë të pavlefshme, mos pritni pastaj shoqatat joqeveritare ta zgjidhin këtë problem. Këtë problem pastaj askush s'do të mund ta zgjidhë.

Është e qartë se të gjithë kanë kalkuluar dhe s'kanë vënë vërejtje në procesverbalet. Ose kanë vënë dhe ne s'kemi informata të tilla, por partitë nuk i kanë shfrytëzuar për vërejte adekuate, ose nuk dimë për këtë, sepse u kanë konvnuar rezultatet.

(Aleksandar Novakovski është ekspert juridik dhe avokat, ish-kryetar i KSHZ dhe anëtar i ekipit të ekspertëve të Civilit.)



BETEJA PËR
DEMOKRACINË
NË MAQEDONI



Sandra Gavrillovska, pres qendra e Civilit, 11 dhjetor 2016

BETEJA PËR DEMOKRACINË NË MAQEDONI

SANDRA GAVRILLOVSKA

Është trishuese që në Maqedoni ende flasim dhe angazhohemi për respektimin e parimeve themelore demokratike, të cilat pa dyshim se duhet të jenë shtyllë e çdo shoqërie të shëndoshë dhe normale.

Faktorët ndërkombëtarë seriozisht dhe me qëllim të mirë, të brengosur, me panik dhe pothuajse të dëshpëruar na flasin për respektimin e parimeve themelore të demokracive bashkëkohore, mes të cilave, në veçanti për: ndarjen e pushtetit, barazinë e qytetarëve (posaçërisht para ligjit), sundimin e drejtësisë dhe gjykimin e drejtë, pluralizëm politik, zgjedhje të drejta dhe të lira...

Por nuk është lehtë ta masim shkallën e demokracisë në shoqërinë tonë, posaçërisht sipas sasisë dhe kuantitetit të vlerave të përfaqësuara demokratike.

Në kushte të barazimit të plotë të partisë sunduese me shtet, koncentrimin të plotë të çdo lloji fuqie në një familje dhe kontrollin e plotë të mendimit dhe shprehjes, mund të flitet vetëm për një shtet, gjegjësisht pushtet absolutist, dhe jo demokratik.

Pa aplikimin e konceptit të provuar dhe praktikisht të dëshmuar për ndarjen e pushtetit, për të cilën ka shkruar Xhon Llok (në - Dy traktate për pushtetin) që në vitin 1690 (!), është rëndë të flitet për organe të pavarura dhe të ndara njëri nga tjetri (ligjvënëse, ekzekutive dhe gjykatëse).

Edhe më pak mund të flitet për një sistem të kontrollimit dhe baraspeshës, qëllimi i të cilave është të parandalohet keqpërdorimi i pushtetit shtetëror.

E më së paku mund të flitet për ndonjë demokraci (të shtetit dhe pushtetit, sidoqoftë).

Në kontekst të domethënies së madhe të aplikimit dhe respektimit të parimeve themelore demokratike, një persona non grata tregoi që në kushte të mosrespektimit të parimeve themelore demokratike, nuk mund të pritet se me zgjedhjet do të përmirësohet demokracia, por, e kundërta, se kjo do të ishte (citoj): “varrim i mbeturinave nga ajo që njëherë ishte një shtet demokratik”.

Mbetet çështja nëse demokracia në Maqedoni (të cilën veç më e kam karakterizuar si të ndjeshme dhe anemike) do të fitojë shansin për shpëtim dhe mbijetesë.

Sipas të gjitha gjasave demokracia nuk do të ketë shans tjetër, ndërsa ne nuk do të kemi tjetër zgjidhje përveç nëse të gjithë aktorët në filmin me titull pune “Beteja për demokracinë në Maqedoni” lirohen nga kufizimet e frustrimeve, frikës, urrejtjes, përkatësisë politike dhe ambicjes...që demokracia të fitojë.

Objekt i kësaj analize të shkurtë për nevojat e raportit nga vëzhgimi zgjedhor i CIVIL, janë sanksionet ligjore për parregullsitë zgjedhore, vlerësimi i punës së Komisionit Shtetëror Zgjedhor, dhe vrojtim i shkurtë i kompetencave të Prokurorisë Speciale Publike.

SANKSIONE PËR PARREGULLSI ZGJEDHORE

Sistemi ynë ligjor përmban një varg përcaktimesh ligjore të cilat parashikojnë ndëshkime dhe sanksione për parregullsi zgjedhore.

Edhe Kodi Penal edhe Kodi Zgjedhor përmbajnë përcaktime ligjore për veprat penale lidhur me zgjedhjet dhe parashikojnë dënime financiare, por edhe me burg nga 3, dhe më tepër se 5 vite për vepra të kryera lidhur me zgjedhjet, si për shembull: për pengimin e zgjedhjeve dhe votimit, për lëndimin dhe keqpërdorimin e përcaktimit të votuesve, për rryshfet gjatë zgjedhjeve dhe votimit, për lëndimin e privatësisë së votimit, për shkatërrimin e dokumenteve zgjedhore, për kryerje mashtrimi zgjedhor dhe për veprime tjera kundërligjore të kryera gjatë organizimit dhe zbatimit të procesit zgjedhor.

Pra, dënimet e përcaktuara ligjore dhe sanksionet janë të parapara për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor: për partitë politike dhe koalicionet, organet zgjedhore dhe anëtarët e tyre, për zyrtarët që kryejnë punë të lidhura me zgjedhjet dhe votimet, po edhe për Presidentin dhe anëtarët e KSHZ, si dhe për anëtarët e Qeverisë.

Në thelb, problemi është vetëm aplikimi praktik i dënimeve të përcaktuara në këtë mënyrë dhe sanksionet për parregullsi zgjedhore, për të cilat faji qëndron te mos-funksionimi i sistemit ligjor, gjegjësisht, në mosfunksionimin e organeve shtetërore dhe mosplotësimin e obligimeve dhe kompetencave të tyre ligjore, posaçërisht nga ana e Ministrisë për Punë të Brendshme, Ministrisë për Drejtësi, KSHZ, Prokurorisë Publike, si dhe gjykatat (nga të gjitha instancat).

Në atë kontekst, në muajin mars të vitit 2016, nga ana e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë, u formua komisioni për ndjekjen e parregullsive zgjedhore, me qëllim për mbrojtje nga veprime kriminale ose veprime tjera kundërligjore, dhe ndjekjen e parregullsive zgjedhore të cilat do të ishin bërë gjatë organizimit dhe zbatimit të zgjedhjeve më 11 dhjetor të vitit 2016.

Mirëpo, ende nuk kemi dëgjuar për Raportim të këtij Komisioni, ose për procedurë eventuale të ngritur nga Prokuroritë themelore kompetente publike ose nga cili do organ shtetëror, për kryerjen e parregullsive zgjedhore.

Kjo është vetëm një nga dëshmitë e shumta për mosfunksionimin individual, por edhe global të sistemit juridik, në të gjitha segmentet.

KOMISIONI SHTETËROR ZGJEDHOR

Me sa duket, KSHZ në këto zgjedhje u ballafaqua me një sërë problemesh në punën e tyre, të cilat ishin të shkaktuara nga ndikime dhe presione të ndryshme të brendshme, të jashtme, të vendit, të huaja dhe lloj- lloj ndikime dhe presione tjera.

Pavarësisht nga struktura e KSHZ, e cila duhej, gjegjësisht, pritej të sigurojë punë të ndërgjegjshme, profesionale, transparente dhe ligjore të këtij institucioni, i cili është, ose së paku duhet të jetë shtyllë e një procesi zgjedhor në një shtet normal demokratik, megjithatë, mendoj se edhe në këto zgjedhje KSHZ nuk i arriti rezultatet e pritura nga puna e tyre, dhe me siguri, përsëri i dëshpëroi qytetarët, të cilët prej kohësh e kanë humbur besimin jo vetëm ndaj KSHZ, por edhe në institucionet shtetërore në përgjithësi.

Në pajtim me përcaktimet ekzistuese ligjore, Komisioni Shtetëror Zgjedhor mundet, dhe duhet të përgjigjet për keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe autorizimit, si dhe për lëndimin e të drejtës për votim, sepse me punën e tyre të papërgjegjshme dhe mosveprimin sipas kërkesave të qytetarëve për regjistrim në Listën e Votuesve, si dhe për pastrimin e votuesve joekzistues nga Lista e Votuesve, ka kontribuar për mosrealizimin e të drejtës votuese të personave të cilët e kanë këtë të drejtë, gjegjësisht, për realizimin e të drejtës votuese të personave të cilët nuk e kanë këtë të drejtë.

PROKURORIA SPECIALE PUBLIKE

Në pajtim me Ligjin për Prokurori Speciale Publike, gjegjësisht, Ligji për Prokurori Publike për përndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat dalin nga përgjimi joligjor i komunikimeve:

- Mandati i Prokurorëve Publik të zgjedhur në PSP ka kohëzgjatje prej 4 vite, me të drejtë të rizgjedhjes, ndërsa
- Funkzioni PP mbaron pas kryerjes së të gjitha hetimeve dhe përndjekjeve të cilat janë nën kompetencat e saj.

Afati ligjor i paraparë për ngritjen e hetimeve dhe procedurave nga ana e PSP është 18 muaj nga dita e marrjes së lëndëve dhe materialeve nën kompetencat e PSP.

Mirëpo, duke i pasur parasysh të gjitha pengesat në punën e deritanishme të PSP, vlerësoj se ky afat do të duhet patjetër të vazhdohet.

Ndërsa, për vazhdimin e këtij afati prej 18 muaj, do të duhet të propozohen dhe të kërkohen ndryshime të ligjit ekzistues për PSP, por për këtë gjë me siguri se duhet pasur vullnet politik nga shumica parlamentare, me qëllim që ndryshimet të kalojnë në procedurë të Kuvendit.

Vazhdimi i këtij afati prej 18 muaj, është me qëllim që PSP ta realizojë rolin e saj dhe me tërë kapacitetin të angazhohet për ngritje sa më të shpejtë të akuzave të cilat mund të dalin nga materialet që janë marrë në kompetencat e saj, si dhe për kryerjen e procedurave veç më të nisura, gjë për të cilën duhet të realizohet edhe formimi i repartit special gjyqësor, në mënyrë që puna e PSP të ketë efektin real.


Përndryshe, pavarësisht nga përcaktimet ligjore, sipas të cilave nuk ekziston rreziku nga ndërprerja e punës së PSP, megjithatë, fati dhe mbijetesja e PSP, me siguri se do të varen nga përbërja e Qeverisë së re, si dhe nga vendimi i shumëpritur i Gjykatës Administrative për vlerësimin e kushtetueshmërisë së Ligjit për PSP, gjegjësisht, për heqjen eventuale të PSP si jokushtetuese, që pa dyshim se do të ishte vendim politik, dhe jo vendim juridik i Gjykatës Administrative.

Ndërsa, shpallja e Ligjit për PSP si jo-kushtetues, do të ishte absurde dhe e pakuptimtë, në situatë kur ky Ligj në procedurë të Kuvendit është sjellur me shumicë të madhe, gjegjësisht, madje me 118 vota “për”.

(Sandra Gavrillovskaja është eksperte juridike dhe avokate, anëtare e ekipit Ekspert të CIVIL)



FINANCIMI I
FUSHATAVE
ZGJEDHORE TË
PARTIVE
POLITIKE



FINANCIMI I FUSHATAVE ZGJEDHORE TË PARTIVE POLITIKE

GORAN NAUMOVSKI

Financimi i fushatave zgjedhore të partive politike ende paraqet enigmë për qytetarët dhe qytetarët e Maqedonisë. Ndryshimet cilësore dhe plotësimet në Kodin Zgjedhor në pjesën në të cilën trajtohet kjo problematikë, të kryera pas Marrëveshjes në Përzhinë, pashmangshëm e imponojnë pyetjen nëse ato janë të mjaftueshme për parandalimin e financimit shumëvjeçar korruptues dhe kriminel, të fushatave zgjedhore, por edhe të funksionimit të partive në përgjithësi. Në Nenin 4 nga Ligji për financimin e partive politike, është qartë e përcaktuar se financimi i partive politike është publik dhe transparent, me inspektim të plotë nga ana e qytetarëve dhe organit kompetent për kontrollin e punës financiare-materiale. Gjithashtu, burimet e financimit të partive politike, janë publike dhe transparente, dhe i nënshtrohen kontrollit të organeve kompetente për punë financiare-materiale. Neni 5 nga ky ligj mundëson që çdo qytetar të ketë të drejtë të barabartë, në qasjen e barabartë në inspektimin e financimit të partisë politike, mirëpo, edhe përskaj obligimit ligjor të partive, publiku pothuajse aspak nuk ka inspektim të tillë, gjegjësisht, nuk është e njoftuar me financimin e partive dhe shpenzimet e tyre. Ekipi i CIVIL-Qendrës për Liri, në vazhdimësi e përcjell dhe e analizon financimin e partive politike me theks të veçantë mbi monitorimin e shpenzimeve në procesin parazgjedhor, dhe zgjedhor. Në interes të kohës dhe hapësirës, kjo analizë e të ardhurave dhe shpenzimeve, e bazuar mbi


raportimet e dorëzuara nga partitë politike, ka të bëjë vetëm me gjashtë partitë politike të cilat fituan më së shumti vota në zgjedhjet e parakohshme parlamentare dha mandate në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

PARTI/KOALICION	VOTA TË FITUARA	MANDATE TË FITUARA
Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	454.577	51
Koalicioni i udhëhequr nga LSDM	436.981	49
BDI	86.796	10
BESA	57.868	5
Koalicioni Aleanca për Shqiptarët	35.121	3
PDSH	30.964	2


Në bazë të raportimeve të cilat në mënyrë ligjore i dorëzon çdo parti politike, pjesëmarrëse në procesin zgjedhor, të ardhurat e realizuara për financimin e fushatës zgjedhore, si dhe shpenzimet për të njëjtën, do t'i paraqesim në mënyrë tabelore dhe me paraqitje grafike:

PARTI/KOALICION	TË ARDHURA	SHPENZIME	DALLIMI
Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	18.131.715,00	117.212.742,00	-99.081.027,00
Koalicioni i udhëhequr nga LSDM	37.497.867,00	33.923.911,00	3.573.956,00
BDI	12.686.050,00	22.684.550,00	-9.998.500,00
BESA	6.079.750,00	8.725.348,00	-2.645.598,00
Koalicioni Aleanca për Shqiptarët	1.326.145,00	1.052.030,00	274.115,00
PDSH	935.001	2.044.210,00	-1.109.209

SHPENZIME



TË ARDHURA



Nga të dhënat e prezantuara mund të shihet qartë se cila parti politike sa mjete ka siguruar për financimin e fushatës së saj, por edhe sa shpenzime ka bërë për të njëjtën.

Në strukturën e të ardhurave të partive politike dominojnë donacionet nga persona fizikë, ndërsa një pjesë nga partitë kanë paraqitur edhe donacione të larta nga subjekte juridike. Është interesant fakti se partitë politike nuk kanë shpenzuar në kornizat e lartësisë së mjeteve të cilat i kanë siguruar për financimin e fushatave të tyre zgjedhore.

Disa nga partitë kanë realizuar kursime, do të thotë, kanë shpenzuar më pak mjete nga ato të cilat i kanë pasur në dispozicion (LSDM, Aleanca për Shqiptarët), ndërsa tjerët kanë realizuar më tepër shpenzime në aspektin e të ardhurave, gjegjësisht, kanë realizuar huazime (VMRO-DPMNE, BDI, PDSH, BESA) ku në vend të parë është Koalicioni i udhëhequr nga VMRO, i cili ka realizuar borxh me shumë fantastike prej 99, 081,027, 00 mkd ose 1.611.000,00 euro.

Sipas Nenit 86, Paragrafi 1 nga Kodi Zgjedhor, secili nga pjesëmarrësit e lartpërmendur në fushatën zgjedhore, nga të cilat lista të kandidatëve janë zgjedhur kandidatë për deputetë, kanë të drejtë për kompensim të shpenzimeve për fushatën nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, në lartësi prej 15, 000 denarë për votë të fituar.

Shuma e kompensimit te partitë parlamentare është:

PARTI/KOALICION	NUMRI I VOTAVE TË FITUARA	KOMPENSIM PËR VOTË	KOMPENSIMI NË TOTAL
Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	454.577	15,00	6.818.655,00
Koalicioni i udhëhequr nga LSDM	436.981	15,00	6.554.715,00
BDI	86.796	15,00	1.301.940,00
BESA	57.868	15,00	868.020,00
Koalicioni Aleanca për Shqiptarët	35.121	15,00	526.815,00
PDSH	30.964	15,00	464.460,00


Nga kjo përlllogaritje shihet qartë se kompensimi i cili u takon me ligj partive politike, as përafërsisht nuk mund t'i mbulojë huazimet e tyre, kështu që imponohet pyetja- prej nga do të sigurojnë mjete të njëjtit për mbulimin e shpenzimeve të tepërta?

Para ndryshimeve më të reja të Kodit Zgjedhor, partitë (koalicionet) ishin të obliguara me ligj që raportin përfundimtar financiar për fushatën zgjedhore, ta dorëzojnë deri te institucionet përkatëse më së voni në afat prej 15 ditë nga dita e mbarimit të fushatës, me çfarë, periudha kohore për kurdisje të të njëjtave, ishte mjaftë shkurtë.

Me ndryshimet në Nenin 85, Paragrafi 1, nga Kodi Zgjedhor, afati për dorëzimin e raportit financiar për fushatën zgjedhore është 30 ditë nga dita e mbylljes së llogarisë së veçantë të transaksionit për atë qëllim.

Me shtesën e Paragrafit 10 në Nenin 71 nga Kodi zgjedhor, me të cilin rregullohet mbyllja e llogarisë së veçantë të transaksionit në afat prej tre muaj nga dita e shpalljes së rezultateve përfundimtare zgjedhore, në fakt, partive (koalicioneve) u jepet periudhë prej katër muaj për dorëzimin e raportimit përfundimtar financiar për financimin e fushatës zgjedhore. Kjo u mundëson partive hapësirë të madhe për dyshime të arsyetuara për ligjshmërinë e punës financiare të partive politike.

Nga këto arsye, kjo analizë nuk mund të jetë e plotë, ndërsa përgjigjen në pyetjen e parashtruar do ta pranojmë pas mbarimit të katër muajve të lejuara me ligj, kur nga raportimet përfundimtare financiare do të mund të shihet se me çfarë dhe nga cilat burime të mjeteve, partitë (koalicionet) i kanë mbuluar huazimet e mëdha për financimin e fushatave zgjedhore.



FUSHATA MË E
PISTË DERI MË
TANI



Petrit Saraçini, Pres qendra e Civilit, 11 dhjetor 2016

FUSHATA MË E PISTË DERI MË TANI

PETRIT SARAÇINI

Mënyra në të cilën u zhvillua fushata në media është një pasqyrim i mjerueshëm dhe brutal i realitetit, në të cilin gjendet shoqëria në Maqedoni, duke përfshirë edhe mënyrën në të cilën ajo tentonte të zgjidhë krizën politike dhe shoqërore nëpërmjet këtij procesi zgjedhor në vend, të cilin shumë edhe prej vetë aktorëve politikë e konsideronin si një moment kthyes në historinë e tij.

Në kushte pothuajse jonormale të krijuara prej vitesh, mjedisi mediatik ishte fushëbetejë midis përpjekjeve të pjesës demokratike dhe progresive të shoqërisë dhe publikut për kushtet minimale për mbajtjen e zgjedhjeve të besueshme, dhe pengesave e shkeljeve të vazhdueshme nga ana e pushtetit dhe mediave të afërta me të. Korniza që kjo betejë të zhvillohet në pozicione relativisht më të barabarta se më parë u bë e mundur me zbatimin e pjesëshëm të ndryshimeve ligjore, të cilat ndodhën si rezultat i Marrëveshjes së Przhinës. Por, lufta për minimum e zëvendësoi garën e vërtetë elektorale, në të cilën media shërben si një platformë për trajtimin dhe analizimin e ofertës politike dhe krijimit të një mjedisi për zgjedhje të informuar të qytetarëve. Pas gjithë asaj që e kemi parë, mediat, në shoqërinë tejet të polarizuar dhe të ndarë në Maqedoni, në baza politike, etnike, fetare dhe për shumë arsye të tjera, janë larg nga të qenit në nivelin e detyrës që është vendosur para tyre si mbrojtës të demokracisë dhe interesit publik.

Në një kornizë të tillë, këto zgjedhje, ndryshe nga ciklet e fundit zgjedhorë, ishin të ndryshme në atë që u zhvilluan në një mjedis mediatik që është pak më i favorshëm dhe më propulziv. Kishte mundësi, për shkak të rolit të rregullatorit dhe legjislationit më strikt, por për shkak të imazhit më të konsoliduar të mediave kritike dhe një pjesë e publikut, më shumë ose më pak, për të dëgjuar ofertat e ndryshme të konkurrentëve në zgjedhje, madje edhe në media, të cilat kanë qenë prej kohësh në funksion të propagandës.

Megjithatë, kjo as së largu nuk i kënaq kriteret dhe mënyrat, në të cilat duhet të raportojnë mediave për zgjedhjet dhe ofertën politike në një vend demokratik. Ende është i qartë dominimi i pushtetit dhe raportimit të njëanshëm në favor të tij në shumë media, gjë që mund të dëshmohet përmes më tepër treguesve.

Edhe në këto zgjedhje u vu re se në vend të informacionit rreth ofertës zgjedhore, analizë e asaj që ofrohet dhe ballafaqim i argumenteve, fituan fushatë mediale të dominuar nga përpjekjet për të denigruar kundërshtarët politikë, shfokusimin nga çështjet reale dhe debat për çështje të rreme. Në vend të debatit, ka pasur shumë më tepër hapësirë për propagandën njëkahëshe, të paguar ose të papaguar, sidoqoftë. Kjo është terren që e ka dominuar prej kohësh pushteti, i cili, për vite me radhë, mu me kësi lloj "të kuptimit" të medias, e solli Maqedoninë në gjendje për t'u kualifikuar si një shtet jo i lirë prej organizatave ndërkombëtare me renome. Ashtu ishte edhe tani, të paktën duke gjykuar nga paratë, sekondat dhe hapësira, të cilat i shpenzoi ose shfrytëzoi secila prej partive në media.

Mungesa e debatit, informacionet selektive dhe sipërfaqësore, gjenerimi i temave për diskutim në publik nëpërmjet agjendave të orkestruara mediatike dhe gjuha nxitëse ishin anomalitë kryesore, sidomos në 10 ditët e fundit të fushatës parazgjedhore në media.

MUNGESA E DEBATIT

Kur flasim për mungesën e debatit të vërtetë mes aktorëve politikë, duhet të theksojmë se kjo është kryesisht për shkak të refuzimit të VMRO-DPMNE-së për t'u ulur në të njëjtën tryezë me kundërshtarin politik në një ballafaqim mediatik për shumë vite. Krerët e partive nuk u përballën para qytetarëve, e as bartësit e listave. Do të mbetet si shembull i vetëm paraqitja e Nikolla Popovski në debatin në TV Alsat M me kandidatët e tjerë nga Njësia Zgjedhore 1.

Debat në televizionet kombëtare kishte TVM1, TVM2, TV Telma, TV 24 Vesti, TV Alsat M, TV21, TV Shenja, TV ART. Debat nuk kishte fare te stacionet televizive pro qeverisë, TV Sitel, Kanal 5 dhe Alfa TV. Debat kishte vetëm në TV Nova, në të cilin shpesh vërehej mungesa e përfaqësuesve nga koalicioni kryesor opozitar.

Në vend të kësaj, si një zëvendësim për VMRO-DPMNE në debatet televizive shfaqeshin analistët Pandov, Dashtevski, Nikovski, Karakamisheva, Naunovski, Kostov etj. Shembuj të konfrontimit të drejtpërdrejtë të kandidatëve të dy partive më të mëdha pothuajse edhe nuk kishte, përveç atij në Alsat dhe disa përpjekjeve me nivelet më të ulëta partiake në MTV 1 në fillim të fushatës, që më vonë u ndërprehen.

Në mediat shqiptare gjendja ishte pjesërisht më e favorshme, ka pasur më shumë debat në mes të pushtetit dhe opozitës, edhe pse me vërejtjet për shkak të refuzimit të BDI-së në pushtet, por edhe të PDSH-së, për t'ju përgjigjur ftesave për debat në disa media apo për të debatuar me partitë tjera të shqiptarëve.

Në këtë ndërlidhen problemet me qasje në burime dhe bashkëbisedues nga "ana tjetër". Për mediat kritike është pothuajse e pamundur qasja në burimet e afërta me partitë në pushtet, edhe pse ka raste ankesash edhe nga mediat pro-qeveritare, të cilat thonë se ata përballen me vështirësi për të siguruar bashkëbiseduesit nga "pala tjetër". Në këtë konstelacion, është pothuajse e pamundur për mediat që të ofrojnë informacion i cili do të jetë i paanshëm dhe objektiv, përmbajtje që do të shfaqin një ngjarje apo ndonjë gjendje të caktuar në shoqëri në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Gjatë fushatës, VMRO DPMNE e lajmëroi Televizionin Telma që nuk do të vijë në emisionet e debatit të këtij mediumi. Pas disa takimeve fillestare, debati i vërtetë mes përfaqësuesve të pushtetit dhe opozitës mungoi edhe në MTV1.

BDI e bojkotoi Televizionin Shenja, ndërsa dhe PDSH dhe BDI, përveç asaj, nuk pranorin debate me partitë e “vogla”, siç i quanin Lëvizjen Besa dhe Aleancën për Shqiptarët. Në MTV 2, për shembull, mund të shihnim në debat kandidatët Idriz Orana nga PDSH dhe Driton Kuçi nga BDI - me dy analistë.

“Mungesën” nga debatet në TV Telma në mes të fushatës e paralajmëroi edhe partia “E Majta”, duke shprehur publikisht pakënaqësinë dhe duke hyrë në polemika në rrjetet sociale me njerëz nga stafi redaktues dhe drejtues i mediumit rreth hapësirës së dhënë dhe formatit të debatit në këtë televizion.

Edhe në mediat rajonale dhe lokale, përballja mes kandidatëve dhe ofertave të tyre ishte në një nivel të ngjashëm. Për shembull, debati televiziv mes kandidatëve të Njësisë Zgjedhore 4 në TV VIS u mbajt pa Nikolla Gruevskin.

AMSHMA DHE KOMISIONI I PËRKOHSHËM PËR MEDIAT – ILAÇ QË ZBULON, POR E SHTYN DHE NUK E SHËRON SËMUNDJEN

Puna e Agjencisë për Media dhe Shërbime Mediatike Audiovizuale (AMSHMA) dhe Komisionit të Përkohshëm për monitorimin e punës së mediave gjatë procesit zgjedhor, i cili u krijua si një “trup special” në kuadër të AMSHMA, arriti vetëm shumë pak për të zbutur efektet e shumë viteve të okupimit të mediave nga qendrat e fuqisë, kryesisht ato të afërta me partitë në pushtet.

Mundësia e kumtimit të sanksioneve ka pasur një efekt të caktuar parandalues, e në media të caktuara ndoshta mund të ketë pasur edhe efekt të “ftohjes” në raportim, që nxit auto - censurën. Nga ana tjetër, në mbarë këtë periudhë, është vërejtur se Komisioni ad - hoc nuk i ka arritur vendimet me konsensus dhe ka punuar nën presion politik nga jashtë dhe brenda, si dhe se disa nga anëtarët e tij janë prononcuar në publik në një mënyrë, e cila është e papërshtatshme për zyrtarë publikë me këtë përgjegjësi specifike.

Gjatë funksionimit të dispozitave të reja të legjislacionit zgjedhor në lidhje me mediat, të cilat ishin pjesë e një marrëveshjeje politike midis katër partive, e dukshme ishte se përmbajtja e televizioneve dhe radiove, ndryshe nga më parë, ka pasur më shumë hapësirë për opozitën, dhe se shumica e mediave tradicionale elektronike përmbaheshin nga sulmet e hapura dhe gjuhës nxitëse. Kjo përshtypje me siguri se u prish në pjesën e fundit të fushatës nga media të caktuara.

Por nga ana tjetër, vërehej dukshëm se mediat përdornin mjete të tjera për të manipuluar opinionin publik, kryesisht nëpërmjet gjenerimit të disa temave, që janë trajtuar me ditë të tëra prej më shumë redaksive, dhe me të cilat opsione të caktuara politike portretizoheshin në mënyrë negative, jo vetëm në kontekstin politik, por edhe në atë etnik, fetar, si dhe në kontekste të tjera.

Redaksitë e bënin këtë duke transferuar pjesë të parëndësishme dhe jothelbësore të qëndrimeve të aktorëve politikë, me shtrembërim të tyre dhe vënie në kontekst të gabuar, si dhe duke theksuar dhe mbitheksuar ose duke minimizuar dhe fshehur ngjarje të caktuara në agjendën redaktuese, pra në radhitjen dhe përmbajtjen e lajmeve. Kjo mënyrë e raportimit, edhe pse është tërësisht në kundërshtim me standardet e gazetarisë si dhe të atyre për informim gjatë zgjedhjeve, ishte e pamundur që të trajtohet në kuadër të metodologjisë dhe përgjegjësisë të ad - hoc Komisionit, ndërsa Agjencia për Mediat, edhe pse i vuri zyrëtarisht në veprim mekanizmat që i ka në dispozicion, nuk arriti të ndikojë rrënjësisht për të përmirësuar raportimin e transmetuesve të caktuar me ndikim, si dhe të gjithë tregun mediatik në përgjithësi.

Javën e parë të fushatës Komisioni ad - hoc vendosi një propozim për vërejtje ndaj TV Alfa për shkelje të nenit 75 të Kodit Zgjedhor, për shkak se zëri i një punonjësi të televizionit dëgjohet në reklamat e një partie politike; për TV 24 Vesti për shkelje të nenit 75 - f të Kodit Zgjedhor, apo bashkimin e blloqeve të reklamave me vetëm një parti politike në to dhe për transmetimin e reklamave për zgjedhjet në programet e veçanta informative, si dhe TV Nova për shkak të reklamave të paguara politike në programin e lajmeve "Argumente" (Nen 76, paragrafi 4) dhe për tejkalim të kohës për reklamim në orë reale (neni 75 f).

Për periudhën e dytë dhjetë-ditore e fushatës, Komisioni i Përkohshëm për moni-

torimin e raportimit të prezantimit mediatik i botoi raportet e monitorimit me disa ditë vonesë. Takimi i 2 dhjetorit i Komisionit ad-hoc pranë AMSHMA nuk mbajti, për shkak të mungesës së kuorumit. Gjatë kësaj periudhe, më 5 dhjetor, Komisioni i Përkohshëm pranë AMSHMA paraqiti propozime për veprim ndaj Televizionit Nva, TV 21, Nasha TV, Televizionit rajonal Ultra, Televizionit Telma, Alsat-M. Komisioni, po ashtu, më 8 dhjetor ka paraqitur propozime për veprim për TV Nova, TV MTM, Televizionit Tri nga Kumanova dhe EF-EM 90.3 Sport Radios nga Shkupi. Të gjitha propozimet ishin në lidhje me tejkalimin e kohës reklamuese apo transmetimit të blloqeve të reklamave politike në programet informative.

Njëkohësisht, trupi ad-hoc e tërhoqi propozimin për kallëzim për kundërvajtje për TV Alfa, sepse një nga anëtarët e tërhoqi vendimin e tij pas një rishqyrtimi ku është konstatuar se Alfa TV nuk ka bërë 5 shkelje të rregullave (kuota e përcaktuar sipas metodologjisë së pranuar të Komisionit) për të "fituar" një padi për kundërvajtje nga trupi, siç ishte paracaktuar paraprakisht për të gjitha mediat.

TV Nova, më 5 dhe 6 dhjetor 2016, e ka njoftuar Agjencinë se po përballet me probleme gjatë raportimit nga tubimet e partive të caktuara politike. Agjencia, edhe në këtë rast më të fundit, e përsëriti pikëpamjen se askush nuk duhet të pengojë gazetarët dhe ekipet lajmeve në kryerjen e përgjegjësive të tyre profesionale dhe kështu të kufizojë të drejtën e publikut për t'u informuar rreth ngjarjeve aktuale shoqërore dhe politike.

Megjithatë, përshtypjen tonë se epilog dhe efekte të veçanta dhe të qëndrueshme prej rolit të rregullatorit dhe legjislacionit nuk ka, e përforcon fakti se asnjë nga propozimet e Komisionit nuk ka përfundim konkret gjyqësor. Dhe disa raste që janë shqyrtuar nga Gjykata Administrative janë refuzuar me shpjegime administrative, se kanë ndodhur jashtë periudhës për të cilën ishte kompetent të vendosë ad-hoc Komisioni.

SERVISI PUBLIK ME REDAKTOR SPECIAL TË PROGRAMIT INFORMATIV: PAMJAFTUESHËM MË MIRË

Përmirësimi në raportimin gjatë zgjedhjeve, edhe në drejtim të analizimit të ofertës, si dhe në aspektin e ndjekjes së aktiviteteve të aktorëve politikë, mund të shihej në programin e informacionit në Servisin e parë programor të Televizionit të Maqedonisë.

Mund të konkludohet se kjo është kryesisht për shkak të ndryshimit në politikën redaktuese, që erdhi me redaktoren e re të programit të lajmeve, e caktuar përkohësisht gjatë procesit zgjedhor me propozim nga opozita, siç ishte rënë dakord ndërmjet liderëve të partive më të mëdha në vend.

Kjo dha prova edhe një herë se problemi kryesor në mediat në vendin tonë qëndron në lidhjet mes redaktorëve dhe menaxhmenteve të mediave me politikën dhe pushtetin, dhe se kur ky bashkim prishet, mediat menjëherë fillojnë të prodhojnë një pamje shumë më realiste të shoqërisë.

Por, po ashtu ishte e dukshme edhe se redaksia nuk ka burime të mjaftueshme për zbatimin cilësor të prezantimit elektoral të kandidatëve dhe ndjekjen e aktiviteteve parazgjedhore të të gjitha partive politike në mënyrë përkatëse.

PRESIONE, SULME DHE KUFIZIME PËR MEDIAT DHE LIRINË E TYRE - TË ÇDO LLOJI, NË ÇDO HAP

Gjatë fushatës zgjedhore u zhvilluan edhe disa ngjarje të tjera dhe u vunë re disa fenomene që janë tregues për rrethanat e vështira, në të cilat ushtrohet e drejta e lirisë së informimit dhe e drejta për një zgjedhje të informuar.

Rasti 1: Kush i shkyçi portalet, problem teknik i provajderit apo ...?

Në fillim dhe në fund të javës së parë të fushatës janë vërejtur dy sulme mbi më shumë portale të internetit, ku ka pasur një ndërprerje prej disa orëve në qasjen ndaj

tyre në internet. Në publik, kjo shkyçje trajtohet si shumë e dyshimtë.

Provajderi UNET u prononcua publikisht, duke pretenduar se bëhet fjalë për një problem teknik.

Në fund të javës, shuarja e disa ueb faqeve, të cilat janë të hostuara te ky ofruer i internetit, u përsërit, andaj publiku me të drejtë pyet nëse kjo është më shumë se një rastësi, një tentativë për të rrezikuar lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias?

Rasti 2: Klientelizëm në KSHZ apo shantazh prej medias?

Interesimin e publikut e tërhoqi edhe rasti i fjalosjes mes udhëheqjes së gazetës “Lajm” dhe zëvendës-kryetarit të KSHZ, Rexhep Prekopuca.

Nga njëra anë, redaksia pretendonte që ka qenë e dëmtuar në ofertimin për reklamim në media nga ana e KSHZ, duke e akuzuar Prekopucën për gabim të qëllimshëm në leximin e çmimit të ofruar prej këtij mediumi për hapësirën e kërkuar reklamuese.

Nga ana tjetër, Prekopuca akuzoi për presion dhe shantazh nga ana e mediumit për të fituar tenderin. Të dyja palët paralajmëruan padi.

Rasti 3: Nuk ka të vërtetë kur është barku bosh!

Në periudhën e mbuluar me këtë raport, publiku mësoi se korrespondentët e gazetave dhe publikimeve të MPM nga vendet jashtë kryeqytetit nuk kanë marrë honorarë që nga korriku i vitit 2016!

Kjo është vetëm një prej serisë së lajmeve që vijnë nga kjo kompani për muaj dhe vite, secili më i keq se tjetri, sa i përket të drejtave të punës të punëtorëve të saj. E, ky është një prej operacioneve më të mëdha të biznesit mediatik, ku si pronarë përfshihen njerëzit më të pasur në Maqedoni.

Në qoftë është kështu te të pasurit, të afërt me resurset e pushtetit, kush e di se si është situata në mediat tjera dhe te pronarët e tyre ...

E PËR ÇFARË MË SË SHUMTI DHE SI RAPORTUAN MEDIAT GJATË ZGJEDHJEVE?

Në ofertën e mediave për zgjedhjet, në javën e parë të fushatës por edhe më tej, dominoi fushata e zezë dhe temat e lajmet “e rreme”: federalizimi, diskursi i patriotëve dhe tradhtarëve, gjuhën e urrejtjes në tubime (kafaze, burg për kundërshtarët politikë), rasti i regjistrimeve në Halkidiki që është pjesë e rastit “Spiun”, gjë që solli edhe diskursin e stigmatizimit të popullatës LGBT, disa media pro-qeveritare u morën edhe me lajmin e rreme se paska vdekur Soros, duke e kontekstualizuar ngjarjen negativisht për opozitën dhe shoqërinë civile, disa media përdorën recetën e vjetër propagandistike të “pranisë së dobët në tubime” ose “transferimeve të degëve dhe anëtarëve”, duke përsëritur kontributet me këto tema pothuajse çdo ditë ... Si kurrë më parë, spini dhe propaganda ishin punë primare e fushatës, e jo informimi.

Në këtë fushatë dhe në botimet e mediave vërehej edhe abuzim me çështjet fetare, siç ishte për shembull propaganda me botimet e mediave se nëse LSDM-ja do të vijë në pushtet, në program parashikon synet të detyrueshëm, ose në mesin e partive shqiptare, me fushatën e Lëvizjes Besa dhe sloganin “Nëse beson në Zot”, por edhe me paraqitjet e Ali Ahmetit ku adresohen çështjet fetare në mënyra të ndryshme, e që përdorej për ndërtimin e “profilit mediatic” fetar të liderit të BDI-së në pushtet.

E dukshme ishte edhe gjuha nxitëse dhe gjuha e urrejtjes, që pjesërisht ka ardhur nga retorika dhe qasja e komunikimit nga ana e një pjese të pjesëmarrësve në fushatë, por pjesërisht është prodhuar edhe nga vetë mediat, si përkrahje për temat, të cilat duhet të “dominojnë” në fushatë sipas vlerësimeve të strategëve për PR nëpër parti (sulme të tilla ndaj kundërshtarëve politikë ishin kryesisht të dukshme në mediat online). Vërehej po ashtu fshehje ose minimizim i ngjarjeve (siç ishte rasti me vdekjen e një njeriu në rrugën e tij për një tubim të VMRO DPMNE-së në Ohër, ose për shembull, raporti i mediave pro-qeveritare ndaj konferencës për shtyp të PSP-së para fillimit të fushatës). Në më tepër media pro-qeveritare, përmes temës së imponuar për gjoja rrezikun nga federalizimi dhe kantonizimi i Maqedonisë, përhapej gjuhë nxitëse që prish tolerancën ndëretnike në vend, apo sulmon kundërshtarët politikë.

RASTI I TV SITELL DHE “KOSTOJA E DYGJUHËSISË”

Shembulli më i eklatant është editoriali i TV Sitell më 6 dhjetor, me titullin “Kostoja e dygjuhësisë”. Në një komentin e redaksisë u shpalosën një mori shifrash e statistikash pa asnjë burim, të cilat tregonin se dygjuhësia do t’i kushtojë Maqedonisë 50 milionë euro, që mijëra maqedonas etnikë do të humbasin punët e tyre në administratë, arsim, shëndetësi, ndërsa do të punësohen mijëra shqiptarë të rinj. Kërcënimi arrin kulmin me shifrën e më shumë se 70.000 shqiptarëve, të cilët do të lëvizin në pjesën lindore të Maqedonisë dhe do të ndryshojnë hartën etnike të vendbanimeve. Përderisa shkojnë këto fjalë, në kronikë shihet vizatim i animacionit me hartën të Maqedonisë dhe tre shigjeta të mëdha që lëvizin nga perëndimi në lindje të vendit, e që përfaqësojnë “pushtimin” e shqiptarëve. Dhe, e gjithë kjo, pa as edhe një burim, pa asnjë fakt të vetëm, por duke u fshehur prapa floskulave “komenti i redaksisë”, “ekspertët thonë”, e paketuar me shifra, grafikë dhe animacione, që të duket hem e tmerrshme, hem e bindshme.

Për serinë e kronikave të tilla të këtij televizioni gjatë këtyre disa ditëve, AMSHMA zbatoi edhe mbikëqyrje të veçantë dhe ka përgatitur një raport prej 24 faqesh, i cili arriti në përfundimin se ka shkelje të nenit 48 të Ligjit për Media (gjuha e urrejtjes) dhe se duhet të nisët procedurë për veprim të mëtejshëm të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi - në bazë legjislacionit kundër diskriminimit, por edhe para Prokurorisë Themelore Publike, në drejtim të trajtimit të këtyre shkeljeve sipas Kodit Penal. Mbetet për të parë se si do të përgjigjet Komisioni i Antidiskriminimit dhe PTHP ndaj kësaj mbikëqyrjeje të AMSHMA të botuar më 28 dhjetor 2016, si dhe në propozimet për veprim ndaj TV Sitell.

Një qasje të ngjashme ka edhe në dokumentarin që trajton personalitetin dhe veprën e miliardërit Xhrxh Soros dhe fondacioneve të tij, i cili në ditët e фондит тч фусхатчс u transmetua në servis publik MTV1, si dhe në TV Sitell, TV Alfa, Sitel 3, Kanal 5... Dokumentar kryesisht i bazuar në gjysmë të vërteta, spekulime, teori të konspiracionit, në të cilin sigurisht se nuk harrohet që për më tepër herë të tërhiqet një paralele

mes Sorosit të keq dhe shërbëtorëve të tij vendas në fytyrën e opozitës dhe shoqërisë civile në vend.

Megjithatë, nuk është se publiku ynë nuk e di dhe se nuk është i sensibilizuar për atë që është shembullore apo jo në media. Ja, për shembull, vëmendjen e publikut në këtë periudhë e tërhoqi edhe komenti i gazetares Olivera Trajkovska në emisionin Top Tema, i cili përmbante termin “autizëm” dhe reagimi i prindit të një fëmijë me autizëm, i cili kërkoi prej gazetares dhe medias për të kërkuar falje për keqpërdorimin e termit . Redaksia dhe gazetarja nuk kërkuan falje, duke konsideruar se fjala është përdorur në një kontekst krejtësisht të ndryshëm, i cili nuk stigmatizon ata që vuajnë nga autizmi.

MË E “PËRGJAKSHME” - BETEJA E INTERNETIT

Diskursi onlajn u bë fushëbetëj dominuese e propagandës, ndërsa shpifjet dhe fyerjet, stigmatizimi i vazhdueshëm dhe demonizimi i subjekteve të caktuara nga sektori politik por edhe ai civil, si dhe të “gazetaria” e njëanshme dhe jo objektive në platformat digjitale, ishte një përditshmëri gjatë fushatës për zgjedhjet e parakohshme. Kjo qasje ishte veçanërisht e spikatur te portalet Kurir, Republika, Netpress, Press24, Puls 24, Vistina, Vesti ... Përveç kësaj, i kishim edhe Maktel, Infomaks, Narodn Glas, Centar Njuz, ku, përveç këtyre gjërave, kishte edhe fjalor ofensiv ofendues, të papërshtatshëm për publik.

Në këtë periudhë vërehet edhe paraqitja e faqeve me lajme të rreme – sipas yrneku të ueb faqeve nga Velesi në fushatën amerikane, të hapura në Kroaci, Serbi, Mal të Zi, Bosnje, Bullgari, Shqipëri, të cilat publikonin lajme ekskluzive në dëm të ndonjë opsioni politik. Botime të tilla gjatë fushatës kishte në llogari të opozitës, para së gjithash, në drejtim të marrëdhënieve të LSDM-së dhe liderit të saj Zaev me shqiptarët.

PUSHTETI DERDHI PARA, OPOZITA U PËRPOQ TË BËJË BALLË, PARTITË E VOGLA DHE PARTIVE E SH-QIPTARËVE ME FUSHATA MODESTE

Sa i përket reklamimit të paguar politik, i cili u intensifikua me fillimin zyrtar të fushatës, në këtë periudhë, as në këtë kuptim gjërat nuk kanë shkuar pa pengesa. Përfundimi kryesor është se, ndryshe nga më parë, kur mediat fërkonin duart e tyre për shkak të mjeteve që u vinin gjatë fushatave të mëparshme, tani, për shkak të zvogëlimit drastik në çmimin e reklamimit, si dhe rrethanave të tjera, duket se reklamimi paraqet edhe një ngarkesë për mediat, jo vetëm në kuptim të tregut, por edhe në kuptim politik.

Opozita u ankua se në stacione të caktuara televizive nuk mund të blejë termine që janë të lirë dhe nuk janë blerë nga partitë e tjera opozitare.

TV Telma u ankua në publik për jo efikasitetin e partive dhe qëndrimin arrogant nga shumë aspekte gjatë negociatave në lidhje me reklamimin e partive në këtë televizion.

Në këtë kontekst, do të kujtojmë edhe për fjalosjen në mes të KSHZ-së dhe gazetës "Lajm" për shikimin e ofertës së paraqitur për reklamim të dorëzuar nga ky medium në KSHZ, një polemikë që mori përmasa të tjera, për të cilat shkruam më sipër në raport në më shumë detaje.

Në mediat në gjuhën maqedonase dominoi fushata e VMRO-DPMNE. Ajo ishte e ndjekur nga opozita e udhëhequr nga LSDM, ndërsa partitë dhe koalicionet e tjera ishin shumë më pak të përfaqësuar. Te mediat në gjuhën shqipe ishte shumë më dominuese fushata e BDI, e dukshme ishte edhe fushata e Lëvizjes Besa, ndërsa u vu re se edhe Lidhja Socialdemokrate ka fushatë në mediat në gjuhën shqipe. Partitë e tjera dhe koalicionet në "bllokun shqiptar", pothuajse nuk u vërejtën në programin e paguar politik dhe në përgjithësi zhvilluan fushata shumë më modeste mediatike.

Shënim: Objekt i shqyrtimit të kësaj analize janë aspektet që kanë të bëjnë me mediat dhe të drejtat e njeriut (para së gjithash, të drejtën e të shprehurit), të drejtat e votimit dhe legjislacionit mediatik që ka të bëjë me zgjedhjet. Burimet në të cilat e bazojmë analizën tonë janë gjetjet e ekipit hulumtues të Civil, përmbajtjet mediatike, por edhe raportet e AMSHMA dhe trupit ad-hoc i cili ka vlerësuar raportimin mediatik gjatë kësaj periudhe, Komisionit Shtetëror Zgjedhor, si dhe raportet e OJQ-ve të tjera, organizatave qytetare e ekspertëve që ndjekin mbulimin mediatik gjatë kësaj periudhe.

(Petrit Saraçini është ekspert i mediave, gazetar, artist dhe aktivist, anëtar i ekipit të proektit të CIVIL)

SI TË VIJMË TE DALJA DHE ÇFARË TË BËJMË PO QE SE PRAPË HYJMË NË TUNEL?

Në këtë konstelacion do të ishte shumë optimiste të pritet që mediat të luajnë çfarëdo roli konstruktiv në opinionin publik dhe proceset politike në vend në të ardhmen e afërt.

E para dhe më kryesorja: pa u përmirësuar paraprakisht gjendja politike, nuk mund të pritet përmirësim i gjendjes së mediave. Mediat janë pasqyrë e shoqërisë, e çdo shoqëri ka pushtetin dhe mediat që i meriton. Fotografia e shëmtuar e shoqërisë në Maqedoni duhet patjetër të përmirësohet në shumë aspekte, e për të gjitha këto, fjalë kyçe janë – vullneti politik.

Pa filluar së funksionuari në mënyrë të pavarur institucionet dhe mekanizmat e shtetit të lidhura me mediat, që momentalisht janë uzurpuar nga partitë në pushtet, pa gjyqësi që do të sanksionojë gjuhën e urrejtjes dhe thirrjet publike për linç, dhunë, vrasje, pa zbatim të përpiktë e joselektiv të ligjeve për shpifje dhe ofendim duke e marrë parasysh praktikën e Gjyqit të Strazburgut, nuk mund të kemi medie të përgjegjshme e transparente.

Pa mundësim të kushteve të drejta të tregut për mediat dhe kushte të drejta për punë për gazetarët, pa filluar të funksionojë në Maqedoni “dora e padukshme e tregut”, e jo “dora e gjatë” e pushtetit, nuk mund të kemi medime të lira.

Pa respektim të standardeve të profesionit dhe kodeksit të etikës, nuk ka medie të lira. Po qe se gazetarët vetë nuk i zgjidhin çështjet, gjithmonë do të lënë hapësirë që dikush tjetër prej jashtë t’ua zgjidhë ato. Vetërregullimi është një prej boshteve, mbi të cilët prehet gazetaria e pavarur. Ai duhet të përqafohet e të kultivohet, e jo të sabotohet e të banalizohet.

Pa servis publik të pavarur, i cili do të jetë shembulli pishtar për mediat e tjera për standarde e cilësi, as cilësia e përmbajtjeve në mediumet private, që megjithatë kanë interesa private biznesore, nuk do të ndryshojë.

Po qe se punët mbeten kështu siç janë, gjendjet nuk do të ndryshojnë në të ardhmen e afërt. Përkundrazi, do të përkeqësohen dhe do të degradohen edhe më shumë, me çka do të ndikohet negativisht edhe në mundësitë që Maqedonia të dalë nga kjo krizë shoqërore, gjë që mund të ketë edhe implikime të tjera më të gjera rajonale.

MEDIAT E DIRIGJUARA PËRSËRI ME AVAZIN E VJETËR: PROPAGANDISTËT E DËGJUESHËM TË PUSHTETIT MEZI E PRITËN FUNDIN E MANDATIT TË KOMISIONIT AD-HOK!

DEHRAN MURATOV

Pas mbarimit të zgjedhjeve dhe ndaljes së punës të komisionit ad-hok për rregullimin mediave gjatë procesit zgjedhor, vazhdoi kontrolli i fuqishëm i pushtetit mbi mediat në Maqedoni. Redaktorët e mediave të caktuara të dirigjuara, në vend të informimit të paanshëm, menjëherë u kthyen në rolin e njohur mirë të “shërbyesve të Partisë”, duke krijuar përmbajtje propagandistike si agjentë marketingu, para së gjithash, të VMRO-DPMNE.

Pasi u anulua votimi në fshatin Tearcë të Tetovës nga ana e KSHZ i Republikës së Maqedonisë dhe u sjell vendimi për rivotim, mediet pro-qeveritare vazhdimisht kanë lëshuar video anketë me deklarata nga banorë të njëjtë nga Tearca, të cilët kanë deklaruar se zgjedhjet e 11 dhjetorit të vitit 2016, ishin të drejta dhe demokratike dhe se nuk ka nevojë përsëri të votohet. Ky është vetëm shembull se si mediat të cilat me vite janë nën kontrollin e fuqishëm të pushtetit, tentuan që përmes materialeve të ndryshme të dirigjuara dhe të porositura, t’i paraqesin zgjedhjet si të suksesshme, ndërsa VMRO-DPMNE për fitues absolut.

Është e paqartë se pse komisioni ad-hok për mediat nuk funksionoi, dhe nuk e përcjelli punën e mediave pas mbarimit të zgjedhjeve të 11 dhjetorit? Komisioni është formuar si marrëveshje politike në Përzhinë, për monitorimin e përmbajtjeve të mediave deri në mbarimin e plotë të zgjedhjeve, ndërsa zgjedhjet nuk mbaruan më 11 dhjetor, sepse pati rivotim në Tearcë.

Këtë “lëshim” e shfrytëzuan mediat pro-qeveritare, për përhapjen e propagandës negative përmes përmbajtjeve mediatike kundër opozitës. Kishin hapësirë për manipulim që përmes artikujve të tyre t’i frikësojnë qytetaret dhe qytetarët se, nëse opozita e udhëhequr nga LSDM fiton edhe një deputet, atëherë do të bëhet kantonizim, federalizim dhe ndarja e shtetit.

Për këto artikuj, komisioni ad-hok nuk reagoi, sepse i mbaroi mandati më 11 dhjetor!

CIVIL kërkoi mendim nga disa ekspertë për qasjen (jo) profesionale të mediave ndaj zgjedhjeve dhe


mënyrës së informimit gjatë fushatës, në ditën e zgjedhjeve, dhe në periudhën post- zgjedhore. Drejtoresha e Këshillit për Etikë në Mediat e Maqedonisë, Marina Tuneva, thotë se politikanët përmes mediave kanë luftuar që ta fitojnë “hapësirën e merituar”, ndërsa gazetaria ka luajtur rolin e shërbyesit servil në atë qëllim. Kështu që, mediat nuk kanë ditur të vendosin vetë, por lejuan që këtë ta bënin dikush tjetër, në emrin e tyre.

“Për fat të keq, mjaft nga mediat nuk e kaluan provimin e profesionizmit, dhe nuk arritën të lirohen nga presioni i situatës politike. Përveç se u shndërruan në stacione për publicitetin e partive politike, hapësirën e tyre e keqpërdorën për t’u bërë hapësirë aktorëve politikë dhe agjendës dhe porositë të tyre, madje edhe kur ato përmbanin retorikë luftarake dhe provokuese. Mbeti perceptimi që do të zgjasë një kohë të gjatë, që etika nuk është në thelbin e punës së mediumit, por se ajo është vetëm emër abstrakt”, thotë Tuneva.

Komunikologu Sefer Tahiri, për CIVIL deklaroi se Maqedonia gjendet thellë në listën e mediave të robëruara, sepse në disa medie ka tekste me tituj të njëjtë, me tema të njëjta, që tregon se ato përmbajtje vijnë nga ndonjë qendër partiake ose shërbim propagandist.

“Për fat të keq, kjo është pasqyra e vërtetë për mediat tona. Informimi është një-dimensional dhe njëdrejtimësh, organizatat joqeveritare, mediat kritike, janë më qëllim të paraqitet VMRO-DPMNE si fituesi i vërtetë i në këto zgjedhje. Shpesh, në media të caktuara, ka edhe shprehje të urrejtjes, diskriminim, shpifje...ndaj atyre që nuk mendojnë si partia qeverisëse”, thotë Tahiri.

Snezhana Trpevska nga Instituti Maqedonas për Studime të Komunikimeve, deklaroi për CIVIL se, para se të fillojë fushata zgjedhore, ka pasur një periudhë në të cilën dukej se ka përmirësim në informimin e mediave për aktorët politik. Ajo shton se kjo është bërë me qëllim, sa të bëhet përshtypje pozitive para ndërkombëtarëve, posaçërisht si rezultat i marrëveshjes së dytë të Përzhinës. “Mediat pro qeveritare dhe private dhanë më tepër hapësirë në lajmet për opozitën dhe e “zvogëluan” diskursin demonizues ndaj zërave kritik të opozitës dhe tjerëve, ndërsa RTVM ka informuar në mënyrë relativisht të balancuar për të gjithë aktorët dhe temat politike. Mirëpo, siç afrohej fushata, kështu filloi të qartësohet se kjo me të vërtetë vetëm është dukur ashtu. Ata iu kthyen vetes, siç thuhet. Përsëri e shohim retorikën demonizuese të njëjtë ndaj opozitës, favorizimin eklatant të partisë në pushtet dhe përcjelljen jo-kritike të shprehjes së hapur të urrejtjes e cila vjen nga funksionarë të lartë politik nga pushteti”, thotë Trpevska.





FUSHATË E

ZEZË

ЗА МАКЕДОНИЈА СЕ РАБОТИ!
ЗОРАН ЗАЕВ ЗАГОВАРА
КАНТОНИЗАЦИЈА НА
МАКЕДОНИЈА!



ЗА МАКЕДОНИЈА СЕ РАБОТИ!

Ако Македонија ја немаш, а се друго имаш, тогаш ништо немаш! Покажи дека си патриот! Гласај против кантонизација, промена на уставот, двојазичност и редифинирање на државата! Една грешка може многу да ја чини Македонија!
Да гласаме за унитарна и суверена Македонија!

ЗОРАН ЗАЕВ ЗАГОВАРА
КАНТОНИЗАЦИЈА НА МАКЕДОНИЈА!

Тој предвидува пренесување на надлежностите на полицијата од централната на локалната власт, што значи дека Арачиново, Тилково, Чбир и другите општини во кои албанците се мнозинство, градоначалникот под своја команда ќе има сопствена униформизирана и вооружена полиција, и овие општини ќе одлучуваат за вработувањата, за културата, за здравствата, за управување со нивите, шумите и пасиштата, ќе издаваат лични карти и пасоши.
На стр. 163 и 164 од програмата на СДСМ, се издаваат дека општините ќе ги направат кантони.

ИЗВОДОК ОД ПРОГРАМАТА

КАНТОНИЈЕ НА ЛОКАЛНИТА САМОУПРАВА
На општините ќе им бидат пренесени сите надлежности што може да ги извршат и организирани од централната власт и тоа, без да управат функциите на МРО (материјално-економички, образовани и социјални делови) дел од надлежностите на полицијата (Завед. Ред и Мир) регулаторна на стандардите (Кантони) риншта (општин) и на медицински услуги, социјална заштита, центри за вработување (вештачки) зградите на установите од релјева на културата (од институција на нив што од национално значење) управување со земјиштето, земјоделството, шумите и пасиштата и др.

FUSHATË E ZEZË

MAJA IVANOVSKA

Në vend të fushatës parazgjedhore në të cilën mediat janë arenë për ballafaqim dhe analizim të ofertës politike, Maqedonia u përballua me një pasqyrë trishtuese dhe brutale të realitetit në të cilin gjendet shoqëria Maqedonase. Në vend se theksi i programeve të ofruara të partive politike, në ndoshta zgjedhjet më të rëndësishme nga pavarësimi i Maqedonisë e deri tani, periudha parazgjedhore në Maqedoni ishte e mbushur me fajësime të ashpra, ofendime, spine, defokusim të publikut dhe lojë politike të fëlliqur.

Fushata negative, qëllimi i të cilës është diskreditimi i kundërshtarit politik, ku nuk respektohet dinjteti i njeriut, bëhet inkadrim negativ dhe stereotipizim, ku avancohen sulme personale kundër oponentëve politikë, ka arritur kulmin deri në atë masë, sa që Maqedonia lirisht mund të hyjë si shembull në definicionit për fushatë të zezë.

Fushata e zezë u bë emërues i përbashkët i të gjithë pjesëmarrësve në procesin zgjedhor. Fokusi i fushatave ishte i drejtuar nga korrupsioni, krimi, përgjimet, spinet e një pjese të ofertës politike të partive, pa zgjedhje të mjeteve. Edhe pse pritej që kjo fushatë parazgjedhore do të jetë një nga më të fëlliqurat deri tani, duke e marrë parasysh faktin se këto zgjedhje paraqesin moment historik në politikë, ekspertët partiak për PR dhe marketing politik, kanë zbatuar taktikë jashtëzakonisht të suksesshme të imponimit të temave të caktuara me qëllim – defokusim i publikut nga problemet reale.

Taktika e këtillë në veçanti është e zhvilluar nga VMRO-DPMNE, e cila bindshëm i realizon parashikimet e krijuesve të politikës së tanishme. Teknikat jashtëzakonisht të përvetësuar të spineve dhe pizmës, të pasuruara me propagandë ditore-politike, për fat të keq, kanë sukses të madh. Ende ekziston një pjesë e madhe e publikut e cila i “blen” këto “produkte”, edhe pse, mbi asnjë bazë, duke marrë parasysh të gjitha problemet me të cilat po përballlet shoqëria e Maqedonisë, nuk guxuan të bëhen tema të interesit publik dhe në mënyrë plotësuese ta copëtojnë shoqërinë edhe ashtu të ndarë.

Defokusimi nga problemet e vërteta ishte i pranishëm në të gjitha format, prej video spot-eve për bukuritë e Maqedonisë, deri te fajësimet reciproke për përgjegjësinë për shkatërrimin e Maqedonisë. Kjo shpesh kishte tonin e nacionalizmit të fuqishëm dhe demonizimin e komuniteteve të tëra etnike dhe fetare, si dhe etiketimin e një numri të madh të qytetarëve dhe qytetarëve, si spiunë dhe tradhtarë. Nxjerrja nga konteksti nga deklaratat e kundërshtarit politik, ishte e vazhdueshme, si dhe shfrytëzimi i të njëjtave si armë e ftohtë kundër tyre, përmes shmangies së aftë të çështjeve djegëse dhe sfidave. Lajmet dhe evenimentet publike ishin të bazuara në pamflete të lira politike të stërmbushura me shprehje të urrejtjes dhe thirrje për dhunë ekstreme.

Maqedonia mbeti e etur për debat të vërtetë politik në të cilin opozita nuk do të kapet në karremin e hedhur nga pushteti, i cili impononte tema dhe përmbajtje artificiale dhe destruktive. Në vend se t’i injorojë temat e imponuara, opozita u zhyt thellë në polemikë për dygjuhësinë dhe gjoja federalizmin dhe kantonizimin e Maqedonisë.

Edhe pse, Nikolla Gruevski që në fillimin e fushatës zgjedhore, në vend të fushatës zgjedhore, paralajmëroi 500 faqe program real të VMRO-DPMNE, realiteti ishte ndryshe.

“Dëshiroj t’u theksoj të gjithë ju, qytetarëve të Maqedonisë se ka jo 101, por më shumë se 1001 arsye të mos e votoni opozitën, por ne nuk u helmojmë me fushatë të tillë negative, urrejtja dhe destruktiviteti i tyre flet për ata, ne u japim mbi 500 faqe plot me arsye në programin tonë pse të votoni për ne...Ne ofrojmë shumë projekte dhe masa reale”, porositi Gruevski në tubimin parazgjedhor në Shkup.

Paralajmërimi i fushatës në shikim të parë dukej tepër optimist, për atë që më vonë u shndërrua në pikën kryesore të fjalimeve të Gruevskit në tubimet nëpër Maqedoni.

“Përveç dygjuhësisë në tërë territorin, Zoran Zaev si duket ka premtuar edhe kantonizimin e Maqedonisë. Kantonizimi i Zvicrës është një punë, ndërsa në Ballkan është krejtë-

sisht tjetër. Kantonizimi i Maqedonisë do të nënkuptonte pesë, gjashtë kantone të cilat me kohë, një nga një në mënyrë ligjore, me vendimin e qeverive lokale kantonale, do të shkëputen. Një gjë e tillë nuk na duhet. Duhet ta ndërprejmë këtë ide të çmendur të Zoran Zaevit. Duhet ta ndërprejmë sepse nga kjo do të ketë pasoja të përmasave të mëdha. A do të ndodh për tre ose pesë vite, problemet do të vijnë para derës tonë. Ne vetëm u tregojmë të gjithëve se do të na e prishin paqen, do të na krijojnë probleme të mëdha dhe të përgjakemi. Më 11 dhjetor duhet ta këpusim këtë, dhe do tu themi se çfarë Maqedonie dëshirojmë, dhe se askush nuk mund të na qeveris”, u shpreh Gruevski në tubimin në Veles.

Përveç fjalimeve të këtij lloji, në fjalimet politike edhe më të pranishme ishin ofendimet personale, kërcënimet dhe kushtëzimet, si dhe shprehja e urrejtjes. Kështu që dëgjuam se si Zoran Zaev duhet të mbyllet në kafaz në shesh, sepse aty e ka vendin. Dëgjuam se si duhet të mbarojnë të gjithë “tradhtarët” si ai.

“ Edhe ai erdhi këtu në Dellçevë dhe flet, të bëhet Goce Dellçev, çka do të tregojë për ne si Qeveri, e cila ndërtoi aq shumë, e cila ka tërhequr aq shumë investitorë, e cila dha aq shumë energji, fuqi, ndihmë fermerëve në Maqedoni dhe shumë gjëra tjera. Ai ka gjetur ta citojë Dellçevin. Unë do t’i tregoj. Po të ishte Dellçevi gjallë sot, ai nuk do të mundej as të përshëndetet me atë, atij do ti ishte dërguar vetëm Qoseja ta kryejë tregimin për atë njeri” – tha Gruevski në fjalimin në Dellçevë. Me këtë, Gruevski në mënyrë të hapur u kërcënua me vrasje, ndaj të cilës gjë nuk reagoi asnjë institucion relevant, që nuk është për t’u habitur, duke pasur parasysh se janë nën kontrollin e plotë partiak.

Edhe pse dukej se opozita bën fushatë më të ndritur për një nuancë, megjithatë nuk mbeti imune në fjalimet provokuese, kështu që Zoran Zaev, përmes foltores nga Çairi i Shkupit iu drejtua liderit të VMRO-DPMNE me fjalët: “ Derisa unë flas për Goce Dellçevin, ti Nikollë, kërcënohesh me Qosen. Por, çdo gjë që ka fillimin, ka edhe fundin. Nikollë, si e ka emrin dora e djathtë e Qoses? Quhet Dokurçev. Çfarë të të them më tepër, Dokurçev dhe Qoseja”.

Gjëja që seriozisht brengos në këtë retorikë është që kandidatë, bartës të listave për deputetë, publikisht bëjnë thirrje për linçimin e kundërshtarëve politikë, duke u referuar në persona nga e kaluara siç është Andon Llazov – Qoseto, Ilagapi i të cilit ka qenë Kasapi, gjë që në mënyrë të mjaftueshme e shpjegon rolin e tij në lëvizjen kombëtare. Pikërisht me figura të tilla nga historia e Maqedonisë, Gruevski e udhëhoqi fushatën, ndërsa prob-

lemet “reale” dhe zgjidhjet e tija “reale” ishin dhe mbetën vetëm zbukurim.

Fushata negative, përveç fjalimet e kandidatëve, agoi edhe në materialin propagandues të partive dhe në mediat e shtypit dhe elektronike. Kështu ishte i pranishëm edhe materiali i shtypur propagandues me përmbajtje: “LSDM dëshiron ta federalizojë Maqedoninë! Interesat më të larta kombëtare janë objekt i tregtisë të LSDM. LSDM e vendos në rrezik tërësinë e Republikës së Maqedonisë.”

Në disa nga video – spotet të cilat emitoheshin në televizionet , qëllim të vetëm kanë pasur diskreditimin e kundërshtarit politik, pa respekt ndaj dinjitetit njerëzor, inkuadrim negativ, stereotipizim dhe sulme personale kundër figurave politike në dy partitë më të mëdha të bllokut Maqedonas.

“Agjencia për Shërbime Audio Vizuale të Mediave, i ka dërguar këto spote deri te Prokuroria Themelore Publike –Shkup : “ Me votën për VMRO-DPMNE, ti bëhesh bashkëpunëtor në këto krime!” (porositës LSDM) dhe “Kërrusje e kurrizit ose interes shtetëror” (porositës VMRO-DPMNE), për shkak të dhënave për shkeljen e nenit 48, për çfarë Prokuroria Themelore Publike u përgjigj se nuk do të ngrit procedurë penale, sepse “nga përmbajtja e dy spoteve doli se nga aspekti penal-ligjor, nuk ekziston dyshim i bazuar se është kryer vepër penale e cila persekutohet me detyrë zyrtare”.

Pas temave të imponuara artificiale u fsheh debati i vërtetë për atë se sa Maqedonia do të fitojë, e sa do të humbë në këto zgjedhje. Pas arsyeve për defokusimin e publikut, fshihet fakti për mospasjen e vullnetit, e as guximit, për dialog dhe prioritet për zgjidhjen e problemeve reale me të cilat po përballet shteti, siç është mosfunksionimi i institucioneve shtetërore, që u tregua edhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në periudhën post –zgjedhore, para dhe pas shpalljes së rezultateve.

As në periudhën post –zgjedhore nuk u anashkalua kjo retorikë e zezë, për çfarë dëshmojnë ngjarjet para Komisionit Shtetëror Zgjedhor, ku përfaqësues të lartë të VMRO-DPMNE publikisht bëjnë thirrje për njëfarë “nate të thikave të gjata”. Gruevski u shpreh me Shpalljen e tij përmes cilës jo vetëm se u vërtetua fushata e zezë dhe destruktive e cila mbahej në periudhën e kaluar, por edhe qëllimet e kësaj partie për përballje brutale kundër të gjithëve të gjithëve që u qëndrojnë në rrugë, prej ndërmjetësuesve të huaj, ambasadorëve, diplomatëve, deri te përfaqësues të sektorit qytetar.

Ajo për të cilën CIVIL –Qendra për Liri ka paralajmëruar për më shumë se një vit para fillimit të procesit zgjedhor, ndërsa një pjesë nga subjektet politike mbetën të shurdhër dhe memecë para konstruktivitetit dhe bashkëpunimit të cilin e ofruam. Përkundrazi, CIVIL, si dhe një numër i madh i sektorit qytetar, madje edhe një pjesë e institucioneve shtetërore si Prokuroria Speciale Publike, ishin vetëm një nga shënjestrat e fushatës së zezë. Në mënyrë e partive në pushtet dhe të mediave ty tyre të dëgjueshme, ishin ofendimet, shpifjet, shprehja e urrejtjes, shpikjet e thjeshta, si dhe thirrje publike për ekzekutime dhe linçime të aktivistëve, intelektualëve dhe opozitarëve.

Në orvatjet për zgjidhjen e krizës veç më të stërzgatur politike në Maqedoni, opinioni intelektual dhe akademik, opozita – tani e zmadhuar dhe e zgjeruar, sektori qytetar dhe mediat, nuk guxojnë t’u nënshtrohen provokimeve dhe diktaturës së strukturave destruktive në sferën publike. Patjetër duhet të mënjanohej të gjitha temat destruktive të imponuara nga pushteti, qëllimi i të cilave është defokusimi i publikut të gjerë nga problemet me të cilat po përballemi. Vendosja nën qilim e të gjitha çështjeve të cilat janë prioritare për këtë shtet thjeshtë duhet të ndërpritet. Secila retorikë nacionaliste dhe militante duhet të gjykohet me vendosmëri!



DYQIND DITË TË
RËNDA PËR MAQE-
DONINË



DYQIND DITË TË RËNDA PËR MAQEDONINË

MONIKA TALESKA

Në gjysmën e dytë të vitit 2016, Maqedonia nuk arriti fare përparim në planin e kthimit të demokracisë, sundimit të drejtësisë, punën e Prokurorisë Speciale Publike (PSP) dhe lirinë e shprehjes.

Pas dështimit të tentimit të dytë, më 05 qershor të vitit 2016, për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, që t'i vendoset fundi krizës politike (kulmi i të cilës ishte afera me "Përgjimet" më 09 janar, 2015) vazhdoi pasiguria për implementimin e Marrëveshjes së Përzhinës. Publiku pro-demokratik, pjesëmarrësit në Revolucionin e Larmë, shoqëria civile, e kanë ndjekur

me vëmendje çdo hap të elitës politike të VMRO-DPMNE, e cila nga ana tjetër, i pengonte fillimet progresive, veçanërisht nga agjenda e PSP.

Partia qeverisëse VMRO-DPMNE dhe partnerët e tyre të koalicionit edhe më tej e mbanin shtetin peng. Çdo tentim për përparim dhe kthim të drejtësisë ishte i shoqëruar me pengesa të ashpra nga qendrat e fuqisë.

Megjithatë, më 31 gusht, liderët e katër partive të cilat e lidhën Marrëveshjen për tejkalimin e krizës, në Përzhinë, Nikolla Gruevski (VMRO-DPMNE), Zoran Zaev (LSDM), Ali Ahmeti (BDI) dhe Menduh Thaçi (PDSH), me ndërmjetësimin e bashkësisë ndërkombëtare, e nënshkruan "aneksin" e Marrëveshjes dhe u kuptuan për datën përfundimtare të zgjedhjeve – 11 dhjetor, viti 2016. Për herë të tretë ishin të caktuara zgjedhje të parakohshme, me imperativin të jenë të lira, të besueshme, të drejta dhe demokratike, t'i vendosin fund krizës politike.

Ndërkohë, u pajtuan për vazhdimin e hetimit dhe trajtimin gjyqësor për veprat penale, të cilat dolën nga afera "Përgjime".

Kushtet nuk u plotësuan. Zgjedhjet u mbajtën.

VMRO-DPMNE fitoi 51, LSDM 49, BDI 10, PDSH 2 mandate. U paraqitën parti të reja relevante në bllokun Shqiptar: Besa, e cila fitoi 5 mandate dhe Aleanca për Shqiptarët 3 deputetë. Një vit pas dorëheqjes së Gruevskit nga pozita e kryeministrit, (sekretari i përgjithshëm i VMRO-DPMNE, Emil Dimitriev nga 18 janari 2016, u emërua për Kryeministër i R.M.), Presidenti Ivanov përsëri ia dorëzoi mandatin për formim të Qeverisë së re. Shteti u fut në krizë politike edhe më të madhe. Partitë e Shqiptarëve etnikë dolën me kërkesa të vendosura si pjesë nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit (e nënshkruar më 13 gusht 2011). Nuk është e sigurt nëse VMRO-DPMNE do të arrijë të formojë Qeverinë e re, ose nëse LSDM do ta fitojë mandatin, në pajtim me ligjin. Qytetarët janë në agoni. Frika nga pasiguria, kthimi i sistemit të vjetër i cili i mbante institucionet nën kontroll, është edhe më e fuqishme. Nevoja për ndërmjetësim të bashkësisë ndërkombëtare, përsëri është imperativ për shtetin Maqedonas.

Korrik dhe gusht

LIDERI GRUEVSKI EDHE MË TEJ KRYEMINISTËR “NËN HIJE”

Vërshimet katastrofale të cilat më 07 gusht të vitit 2016 e përfshinë Shkupin dhe vendbanimet e rrethinës në të cilat humbën jetën mbi 20 persona, ndërsa dy herë më tepër ishin të lënduar, që shkaktuan dëme të mëdha materiale, në fakt e hapën përsëri pasqyrën reale të skenës politike të Maqedonisë. Lideri i VMRO-DPMNE, Gruevski, tregoi se në fakt ai është kryeministri Maqedonas “nën hije”. Me metoda populiste, me veprim gueril “Qeverinë prapa, Gruevski jep komandat”, sapo i kthyer nga pushimi veror në Antal, ai përsëri e ofendoi intelektin e bashkëpartiakëve të tij, e në veçanti kryeministrit aktual Dimitrievi-it. Me përqendrim të vetëm për mbledhje të pikave politike, me telefonin në duar, duke krijuar tension, luante rolin e profetit Maqedonas, përsëri në mënyrë të paskrupullt duke i demonstruar publikut Maqedonas dhe ndërkombëtar, se në Maqedoni, VMRO-DPMNE është shteti, dhe se nuk ka fuqi e cila do ta zbret atë nga froni. Ndërsa, tragjedia, në masë të madhe, më vonë u vërtetua se është pasojë e moskujdesit prej një dekade të pushtetit lokal dhe qendror!

Lideri i LSDM-së, Zaev, i ftoi qytetarët për humanitet dhe solidaritet, të përmbahen

nga akuzimet dhe nga stigmatizimi publik i politikanëve gjatë tragjedisë. I bindur që për tre javë, në takimin e paralajmëruar liderëve, do të vendoset për formimin e Qeverisë kalimtare dhe për caktimin e zgjedhjeve më 11 dhjetor, dhe realizimin e plotë të Marrëveshjes së Përzhinës.

Prokuroria Speciale Publike (PSP) nën udhëheqje të Katica Janevës në këtë periudhë punon me tempo të shpejtësuar, por çdo hap në luftën me krimin në Maqedoni sillej nën pyetje, për shkak të mos bashkëpunimit të gjyqeve të Maqedonisë. Gjykata Penale e Shkupit i refuzoi tre propozimet e PSP për caktimin e masave paraprake për të dyshuarit në rastin "Fortesa". Atyre nuk do t'u merren pasaportat, siç më herët ishte i refuzuar propozimi i PSP për marrjen e pasaportave të ish-Ministres për Punë të Brendshme, Gordana Jankullovska. Masa e vetme e afektuar është për Goran Grujovski, ish-drejtorin e Drejtorisë së Pestë. PSP vlerëson se ka dëshmi, sepse grupi ka organizuar shkatërrimin e dy sistemeve për përgjim të komunikimeve, me të cilin veprim shteti është dëmtuar për 10 milionë euro. Ndërkohë, një nga të dyshuarit në rastin "Fortesa", Toni Jakimovski, shefi i kabinetit të drejtorit të mëparshëm të DSK, Sasho Mijallkov, është avancuar në drejtor gjeneral të Qendrës Juglindore Evropiane për Zbatimin e Ligjit (SELEC), trup ndërkom-

bëtar për luftë kundër krimit, duke përfshirë krimin e organizuar në Evropën Juglindore. Jakimovski është një nga 56 personat e falur, të cilët u gjetën në listën, tani të tërhequr të faljes kolektive të Presidentit Ivanov.

Në skenën politike pikërisht në këtë periudhë, BDI nuk e fshehte pakënaqësinë nga koalicioni qeverisës. Opozita shqiptare akuzoi për manipulime të mëdha në Listën e Votuesve dhe ka shprehur mosbesim dhe dyshim se reformat do të mundësojnë zgjedhje të besueshme. Për lëvizjen Besa, metodologjia është e pasuksesshme.

Një javë pas vërshimeve, kur aktivistët qytetarë luftonin me rrënimet dhe baltën, sepse pushteti edhe kësaj here dështoi, grupi parlamentar i LSDM propozoi seancë të jashtëzakonshme parlamentare dhe kërkoi përgjegjësi. Kuvendi në ditën e tetë pas vërshimeve sjelli masa për ndihmë për viktimat. Publiku i kritikonte politikanët se "blejnë" pika politike, mbi kurrizin e viktimave.

Më 13 gusht të vitit 2016 Maqedonia regjistroi 15 vite pas vendosjes së Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, e cila duhej të vendos fundin e konfliktit të armatosur dhe të bëhet themel i bashkëjetesës ndëretnike në shtetin. Për fat të keq, qytetarët ende luftojnë për të drejtat themelore të njeriut.

Korrik dhe gusht

PARA VENDIMIT PËR ZGJEDHJE TË JASHTËZAKONSHME, MAQEDONIA HUA-ZON!

Dhjetë ditë para takimit të katërshes së liderëve Gruevski, Zaev, Ahmeti dhe Thaçi, të caktuar për 31 gusht, ku pas revidimit të realizimit të pikave nga Marrëveshja e Përzhinës pritej të caktohet data e zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare, Maqedonia e thelloi deficitin e buxhetit për 4%. As euro-bondi prej 450 milionë euro i shpallur më 19 korrik të vitit 2016, nuk mund t'i mbulojë shpenzimet e pushtetit. Me rebalancin e dytë të buxhetit, i cili veç më është i dërguar në parlament, familjeve të dëmtuara nga vërshimet do tu avancohet dëmshpërblim minimal prej 500 euro. Ndërsa Qeveria nuk heq dorë nga "projektet kapitale" – Rrota Panoramike dhe Kop-shti i Parajsës, me vlerë 33 milionë euro! Rejtingu kreditor i Maqedonisë u ul në BB nga BB+, lajmëroi agjencia kreditore "Fiç". E gjithë kjo, për shkak të huazimit të ri me euro-bondin, krizën politike, e cila filloi në shkurt të vitit të kaluar, protestat disamujore, dështimi i Marrëveshjes së Përzhinës dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare të dështuara, të prillit dhe qershorit në vitin 2016. Mirëpo, edhe për shkak të pengimit

të punës së PSP. Tani, pyetja e logjikshme është, se si mund të bie rejtingu i shtetit në rilindje ekonomike, me investime dhe punësime të vazhdueshme (sipas fjalorit të pushtetit)?!

Kjo është periudha kur PSP shënon aktivitete më voluminoze, por zgjedhjet gjyqësore janë larg. Këshilli penal i Gjykatës Themelore Shkup 1, e vazhdoi paraburgimin shtëpiak për kryetarin e Manastirit, Vlladimir Taleski, për 30 ditë, për rastin "Transporter". Mirëpo, Taleski vazhdoi të firmos dokumente për komunën, madje edhe marrëveshje me vlerë prej 5.4 milionë euro. Dëgjimi për rastin "Fortesa" u prolongua, sepse ish-ministrja Jankullovska, e dyshuar për shkatërrim të paligjshëm të pajisjeve, ka kërkuar inspektim në dëshmitë. Dëgjimi i kryetarit të Komunës Qendër, Andrej Zhernovski, për rastin e demolimit ë Komunës në vitin 2013, zgjati tre orë. Në PSP, si dëshmitarë do të paraqiten Menduh Thaçi, lideri i PDSH dhe Samka Ibraimoski, lideri i Partisë për Emancipimin e Plotë të Romëve. PSP mori kompetencat për rastin "Spiun", dhe e kërkoi rastin kundër gazetarit Zoran Bozhinovski.

DATA PËR ZGJEDHJE ËSHTË CAKTUAR, ÇDO GJË TJETËR ËSHTË E PASIGURT

ЛLiderët e katër partive më të mëdha politike më 31 gusht të viti 2016, u pajtuan që zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të nëntat me radhë në Maqedoninë e pavarur, të mbahen më 11 dhjetor. Kushte për zgjedhje të lira duhet të sigurojë Qeveria kalimtare. Shumicën parlamentare e votoi përbërja e re e Qeverisë teknike Maqedonase me mandat prej 100 ditë. Opozita e udhëhequr nga LSDM edhe në këtë Qeveri merr pjesë me Frosina –Tashevskaja –Remenski, Ministria për Punë dhe Politikë sociale, ndërsa Oliver Spasovski është Ministri i ri për Punë të Brendshme. Detyra e tyre, mes tjerash, është ti departizojnë ministrinë dhe ti drejtojnë kapacitetet dhe resurset në shërbim të zgjedhjeve të lira. LSDM merr pjesë edhe me tre zëvendës ministra: Kire Naumov për financa, Aleksandar Kiracovski për shoqëri informatike dhe administratë dhe Ljupço Nikollovski për bujqësi, pylltari dhe ujëra. Janë kuptuar që Parlamenti të shpërbëhet dhe të shpall zgjedhje më 12 tetor. Edhe nga VMRO-DPMNE edhe nga LSDM shpresojnë për fitore në zgjedhje. Kryeministri formal Dimitriev kërkon bashkëpunim konkret, në bend të konflik-

teve mes ministrave dhe zëvendësve.

Në këtë periudhë, pushteti në krye me liderin partiak Gruevski, bën veprime të çuditshme. Vërtetim për këtë është emërimi i Oliver Andonov-it për Ministër të Punëve të Brendshme me mandat prej vetëm 24 orë. Ai menjëherë e emëroi Mitko Çavkovin për njeriun e parë në Byronë për Siguri Publike, dhe pastaj, në pajtim me Marrëveshjen e Përzhinës, dha dorëheqje, që ta pranojë vendimin e ri për zëvendës ministër plotësues të MPB para zgjedhjeve në Qeverinë kalimtare. Ky veprim udhëzon për 100 ditët e ardhshme turbulente në MPB. Emërimi i Çavkov-it brenda natës për drejtor të Byrosë, dhe punësimi i kuadrove të reja partiake në MPB para zgjedhjeve, shton dyshimet për realizimin e zgjedhjeve kredibile. Në vend të departizimit, partia edhe më tepër mishërohet me shtetin.

PSP i refuzoi ankesat e të akuzuarve në rastin “Spiun”, por propozoi uljen e dënimeve, ndërsa për një pjesë nga të akuzuarit ka kërkuar dënime me kusht. Prokuroria e ka vendosur nën thjerrëza projektin “Shkupi 2014”. Në dëgjimin ishte e ftuar Ministria për Kulturë, Elizabeta Kançeska –Milevska. Dëshmoi edhe biznesmeni më i pasur Maqedonas, Orce Kamçev.

MAQEDONINË E TRONDITIN TËRMETE POLITIKE

HJo vetëm vargu i tërmeteve të fuqishme, të cilët e arrinin fuqinë prej 5.3 shkallë të Rihterit, me epiqendër disa kilometra nga metropola e Maqedonisë, në vendbanimet e goditura nga vërshimet, qytetarët e Maqedonisë e shënuan 25 vjetorin e pavarësisht të vendit (08 shtator, viti 2016) edhe me tërmete politike. Është rëndë të vendoset ose mund të thuhet se nuk ekziston bashkëpunim mes ministrave nga VMRO-DPMNE dhe LSDM. Në dy resorët: për Punë dhe Politikë Sociale dhe në Ministrinë për Punë të Brendshme kryhen ndryshime të kuadrove. Vetëm dy ditë para zgjedhjes së Qeverisë kalimtare, VMRO-DPMNE emëroi kuadro të vet në organet udhëheqëse në rreth 30 institucione shtetërore. Të ndërruar brenda natës, drejtorë, këshilltarë, anëtarë të bordeve udhëheqëse... Më turbulente është situata në qendrat për punë sociale. Para ardhjes së Tashavska-Remenski (LSDM) në funksionin e Ministres, dhe me ndërrimin e Ministrit Dime Spasov (VMRO-DPMNE), në seancë të Qeverisë janë emëruar anëtarë të 12 bordeve udhëheqëse në 14 qendra dhe

në institucione tjera sociale në shtetin. Pas emërimit të Remenski, nëntë drejtorë të qendrave, gjatë një dite e kanë informuar Ministrinë se kanë hapur pushim mjekësor. Skenar të ngjashëm, thonë nga opozita, ka pasur edhe gjatë emërimit të parë të Remenski në Qeverinë teknike.

Kushtetueshmëria e PSP ende nuk është e vendosur në rendin e ditës në seancën e parë të Gjykatës Kushtetuese, të caktuar më 28 shtator, edhe pse katër partitë më të mëdha e ftuan Gjykatën të sjell vendim sa më shpejtë. Sipas aneksit të fundit të Marrëveshjes së Përzhinës (31 gusht, viti 2016), në rast të vendimit të Gjykatës Kushtetuese që Ligji për PSP ose një pjesë nga ai ligj është jo-kushtetues, katër partitë obligohen ta përputhin Ligjin me vendimin e Gjykatës dhe përsëri ta formojnë Zyrën në afat prej 5 ditë. Sipas Marrëveshjes “duhet të mbahen efikasiteti, përqendrimi dhe qëllimet e PSP”.

Prokurorja Janeva apeloi deri te Kuvendi që t'i sjellë ndryshimet e Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, që ky institucion të mundet të hyjë në thelbin e rasteve - Martin Neshkovski, “Monstra” dhe “Sopot”. Nga BDI në mënyrë deklarative thonë se do ta mbështesin punën e PSP, mirëpo se duhet së pari të pranojnë iniciativën për këtë.

Procesi gjyqësor “Puç” është i prolonguar për 1 nëntor, për arsye të mungesës së një anëtarit të jurisë. Sipas liderit opozitar Zaev, mungesa e anëtarit të jurisë është vetëm “mbulesë” e dëshmitarit kryesor, i cili ka vendosur të mos paraqitet në Gjykatën. Janeva ka reaguar për prolongimin e dëgjimit dhe faktit që Gjykata nuk u lejoi gazetarëve ta ndjekin.

Organi ligjvënës për pothuajse një javë i ngjan një skene teatrore në të cilën luhet parodi e demokracisë, me skenar të pushtetit. Deputetët nga shumica, nën të gjitha normat etike, me përqeshje dhe sarkazëm i “hidhen” prokurores Janeva. “Yjet” e mediave pro-qeveritare përqendrohen në dantellën, e jo në punën e prokurores. Në kushte kur shteti nuk ka kapacitetin të sigurojë parakushte për zgjidhje të krizës politike, përsëri mobilizohet Revolucioni i Larmë. Situata politike në shtet është me e ndërlikuar sesa para Marrëveshjes së Përzhinës. Revolucioni i Larmë proteston para Kuvendit në shenjë të mbështetjes së Janeva-s.

Gjykata penale nuk i ka dërguar ftesë Gruevskit për dëgjimin e radhës për procesin “Puç”, edhe pse ai është dëshmitar në këtë rast, në të cilin gjykohet rivali i tij më i madh politik, Zaev. Lidhja mes gjykatës dhe pushtetit është më se e

dukshme. Në MPB vijojnë ndryshime të kuadrove sipas vendimeve të ish-ministrit Çavkov. Goran Grujovski, i dyshuar dhe i akuzuar në dy raste të PSP, nga drejtor i DSK është i emëruar për ndihmës-drejtor i koordinimit me MPB. Me këtë hap, në pritje të zgjedhjeve, pesë drejtoritë në MPB janë nën kontrollin e Grujovskit, ndërsa ngriten procedura penale kundër aktivistëve të Revolucionit të Larmë.

KUVENDI NUK I VOTOI LIGJET PËR PUNË TË PAPENGUAR TË PSP

Kuvendi nuk i votoi Propozim – Ligjin për ndryshime dhe Ligjin për PSP dhe Propozim – Ligjin për ndryshim të Ligjit për dëshmitarë të mbrojtur, me të cilat duhej të mundësohet puna e papenguar e PSP-së, derisa nuk kryhen të gjitha veprat penale të cilat do të dalin nga materialet në aferën “Përgjimet”. Grupi parlamentar i VMRO-DPMNE mbeti në qëndrimet se nuk do të pranojnë shqyrtimin e çfarë do kërkesë nga PSP. Ambasada e SHBA shpalli lajmërim në të cilin i inkurajon të gjitha partitë t’u përmbahen obligimeve nga Marrëveshja e Përzhinës, që të sigurojnë zgjedhje të besueshme dhe punë të papenguar të PSP dhe të vëzhguesve të pavarur të mediave. Ambasada ka shprehur sigurimin se kërkesat e PSP-së për mbështetje të hetimit themelor dhe të pavarur të fakteve, janë të arsyeshme. CIVIL- Qendra për Liri vazhdimisht apelon dhe e shpreh mbështetjen e vet për punën e PSP-së.

Rritet pasiguria dhe dyshimi te qytetarët rreth mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme më 11 dhjetor. Në Maqedoni, udhëtoi edhe Eurokomisari Johannes Han. Ai u takua me katër liderët. Porositë se BE me

vëmendje e ndjek procesin parazgjedhor dhe se Maqedonia duhet të kthehet drejt rrugës euroatlantike. Udhëzoi për prioritetet urgjente për reforma nga Raporti i Pribe-së, për nevojën për zgjedhje legjitime dhe të rregullta, dhe shprehi vërtetim se do puna e PSP-së do të mbështetet.

Eurodiplomatët: Riçard Hovit, Eduard Kukan dhe Ivo Vajgëll, në takimin me përfaqësues të organizatave qytetare në Bruksel, dërguan mesazh të qartë se zgjedhjet e 11 dhjetorit do të mbahen. Vajgëll, disa politikanëve në Maqedoni u ka porositur “të gjejnë avokatë të mirë”!

ZGJEDHJET U SHPALLËN, SHTETI PO VLON!

Folësi i Parlamentit, Trajko Veljanoski e ka shpërbë Kuvendin, dhe më 18 tetor, viti 2016, i shpalli zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të cilat do të mbahen në datën e caktuar, më 11 dhjetor. Partitë ua kthejnë mandatet qytetarëve. Vendimi për zgjedhje arriti edhe deri te Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ), ndërsa anëtarët votuan që fushata të fillojë më 21 nëntor.

Filluan kalkulimet partiake, formoheshin listat për deputetë. Partitë më të mëdha, VMRO-DPMNE dhe LSDM, për më saktë, dy

liderët, Gruevski dhe Zaev, do t'i matin forcat në njësinë e katërt zgjedhore. Bëhen anketa partiake, përcillen rejtingjet. Në listat e LSDM dhe Koalicionit "Për jetë në Maqedoni", paraqiten aktivistë të Revolucionit të Larmë. PSP vazhdon betejën me krimin. Ka hapur hetimin për shitjen e truallit për ndërtim për ndërtimin e lagjes " Qyteti i diellit" në Sopishtë të Shkupit. Në rastin "Toplik" akuzoi gjashtë persona, një funksionar i mëparshëm në Ministrinë e Transportit, ndërsa të tjerët janë nga Komisioni për Ankande Publike. Të gjithë ngarkohen për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe dëmtime të buxhetit shtetëror për një milion euro. Ministri i mëparshëm Mile Janakieski, tërësisht i demantoi gjetjet. PSP në rastin e ri "Tenderë" i akuzon Ministren e Kulturës, Kançeska –Milevska dhe tre të punësuar në Muzeun e VMRO. PSP një javë të tërë lufton dhe me dy vendime gjykate hyri në DSK, me qëllim të sigurojë dokumentacionin për masat e veçanta hetuese dhe të dhënat nga sistemi për përgjim. Është marrë edhe një pjesë nga të dhënat, por Janeva ka hasur në pengesa serioze nga DSK. Kulmi ishte dëbimi i hetuesit të PSP nga objekti i DSK. Hetuesi i PSP-së ishte i arrestuar, ndërsa prokurorja e liri nga stacioni policor "Beko". Më vonë, kompania Suedeze "Erikson" lajmëroi se nuk është pronare dhe se nuk operon me pajisjen për përgjime në DSK, si përgjigje në kërkesën e

PSP-së, për asistencë teknike gjatë hetimit në DSK. Ndërsa drejtori i Byrosë për Siguri Publike Çavkov, pas hyrjes së PSP-së në DSK këmbëngulte që sistemi nuk është pronë e MPB dhe DSK, por se është pronë e operatorit dhe se vetëm person i autorizuar ka qasje deri te ky sistem.

Pason skandali në të cilin Zëvendës Ministri për Punë dhe Politikë Sociale, Dime Spasov, kuadër i VMRO-DPMNE shkaktoi fatkeqësi trafiku në gjendje të alkoolizuar, me automjet zyrtar, në mesnatë (29 tetor, 2016). Vargu i ngjarjeve, ndryshimet e deklaratave të bashkudhëtares së tij dhe të punësuarit në Ministrinë, dhe pas heshtjes prej disa ditëve dhe intervistës së rregulluar me Spasov-in në një media pro-qeveritare, janë vetëm vërtetim se në Maqedoni ligji përdoret "sipas nevojës" dhe se funksionarëve të pushtetit u është e lejuar çdo gjë.

Nga ana tjetër, nga kazerma "Ilinden", është evidentuar që janë zhdukur 40 vula nga KSHZ, për Komunat: Sopishte, Bërvenicë, Butel dhe Likovë. Këtë e ka zbuluar komisioni i KSHZ, i cili ka bërë regjistrimin e materialeve votuese. KSHZ lajmëroi se do të bëhen vula të reja.

FILLOI FUSHATA ZGJEDHORE ME RETORIKË TË ASHPËR NACIONALISTE

Më 21 nëntor, viti 2016, në pajtim me afatet ligjore, filloi fushata zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të caktuara për 11 dhjetor. CIVIL-Qendra për Liri nga 11 subjektet politike, parti dhe koalicione të cilat marrin pjesë në procesin zgjedhor, kërkoi respektim të denjë të rregullores ligjore, dhe për çdo shkelje të konstatuar, paralajmëroi se do ta informojë publikun.

PSP e zbardhi rastin "Target", që ka të bëjë me krijuesit dhe aktorët kryesorë në aferën "Përgjimet". Ka ngritur procedura kundër 10 personave, mes tyre edhe kuadro të udhëheqësisë së mëparshme të DSK, drejtpërdrejtë të akuzuar për "keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe kompetencave", të cilët e kanë rrezikuar privatësinë dhe biznes interesat e disa mijë qytetarëve me përgjime të 5.827 lidhjeve telefonike, në periudhën prej vitit 2008 deri vitin 2015. PSP udhëzoi se përgjimet e paligjshme janë realizuar me keqpërdorimin e sistemeve për ndjekjen e komunikimeve, gjatë së cilës janë lënduar të drejtat dhe liritë e njeriut, të mijëra qytetarëve, politikanë të përgjuar, gazetarë, biznesmenë..., anëtarë të partisë qeverisëse dhe të opozitës, figura politike aktuale dhe të mëparshme, me përjashtim të liderit

dhe kryeministrit të mëparshëm, Nikolla Gruevski, lidhjet telefonike të cilat nuk kanë qenë "shënjestër" e përgjuesve.

Fushata zgjedhore vazhdoi me shkallë të ulët të kulturës politike. CIVIL, vetëm për një javë ka regjistruar mbi 70 raste të parregullsive zgjedhore nga vëzhguesit në terren, dhe rreth 100 paraqitje nga qytetare dhe qytetarë për fillimin e parakohshëm të fushatës zgjedhore, për keqpërdorimin e resurseve shtetërore, të të miturve, evidencoi raste të korrupsionit...KSHZ për Civil ka lajmëruar se nuk ka mekanizma për shlyerjen e të ashtuquajturve "fantazma", për arsye se ata janë persona të cilët me dokumente ligjore, në mënyrë ligjore kanë nxjerrë letërnjoftime ose pasaporta.

Diplomati Austriak, Sebastijan Kurc ka ardhur për vizitë në Maqedoni. Pas takimit me kolegun e tij, Nikolla Poposki, deklaroi se "zbatimi i zgjedhjeve të lira dhe të drejta, bashkë me implementimin e prioriteteve urgjente të reformave, do të mundësojnë që Maqedonia të kthehet në rrugën e negociatave për anëtarësim në BE". Prania e Kurc në tubimin e VMRO-DPMNE në Shkup, shkaktoi reagime të mëdha në rrjetet sociale dhe u vlerësua si lobim i hapur parazgjedhor për partinë.

Qytetare/ët e pakënaqur në protesta kërkuan të drejta më të mëdha sociale,

dhe ndalimin e ndotjes së ajrit. Tensionet u rritën edhe në FSM, pasi lideri Zhivko Mitrevski, me vetëvendosje i ka shprehur mbështetje Gruevskit në emër të FSM. Partitë premtonin punsime të reja, ndërsa VMRO-DPMNE edhe investime të cilat nuk i realizoi gjatë 10 viteve në pushtet. LSDM dhe lideri Zaev si udhëheqës të koalicionit “Për jetë në Maqedoni”, premtoi dygjuhësi në tërë territorin e Maqedonisë. Kjo deklaratë e tronditi elektoratin e VMRO-DPMNE dhe koalicionin “ Për Maqedoni më të mirë”.

Dhjetor

MAQEDONIA VOTOI E PAPËRGATITUR, NJË MUAJ PAS ZGJEDHJEVE S’FORMOJ QEVERI!

Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) e mbylli Listën Zgjedhore me 1.531.368 votues në Maqedoni. Kontrolli vërtetoi se me qëndrim dhe punë të përkohshme jashtë vendit janë 230.122 votues, të cilët nuk do të votojnë, dhe 20.573 qytetarë të cilët janë me qëndrim me afat të caktuar, por të cilët do të votojnë në këto zgjedhje. Lista Zgjedhore është në kaos total, përplot me njerëz të paqenë, me persona të ndjerë të cilët vazhdojnë “të jetojnë” dhe “të votojnë”... Të dëshpëruar, të mllefosur,

qytetare/ë s’mund ta realizojnë të drejtën e votës. KSHZ – jotransparent dhe pa qasje. Numri më i madh i medieve në funksion të pushtetit. Publik i painformuar apo mendim publik i krijuar nëpërmjet prizmit të VMRO-DPMNE. PSP në rrugën e drejtësisë. Populli është nën presion të madh nga oferta zgjedhore. Administrata nën presion të madh dhe kanosje nga partia në pushtet. Udhëheqës të administratës në terren, gjatë kohës së punës bëjnë agjitim për partinë. Zbatues të blerjes së votave me para, të zënë “të gjallë”. Pasiguri! Frikë! Shqetësim i qytetarëve para ditës së zgjedhjeve! E këtillë ishte Maqedonia para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.

Dita zgjedhore kaloi qetë, pa incidente. Civili evidentoi një numër të madh të parregullsive zgjedhore! Lideri i opozitës, Zaevi, shpalli fitore. Një orë më vonë, edhe lideri i VMRO-DPMNE shpalli fitore. Qytetarët me pasiguri i pritnin rezultatet. Festime nëpër sheshe. Qytetarë euforik, votues edhe të njërit edhe të opsionit tjetër. Edhe pas 18 orëve, KSHZ nuk doli me një raport relevant për rezultatet e procesit zgjedhor!

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare e thelluan krizën shumëvjeçare politike. Një javë pas zgjedhjeve, Maqedonia është në udhëkryq. Qytetarët duhet të vendosin, a do të përcaktohen për integritet euroatlantike apo e kundërta, do të japin kontribut

Maqedonia të nisë drejt vetizolimit. Situata u bë e ndërlikuar. LSDM dhe koalicioni “Për Jetë në Maqedoni” dhe partia e shqiptarëve etnik, Besa, vendosën të paraqesin vërejtje për parregullsitë deri te KSHZ!

Seanca e KSHZ në të cilën vendosej për vërejtjet u shoqërua me protesta të VMRO-DPMNE. Në mënyrë të organizuar, para selisë, me daulle, me valle dhe zjarre të ndezura, me gjuhë të urrejtjes dhe thirrje për linç publik, të drejtuar nga funksionarë të lartë partiak, VMRO-DPMNE bënte në këtë mënyrë presion mbi punën e KSHZ. Medie të shumta organizuan transmetim të drejtpërdrejtë nga seanca. KSHZ vendosi të pranojë vetëm një vërejtje nga Besa, ndërsa të gjitha të tjerat, së bashku me ato të LSDM, u refuzuan.

Gruevski para KSHZ shpалosi një Proklamim, të votuar nga Komiteti Ekzekutiv i VMRO-DPMNE, i cili përmban pesë pikë dhe me të cilin partia dhe Gruevski e akuzojnë KSHZ për manovrim dhe falsifikim të vullnetit zgjedhor të qytetarëve.

Sipas Proklamimit, VMRO-DPMNE s’do të lejojë që lideri i LSDM të krijojë qeveri, as përzierje të mëtejme të ambasadorëve në çështjet e brendshme politike në vend. Atyre u porositi të qëndrojnë në kuadër të mandateve dhe autorizimeve.

Partia, shpалosi Gruevski, shmanget nga formati i takimeve në të cilat marrin pjesë

ambasadorë, ndërmjetësues të huaj, në të cilat negociohet apo sillen vendime për të cilat në çdo shtet vendosin përfaqësues të zgjedhur nga populli. Në të ardhmen s’do të pranohen zgjidhje jostandarde dhe hibride në çfarëdo sektori, në rast se nuk ekzistojnë në vendet e tjera anëtare të BE.

VMRO-DPMNE s’do të lejojë kantonizim dhe ripërcaktim të vendit me çfarëdo lloj kushtesh dhe rrethanash. Sipas Proklamimit, VMRO-DPMNE do të luftojë për desorosoizim të RM dhe forcim të sektorit qytetar të pavarur.

Dhjetor-janar

ZGJEDHJET PËRFUNDUAN, PROBLEMET MBETËN

Në bazë të vendimit të Gjyqit Administrativ, i cili e anuloi vendimin e KSHZ për refuzim të vërejtjes dhe e pranoi ankesën e LSDM, KSHZ lajmëroi se më 25 dhjetor do të ketë rivotim në vendvotimin 2011 në Komunën e Tearcës. Me këtë u finalizua procesi zgjedhor, i cili në pajtim me Marrëveshjen e Përzhinos, duhej t’i japë fund krizës shumëvjeçare politike në Maqedoni. Por, rezultatet e votimit, 245 përballë 149 votave në favor të LSDM dhe të koalicionit “Për Jetë në Maqedoni”, në kushte të daljes së 402 votuesve nga 714 votuesve/

eve të evidentuar me të drejtë vote, nuk e ndryshuan renditjen politike, sa u përket mandateve të fituara në Kuvendin e ri (VMRO-DPMNE – 51, LSDM – 49, BDI – 10, BESA – 5, PDSH – 2 dhe Aleanca për Shqiptarët – 3).

KSHZ ua dorëzoi vërtetimet për mandatet 120 deputetëve të rinj në Kuvendin maqedonas. Në këtë përbërje të Kuvendit ka 62 deputetë të rinj dhe 58 nga përbërja e mëparshme.

Zyrtarisht, më 30 dhjetor u konstituua përbërja e nëntë me radhë e Kuvendit të Maqedonisë. Tre liderët e katërshes së Përzahinos: Gruevski, Zaevi dhe Ahmeti morën pjesë, ndërsa Thaçi (PDSH) s'që prezent këtë herë. Në seancën konstitutive morën pjesë përfaqësues të korit diplomatik, të bashkësive fetare, kryeministri Dimitriev, por, edhe pse ishte i ftuar, presidenti Gjorge Ivanov nuk erdhi kësaj radhe. Pasi të arrihet marrëveshja për koalicionin qeveritar, do të shqyrtohet edhe propozimi për zgjedhjen e spikerit të ri të kuvendit.

Ministrat dhe zëvendësministrat plotësues të MPB dhe MPPS, të emëruar në pajtim me Marrëveshjen e Përzahinos u shkarkuan, ndërsa në vendin e tyre u emëruan kuadro të reja.

Në vend të ministrit të brendshëm Oliver Spasovski (LSDM), vendin e zuri Agim

Nuhiu (BDI). Ministren e punës dhe politikës sociale Tashevski-Remenski (LSDM) e zëvendësoi Ibrahim Ibrahimi (BDI). Pa funksion mbetën edhe zëvendësministrat plotësues të VMRO-DPMNE Oliver Andonov dhe Dime Spasov dhe Kire Naumovi nga LSDM.

Edhe pse legjitimiteti dhe i tërë procesi zgjedhor janë shumë të diskutueshëm, pasi KSHZ i ndau, ndërsa në seancën e parë konstitutive u miratuan mandatet e deputetëve, formalisht u përmbushën kushtet për hapin e ardhshëm. Duke pasur parasysh shumicën e 51 mandateve të deputetëve, VMRO-DPMNE, më saktë Nikolla Gruevski, më 09 janar, e pranoi mandatin për qeveri të re nga presidenti Ivanov. Vazhdoi mëdyshja, a do të arrijë të krijojë qeveri.

MIRATOHET PLATFORMA E PARTIVE TË SHQIPTARËVE ETNIK

Pas konsultimeve në Tiranë dhe Prishtinë, liderët e partive të shqiptarëve etnik në Maqedoni, e miratuan Platformën e cila është kusht për koalicion me partnerin e ardhshëm në qeveri. Të vetëdijshëm se kanë një rol kyç në formimin e koalicionit të ardhshëm, BDI, Aleanca për Shqiptarët dhe Besa përpiluan 30 kërkesa, ndërsa "Platforma është me afat për implementimin e tyre. Mes tyre, arritja e barazisë së tërësishme në pajtim me Marrëveshjen e Ohrit dhe Kushtetutës, zbatimi i rreptë i parimit të multietnicitetit të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, ku shqiptarët janë pranuar si popull shtetformues. Përkrahje për çdo iniciativë ligjore apo kushtetuese me të cilën përforcohet barazia etnike e popullatës shqiptare. Arritje e barazisë gjuhësore të tërësishme, përdorim i gjuhës shqipe në të gjitha nivelet e pushtetit dhe sigurimi i përdorimit të tij, si e drejtë themelore dhe kushtetuese. Në Kushtetutë të shkruajë 'gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, gjuha shqipe dhe alfabeti i saj janë gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë'. Një debat gjithëpërfshirës për

flamurin shtetëror, himnin dhe stemën e Republikës së Maqedonisë, me qëllim që simbolet shtetërore ta shprehin multietnicitetin shtetëror dhe barazinë etnike. Miratimi i një rezolute në Kuvend, me të cilin dënohet gjenocidi mbi popullin shqiptar në Maqedoni në periudhën 1912-1956, përkrahje e punës së paanshme të Prokurorisë Speciale, pa paragjykime etnike dhe politike...".

Këto kërkesa të BDI, Besës dhe Aleancës për Shqiptarët në mënyrë plotësuese ngritën pluhur, ndërsa politikologët dhe analistët vlerësojnë se Platforma e komplikon gjendjen politike tanimë të komplikuar në shtet.


Shumë çështje janë të hapura: a do të pajtohen të gjitha partitë e shqiptarëve etnik të ulen në tryezë të rrumbullakët me Gruevskin, i cili është i akuzuar për vepra penale nga afëra e përgjimit? Dhe, sa është ai i gatshëm që në emër të anëtarësisë së vet të lëshojë pe, nëse i kemi parasysh fyerjet e vrazhda dhe retorika nacionaliste gjatë zgjedhjeve, drejtuar shqiptarëve etnik në Maqedoni, por edhe qëndrimi për PSP?! Besa është kategorike në qëndrimin se s'do të negociojë me politikanë për të cilët janë ngritur kallëzime penale. Nga ana tjetër, Komiteti Ekzekutiv i VMRO-DPMNE është këmbëngulës se

s'pranon dygjuhësi, s'e pranon Platformën dhe është kundër vazhimit të punës së PSP! Analistët komentojnë se në pajtim me ligjin, në rast se VMRO-DPMNE nuk arrin të krijojë qeveri, duhet ta kthejë mandatin dhe pastaj presidenti Ivanov duhet t'ia japë partisë e cila është e dyta sipas numrit të mandateve të fituara, në këtë rast LSDM. Ndërkohë u takuan Zaevi dhe Ahmeti. LSDM paralajmëroi edhe takime të tjera, edhe pse janë shqyrtuar vetëm pozitat e partive, pa u negociuar. Dëgjohen paralajmërimet se VMRO-DPMNE do të insistojë në zgjedhje të reja?

Zhvillimi i gjendjes politike s'mund të prognozohet. Bashkësia ndërkombëtare dërgon mesazhe të qarta për të gjitha partitë, PSP të vazhdojë me punë pa pengesa, të krijohet një qeveri demokratike, Maqedonia të kthehet në rrugën euroatlantike.

Maqedonia paszgjedhore kërcet në të gjitha anët. Edhe pse sipas kalendarit jemi në vitin e ri 2017, Maqedonia do ta fillojë me faqe të shkruara me probleme të panumërta shoqërore-politike dhe ekonomike. Qytetarët janë të ngrirë, të frikësuar se a do të kenë mjete të mjaftueshme për ngrohje nëse vazhdon dimri polar. Disponimin festiv e zëvendësuan me pasiguri për rezultatin e krizës politike. Pas mar-

rëveshjes së Përzhinos dhe zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 11 dhjetor, Maqedonia përsëri është në fillim, por shumë shkallë më poshtë.



BETEJAT ME

SAJBER UJKUN

E KEQ



Ermin Klimenta në terren

BETEJAT ME SAJBER UJKUN E KEQ

ERMIN KLIMENTA

Pas muajve të gjata të cilat na sollën deri këtu, pas të gjitha ato ofendime, sharje, madje edhe kanosje të shpeshta të cilat i lexojmë në rrjetet sociale, për çdo ditë, por edhe numri më i madh i pakrahasueshëm me lëvdata dhe besim dhe përkrahje të tërësishme në adresë të Civilit, ka ardhur koha të marrim pak frymë dhe të shikojmë prapa. Askush nga ne në ekipin e Civilit nuk është kursyer nga mallkimi i nacionalizmit, të keqes, e cila, për fat të mirë, deri më tani, megjithatë, nuk arriti t'i mbisundojë njerëzit e arsyeshëm në vend.

Shikoni tani, të jesh një sistem-administrator s'është punë fare e lehtë dhe këtë stres nuk ia dëshiroj asnjë të riu. Megjithatë, unë e bëj këtë, sepse më plotëson dhe i jep kuptim përditshmërisë sime. E di se bëj diçka me të cilën krenohem dhe do të krenohem. Vetëm ata të cilët janë në një situatë të ngjashme, e kuptojnë këtë në tërësi... Një punë shumë e rëndësishme të cilën dëshiroj ta theksoj është vetmia, e cila është një armik i vërtet i çdokujt që e punon këtë, fusha ime e interesit profesional. Të gjithë kanë kolegë, por kjo s'do të thotë se të gjithë e kuptojnë atë që e bëni. Por, edhe kjo është në rregull.

Civili është cak i sajber sulmeve të ashpra me muaj. Si duket kjo?

DDoS sulmet janë forma të sulmit mbi infrastrukturën e serverit. Zakonisht, këto janë sulme të targetuara mbi serverët e “armikut”. Njerëz të cilët kanë vetëm një qëllim, të pengojnë një numër të madh të lexuesve të mos arrijnë deri te përmbajtja të cilën e kërkojnë dhe të krijojnë probleme për administratorët.

Sulmet mbi sajtin e CIVIL – Qendrës për Liri, rriteshin në mënyrë konstante, deri te sulmi rekord me 18 GB, të dielën, më 11 dhjetor 2016, ditën e zgjedhjeve. Sulmi më i madh deri më tani në një ditë. Edhe pse jemi mësuar me këto përpjekje për të na heshtur, megjithatë, kishim një periudhë të shkurtër prej pesë minutave, kur faqja ishte e pamundësuar për publikun në Maqedoni.

Sulmet e zakonshme janë rreth 200 GB në muaj, por në periudhën 01-10 dhjetor, kishim sulme me më shumë se 186 GB – për vetëm 10 ditë! Kjo është sikur të zëvendësoni një bager për të hapur një gropë me një ton dinamit për të njëjtën gropë.

E vetmja që mund të konkludoj definitivisht është se askush me qëllim s’do t’i kishte bërë dëm me aq fuqi, një infrastrukturë siç është Civili. Ne i jemi bërë halë në të dy sitë dikujt, i cili qartë paguan nga 300-500 euro në ditë(!), për blerje ditore të një serveri i cili i bën këto sulme.

Përpjekjet e tyre të mjerueshme për fshehjen prapa maskave të cilat i shfrytëzojnë (pun intended) janë pa dyshim nga IP adresa ruse, të cilat janë vërtet të lehta për t’i zbuluar, një herë pasi vendosen protokollet themelore për siguri të një ueb-faqeje të thjeshtë. Këmbëngulja e tyre dhe, gjithsesi, përfitimi ekonomik nga kjo anë (pa dyshim) i lë në attack mode pozitive në mënyrë konstante, por edhe ne na bëri më të mençur, më tinëzarë dhe shumë më këmbëngulës.

Për arsye teknike, s’kisha mundur të hyjë më shumë në detaje, por edhe për shkak të sigurisë së sajteve të cilat i mirëmbaj. Atë që publiku, lexuesit dhe vizitorët, gjithsesi duhet ta dinë është se një njeri i cili është përgjegjës për infrastrukturë, e ka përgjegjësinë për online ekzistimin e medias. Ai duhet të mundësojë një rrjedhë të papenguar të informatave, sidomos në çaste kritike.

E vetmja gjë të cilën kurrë s’do ta lejojmë si CIVIL – Qendër për Liri është të bimë nën ndikim, në sprovë për mënyrën më të lehtë të informimit të vonuar dhe joobjektiv. Detyra jonë, krahas të gjitha sulmeve të “sajber ujkut të keq”, gjithmonë është publikimi i

informatave me kohë dhe të sigurta deri te qytetaret dhe qytetarët e këtij vendi kaq të bukur, por edhe të munduar.

Vizita e outletëve mediatik të Civilit është në rritje të vazhdueshme. Ueb-faqja kryesore www.civil.org.mk në periudhën kohore prej gjashtë muajve (1 korrik – 31 dhjetor 2016) deri më tani ka pasur mbi 500.000 vizita, ndërsa ueb-faqet e tjera të cilat (7 ueb-faqe dhe mbi 15 domejna) gjithashtu kanë një shtrirje prej më shumë se 350.000 vizita në të njëjtën periudhë.

Kjo i solli të gjitha ueb-faqet e Civilit në suaza impresive të faqeve të cilat i indeksojnë parametrat e ndryshëm, siç është vizita e faqes, koha e qëndrimit, numri i faqeve të vizituara dhe kritere të tjera, për të dhënë në fund një listë të faqeve më të vizituara sipas vendit dhe globalisht. Faqet e Civilit, duke pasur parasysh përmbajtjen e specializuar dhe jokomerciale, e cila publikohet me licencë të Creative Commons (e lirë për marrje dhe ribotim), paraqesin një destinacion të shpeshtë të një publiku shumë të gjerë, i cili ndjek përmbajtje në maqedonisht, shqip dhe anglisht. Në bazë të online analitikës, të cilën e bëjnë organizata dhe kompani globale, mbi të cilat s’kemi fare ndikim, me kënaqësi dhe me krenari mund të konkludojmë se Civilit është mes online resurseve më me ndikim në vend.

Për tërë këtë sukses është meritator ekipi i palodhshëm i Civilit, por edhe online autleti www.facebook.com/civil.mk, me 4,7 milionë vizita në periudhën në fjalë. Mendoni pak, 4.700.000 do të thotë se çdo banor i Maqedonisë, duke përfshirë edhe të porsalindurit, kanë lexuar së paku dy lajme të Civilit në gjashtë muajt e kaluar.

Ne në Civil me krenari mund të dëshmojmë se nuk u gjunjëzuam në asnjë çast. Ne nuk dorëzohemi, nuk tërhiqemi dhe nuk kërkojmë falje nëse jemi në të drejtë! Qëndrojmë të drejtuar para të gjithë atyre të cilët na kanose me “wiitch hunt” dhe do të luftojmë kundër padrejtësisë. Deri në fund.

Online – të gjithë jemi online, 24/7 – 7 ditë në javë – 365 ditë në vit. Sidomos me zhvillimin e madh dhe të shpejtë të teknologjisë celulare, smart telefonat u bënë pjesë e përditshmërisë sonë, madje edhe për pesimistët si unë, të cilët thoshin se telefoni kurrë s’do të mund të zëvendësojë një kompjuter statik apo lap-top. Sot, falë telefonit tim mund të shkoj në kafene dhe njëkohësisht ta mbikëqyr infrastrukturën e tërë të rrjetit të cilin unë e administroj. Liri e lëvizjes – kjo është shprehja e vërtetë për t’u përshkruar kjo ndjenjë.

Online paraqitja e Civilit gjithmonë ka qenë unikale në ueb hapësirën maqedonase dhe, sidomos, në rrjetet sociale. Gjendemi në vend të parë në shumë kategori dhe, gjithsesi, më e dashur është besueshmëria e lexuesve tanë, të cilët një kohë të gjatë janë me ne dhe na përkrahin në atë që e punojmë për çdo ditë dhe me mund të madh.

Civili posedon disa outleta të cilët shfrytëzohen për informimin e publikut për tema nga më të ndryshmet, nga proceset politike dhe zgjedhjet në vend, deri te drejtësia sociale, ekologjia dhe kultura.

Civili është i pranishëm në online hapësirën pothuajse nga themelimi në vitin 1999. Ueb-faqja e parë www.civil.mk.org u lansua në të vitin 2001. Ueb-faqja www.civil.org.mk u regjistrua në vitin 2003, si outlet i organizatës dhe pastaj edhe si outlet mediatik i Civil Medias. Kjo ueb-faqe u ndihmoi gazetarëve t'i zgjerojnë horizontet e veta, prodhoi kuadro të shkëlqyera, të cilët tani mund të gjejnë veten në medie prestigjioze në vend dhe jashtë. Ueb-faqja www.civil.org.mk para do kohe e ndali punën si outlet mediatik dhe iu kthye funksionit të mëparshëm – ta përfaqësojë organizatën dhe aktivitetet e veta. Me këtë hap niveli i vizitës të mbetet i lartë, por jemi të sigurt se vizita e outletëve të tjerë mediatik të Civilit do të rritet me shpejtësi marramendëse.

Këtu, para së gjithash, e kam fjalën për www.civilmedia.mk, www.civilalb.info, www.civil.today, por edhe disa të tjerë (www.greencivil.mk, www.clp.mk, www.freedom.mk) me info-portalet e rinj.

Edhe pak statistikë.

Në periudhën prej 1 korriku deri më 31 dhjetor faqja e organizatës www.civil.org.mk ka pasur më shumë se 500.000 vizita, duke u bërë njëra nga ueb-faqet më të vizituara të organizatave joqeveritare, por edhe mediatike, në Maqedoni.

Profilet sociale të cilat më së shpeshti i përdorim për real time live stream-et janë YouTube, Facebook dhe Twitter. Shikueshmëria e live stream-eve arriti mbi 20.000 shikues për postim ditën e votimeve dhe mbi 2.500 në YouTube kanalën CivilMacedonia.

Mbulimi mediatik i Civilit nga ana e televizioneve kombëtare, siç janë Telma, 24 Vesti, TV21 dhe të tjerë, të cilat me inkuadrimitin e drejtpërdrejtë ndikonin në rritjen e shikueshmërisë dhe dukshmërisë të Civilit. Ata, sipas statistikave të fundit të ASHMAA

(Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale) shikueshmëria e këtyre medieve ka qenë mbi 800.000 shikues në nivel kombëtar.

Maqedonia ka një bashkësi krenare (nëntokësore) të tweeter-it, e cila në mënyrë aktive e ndiqte procesin zgjedhor nëpërmjet @CivilMacedonia tweeter handle-in, i cili fitoi mbi 60.000 impresione me tweet-et e veta gjatë ditës së zgjedhjeve.

Kaq prej meje, tani për tani. Shihemi online!



PËR PROJEKTIN

Projektet për vëzhgimin e proceseve politike dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Republikën e Maqedonisë, siguruan informatë jo-partiake, objektive dhe relevante për publikun e Maqedonisë dhe atë botëror, gjatë gjithë periudhës së implementimit.

CIVIL-Qendra për Liri ka zbatuar vëzhgimin afatgjatë dhe analizë për proceset dhe ngjarjet lidhur me krizën shumëvjeçare politike në vendin, si dhe të të gjitha aspekteve të rëndësishme të procesit zgjedhor i cili shihej si hap i rëndësishëm ndaj tejkalimit të gjendjeve të rënda.

Materiali të cilin e kanë përmbledhur bashkëpunëtorët e shumtë të CIVIL-it nga terreni, vazhdimisht është përpunuar, verifikuar dhe i sistematizuar, ndërsa publiku ishte i informuar për të gjitha gjetjet dhe aktivitetet e organizatës, për çdo ditë. Të dhënat nga terreni iu nënshtruan një analize të thellë dhe gjithpërfshirëse, ndërsa pjesa më e rëndësishme nga ky material është përfaqësuar edhe në këtë publikim, i cili përfaqëson dëshmi për gjendjet në Republikën e Maqedonisë, dhe dokument i cili mund të shërbejë si bazë për hulumtime të mëtejme, por edhe si udhëzues drejt ndryshimeve pozitive në vend dhe në shoqëri.


CIVIL ka radhitur vëzhgues afatgjatë në 14 qendra rajonale, të cilat e mbulojnë tërë territorin e Republikës së Maqedonisë. Punën e tyre e kanë koordinuar dhe verifikuar ekipet mobile dhe 14 anëtarët e ekipit të projekteve në Shkup, mes të cilëve është edhe ekipi i CIVIL Media, i përbërë nga gazetarë dhe gazetarë profesionistë.

CIVIL ka formuar edhe ekipin e ekspertëve, në përbërjen e të cilit, përveç ekspertëve që janë pjesë e ekipit të projekteve të CIVIL, janë edhe: Dr. Sasho Ordanoski, Aleksandar Novakoski dhe Sandra Gavrilovska nga Maqedonia, Dragan Zeliq dhe Marina Shkraballo nga GONG, Republika e Kroacisë, Aleksandra Joziq-Ilekoviq nga qendra për përsosmëri pranë Ministrisë për Punë të Jashtme dhe çështje Evropiane, të Kroacisë dhe Heder Roberson Gaston, eksperte për të drejtat e njeriut nga SHBA.

Në ditën e votimeve, më 11 dhjetor, CIVIL ka radhitur 308 vëzhgues të akredituar nga të cilët të gjithë, pa përjashtim, ishin mobil. Ata vizituan pothuajse 2.000 vendvotime, që përfaqëson më tepër se gjysmën e vendvotimeve në vend. Në përbërje të ekipeve vëzhguesve ekipet e CIVIL ishin edhe ekspertët e GONG, Kroacia, si dhe shumë liderë dhe anëtarë të organizatave joqeveritare nga vendi dhe jashtë vendit.

Ekipi analitik i CIVIL, në përbërjen e të cilit ishte edhe një përfaqësues i GONG, Kroaci, në ditën e votimeve numëronte njëzet persona të cilët i morën dhe i përpunuan raportimet nga terreni, ndërsa ekipi i medias përgatiti konferencat për shtyp dhe panel-diskutimet. CIVIL mbajti gjashtë konferenca për shtyp dhe një numër të madh të brifingjeve të jashtëzakonshme për media të caktuara nga vendi dhe jashtë vendit, dhe tre panel diskutime eksperte.

CIVIL vazhdoi me vëzhgimin e procesit politik në vendin edhe pas zgjedhjeve.



Logo: PËRPARA

2016

Projekte të Civilit për vëzhgim, forcimin e vetëdijes publike dhe edukim

PËRPARA!

Projekt për vëzhgimin zgjedhor

ZGJEDHJE TË LIRA PËR QYTETARE DHE QYTETARË TË LIRË

projekt për edukim, forcim të vetëdijes publike dhe vëzhgim

VËZHGOJMË

Projekt për vëzhgim zgjedhor

KARVANI I LIRISË

projekt për forcimin e vetëdijes publike për të drejtat dhe liritë e njeriut


OBJEKTIVI QYTETAR

Projekt për gazetari qytetare

CIVICA MOBILITAS

grant për zhvillim institucional





Projekti: PĚRPARA

www.civil.org.mk